

E Ardhmja e Demokracisë në Europë

Trende, analiza dhe reforma politike



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

E Ardhmja e Demokracisë në Europë



COUNCIL OF EUROPE CONSEIL DE L'EUROPE

E Ardhmja e Demokracisë në Europë

Trende, analiza dhe reforma politike

Përgatitur nga

Philippe C. Schmitter

Instituti Universitar European (Itali)

Alexander H. Trechsel

Universiteti i Gjenevës (Zvicër)

Pjesë e projektit “Funksionimi i Institucioneve
Demokratike në Europë,” Këshilli i Europës

GLOBIC PRESS

Titulli i botimit ne anglisht:

The Future of Democracy in Europe: Trends, Analyses and Reforms.

ISBN10: 92-871-5570-4

ISBN13: 978-92-871-5570-2

This translation of *The future of democracy - Trends, analyses and reforms*, is published by arrangement with the Council of Europe.

Copyright © 2006 ALPSA, on Albanian translation,

Copyright © 2004 Council of Europe, on publication in English and French.

All rights reserved. No part of this book may be reproduced in any manner whatsoever without the prior written permission of the publisher except in the case of brief quotations in critical articles and reviews. For information and permissions, contact Globic Press via email books@globic.us.

Published by Globic Press

A division of Globic LLC

PO Box 788

Chapel Hill, NC 27514-0788

USA

<http://press.globic.us/>

Globic Press books are available at special discounts for bulk purchases and promotions. For more information, please contact: books@globic.us

ISBN 0-9776662-5-5

Printed in the United States of America.

AUTORËT

András Bozóki, Universiteti i Europës Qendrore - *Central European University* (Hungari)

Sven Bring, Shoqata Suedeze e Autoriteteve Vendore dhe Federata Suedeze e Këshillave të Konteve – *Swedish Association of Local Authorities and Swedish Federation of County Councils* (Suedi)

Dario Castiglione, Universiteti i Ekzeterit - *University of Exeter* (Mbretëria e Bashkuar)

Giovanni Di Stasi, Presidenti i Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës – *President of the Congress of Local and Regional Authorities of the Council of Europe*

Brith Fäldt, anëtare e Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës – *member of the Congress of Local and Regional Authorities of the Council of Europe* (Suedi)

Andreas Føllesdal, Universiteti i Oslos - *University of Oslo* (Norvegji)

Daniel Gaxie, Universiteti i Parisit – *University of Paris, Panthéon-Sorbonne* (Francë)

Andreas Gross, anëtar i Ansamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës – *member of the Parliamentary Assembly of the Council of Europe* (Zvicër)

Alan Lloyd, anëtar i Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës - *member of the Congress of Local and Regional Authorities of the Council of Europe* (Mbretëria e Bashkuar)

Vivien Lowndes, *De Montfort University* (Mbretëria e Bashkuar)

Ugo Mifsud Bonnici, President Emeritus, anëtar i Komisionit të Venecias, Këshilli i Europës – *President Emeritus, member of the Venice Commission, Council of Europe* (Maltë)

Patrizia Nanz, Universiteti i Bremenit – *University of Bremen* (Gjermani)

Lawrence Pratchett, *De Montfort University* (Mbretëria e Bashkuar)

Cyril Ritchie, Komiteti për Marrëdhëniet me OJQ-të, Këshilli i Europës – *NGO Liaison Committee, Council of Europe*

Philippe C. Schmitter, Instituti Universitar European – *European University Institute* (Itali)

Alexander H. Trechsel, Universiteti i Gjenevës – *University of Geneva* (Zvicër)

Andrzej Wielowieyski, anëtar i Ansamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës – *member of the Parliamentary Assembly of the Council of Europe* (Poloni)

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	9
HYRJE	11
PJESA I - SFIDA DHE MUNDËSI	15
Globalizimi.....	16
Integrimi European.....	17
Migrimi ndërkulturor	18
Prirjet Demografike.....	18
Performanca ekonomike	19
Ndryshimi teknologjik.....	19
Kapaciteti shtetëror	20
Karakterizimi individual	20
Mediatizimi	21
Ndjesia e pasigurisë.....	21
PJESA II - PROCES DHE AKTORË	23
Qytetaria.....	23
Pakënaqësia politike.....	23
Identiteti kulturor dhe protesta	32
Përfaqësimi	38
Partitë politike	38
Shoqëria civile	49
Vendimmarrja.....	60
“Ruajtja e rojeve”	60
Llogaridhënia ndër-nivelëshe	69
Mekanizma për konsultim të drejtpërdrejtë me qytetarët.....	73
PJESA III - REKOMANDIME PËR REFORMA	85
Hyrje	85
Udhëzime	89

“Lista jonë e dëshirave” për reforma të rekomanduara	91
1. Nënshtetësia universale	91
2. Votimi me mundësi zgjedhje	92
3. Llotari për zgjedhësit	93
4. Mandatet e përbashkëta	94
5. Organe Këshilluese te Specializuara të Zgjedhura	95
6. Kioskat e demokracisë	96
7. Këshilluesit e qytetarëve	97
8. Këshilli i Jo-Shtetasve	98
9. Të drejtat e votës për jo-shtetasit	100
10. Shërbimi qytetar	100
11. Edukimi për pjesëmarrje politike	102
12. Roje për të kontrolluar rojet	103
13. Roje të posaçme për rojet e medias	104
14. Liria e informacionit	105
15. Një dispozitë e “kartonit të verdhë” për legjislaturat	107
16. Papërputhshmëria e mandateve	108
17. Legjislacioni kuadër	109
18. Buxhetimi me pjesëmarrjen e qytetarëve	110
19. Një Kuvend Qytetarësh	111
20. Pragje të ndryshueshme për zgjedhje	113
21. Demokracia partiake	114
22. Kupona për financimin e organizatave në shoqërinë civile	115
23. Kupona për financimin e partive politike	118
24. Referendumet dhe nismat	119
25. Mbështetje elektronike për kandidatët dhe parlamentet (“votimi i zgjuar”).....	121
26. Sisteme të monitorimit elektronik dhe bashkëbisedimit online	122
27. Votimi me postë dhe votimi elektronik	124
28. Një agjent për promovimin e reformës demokratike	125
PËRFUNDIME	127

E ARDHMJJA E DEMOKRACISË NË EUROPË

Philippe C. Schmitter
Alexander H. Trechsel

Parathënie

Me rënien e murit të Berlinit u fashit dhe konflikti, që kishte pushtuar mendimet dhe veprimet tona rreth politikës për më shumë se një gjysëm shekulli. Europa, nga Perëndimi në Lindje, papritur u gjet në një hapësirë demokratike shumë më të madhe. Në këto rrethana favorizuese e të papara për demokracinë në Europë, si mund të shpjegohet pakënaqësia e përhapur gjerësisht ndër qytetarë me mënyrën se si “demokracia e vertetë dhe ekzistuese” po praktikohet në Europë. Reagimet e qytetarëve variojnë nga indiferencë dhe neglizhencë e plotë, në dyshim dhe mosbesim ndaj politikanëve, e deri në armiqësi të hapur ndaj “politikës”.

Për më tepër, qeveritë e sotme janë nën presionin e një numri të pafund forcash të jashtme, që kanë ndryshuar kontekstin në të cilin vepron demokracia liberale, dhe ato janë në vështirësi gjithnjë e më të mëdha për t’i përballur këto forca me institucionet dhe dispozitat ligjore tradicionale. Ndër këto forca përmendim globalizimin, integrimin European, migracionin ndërkulturor, zhvillimet demografike, ecurinë ekonomike, ndryshimet teknologjike, kapacitetin shtetëror, individualizimin e shoqërisë, mediatizimin dhe një ndjenjë mbizotëruese pasigurie për të ardhmen.

Në reflektim të këtyre sfidave, Këshilli i Europës themeloi një projekt 3-vjeçar të quajtur “Të vëmë në funksionim institucionet demokratike” (2002-04)¹ për të parë nga afër praktikat demokratike në shtetet anëtare si dhe për të propozuar rrugë dhe mjete për ta bërë atë më të aftë për t’u përgjigjur ndaj nevojave dhe pritshmërive të njerëzve. Pikërisht në kuadrin e këtij projekti Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës ngarkoi një grup akademikësh Europeanë dhe ekspertësh të tjerë të politikës për të shkruar librin *E ardhmja e demokracisë – trende, analiza dhe reforma*.

¹ Titulli në origjinal i projektit: “Making democratic institutions work.”

Libri është i ndarë në tre pjesë, ku Pjesa I trajton secilën prej forcave të përmendura më sipër duke i paraqitur ato si “sfida dhe mundësi”, me të cilat përballet demokracia. Pjesa II analizon “aktorët dhe proceset” demokratike në lidhje me “sfidat dhe mundësitë” e jashtme, si dhe me tendencat e brendshme të praktikave të demokracisë “së vërtetë ekzistuese”. Pjesa e fundit ofron një përmbyllje duke propozuar njëzetetete reforma, që kanë për qëllim të ndihmojnë në funksionimin e mirë të institucioneve demokratike, pra, forcimin e legjitimitetit të qeverisjes dhe dispozitave qeverisëse.

Reformat e propozuara nuk mbështesin asnjë parti të veçantë apo ideologji dhe nuk duhen konsideruar si përfundimtare. Edhe nëse do të zbatoheshin të gjitha njëkohësisht, ndoshta nuk do të eliminonin të gjitha pakënaqësitë e lidhura me “demokracinë e vërtetë ekzistuese”. Disa pakënaqësi janë tashmë të brendësuar nga demokracia dhe do të duheshin reforma të tjera për t’i luftuar si dhe për ta përshtatur atë ndaj sfidave dhe mundësive të tjera, që lindin.

Në parim, demokracia mbështetet tek qytetarë sovranë, procese transparente të vendimmarrjes dhe qeveritarë të përgjegjshëm. Edhe pse historikisht ka qenë shumë e vështirë për të realizuar këto parime, ato vazhdojnë të jenë udhërrëfyese për përmirësimin e cilësisë së demokracisë bashkëkohore në Europë dhe më gjerë. Pavarësisht nga diferencat në institucionet ekzistuese dhe shumëllojshmëria e kërkesave, që gjenerohen nga *Demos-²* gjithnjë e më i diversifikuar, ky botim tregon se ekzistojnë reforma konkrete, që janë të mundshme, madje të nevojshme, për t’i përmbushur këto parime.

Shpresojmë që *E Ardhmja e Demokracisë në Europë* do t’u vijë në ndihmë lexuesve për të përmirësuar të kuptuarit e tyre në lidhje me dilemat dhe vështirësitë e politikës bashkëkohore. Përveç kësaj, ky botim mund t’i motivojë ata për të vepruar fuqimisht dhe pozitivisht ndaj burimeve të pakënaqësive të tyre dhe të mundohen të reformojnë institucionet e demokracive të tyre “të vërteta ekzistuese”.

² Koncepti “Demos” përdoret për popullsinë ose elektoratin e një vendi [*shënim i përkthyesit*].

Hyrje

“Demokracia është një fjalë për diçka që nuk ekziston”

Karl Popper

Si për diçka, që nuk ekziston, për demokracinë sigurisht është folur shumë kohët e fundit. Për më tepër, të paktën në Europë, demokracia “e vërtetë ekzistuese” duket se ka një të ardhme premtuese, ndonëse po përballet me një diversitet të paprecedentë sfidash dhe mundësish. Çështja nuk është nëse sistemet politike kombëtare, nënkombëtare dhe mbikombëtare, që përbëjnë Europën, do të bëhen apo do të mbeten demokratike, por nëse cilësia e këtij rrjeti rajonal demokracish do të jetë e mjaftueshme për të siguruar mbështetjen vullnetare dhe përkrahjen legjitime të qytetarëve të saj. Sepse është tashmë e evidentuar më së miri që qytetarët e Europës, ndërsa mund të mos jenë dakord me praktikën e saj ekzistuese apo mund të mos e dinë se ç’është ajo në të vërtetë, nuk do të tolerojnë kurrsesi jo-demokracinë.

Mal governo, me këtë kuptohen regjimet, që nuk u përgjigjen nevojave, që përfshihen në praktika korruptive, që mashtrojnë në proceset elektorale, që ndalojnë apo manipulojnë liritë bazë dhe që refuzojnë të jenë përgjegjëse para qytetarëve të tyre, këto nuk kanë një të ardhme të sigurt në këtë pjesë të botës. Ato jo vetëm mund të rrëzohen nga revolta e qytetarëve të tyre, por këto veprime mund edhe të fitojnë mbështetjen e sistemeve politike kombëtare, nënkombëtare dhe mbikombëtare të rajonit.

Arsyeja kryesore për këtë optimizëm është e thjeshtë: demokratizimi i vendeve pranë Europës dhe përfshirja më pas e tyre brenda rajonit si një e tërë. Nuk ka krahasim më të mirë se zgjerimi i anëtarësisë së Këshillit të Europës nga 21 shtete në vitin 1988 në 45 shtete në vitin 2003 dhe zgjerimi i Bashkimit Europian (BE) nga 15 në 25 shtete në vitin 2004. Me suksesin e arritur nga përpjekjet kombëtare për ndryshimin e regjimeve në pjesën e saj Lindore, Europa është bërë dhe duhet të mbetet një zonë e zgjeruar e “paqes së përjetshme”, në të cilën të gjitha sistemet politike kanë mundësinë të zgjidhin dallimet e paevitueshme të interesave të tyre paqësisht nëpërmjet negociimit, kompromisit dhe vendimit gjyqësor.

Përveç kësaj, ekziston një rrjet i përpunuar mbarëeuropian institucionesh transnacionale, ndërqeveritare dhe joqeveritare në ndihmë të zgjidhjes së konflikteve të tilla dhe për të hartuar norma, që parandalojnë përsëritjen e tyre në të ardhmen.

Në mënyrë ironike, ky kontekst rajonal shumë më i favorshëm paraqet dilemat e veta për demokracinë. Shumë, në mos shumica, prej zhvillimeve më të rëndësishme historike në institucionet demokratike dhe praktikatat e ndjekura kanë ardhur bashkë me lufta ndërkombëtare, revolucion kombëtar dhe luftë civile. Fatmirësisht, asnjë prej këtyre mjeteve Arkimediane për të ngritur peshë ndryshime të përmasave të mëdha nuk po përdoren në Europën pacifiste të ditëve të sotme, edhe pse rebelimi kundër *Mal governo*, korrupsionit, demokracisë apatike apo të papërgjegjshme, është ende një mjet bazë shumë i arritshëm prej qytetarëve. Sipas supozimit tonë demokracia nuk mund të jetojë vetëm me paqe, edhe pse fuqizohet prej saj, por sidoqoftë mund të mësojë të reformojë institucionet dhe praktikatat e saj në një mënyrë të përshtatshme dhe të bashkrenduar. Ne nxjerrim pesë konkluzione prej kësaj gjendjeje të paprecendentë marrëdhëniesh.

Së pari, demokracitë e konsoliduara në Europën Perëndimore dhe Jugore do ta kenë gjithnjë e më të vështirë të legjitimojnë vetveten duke i krahasuar rezultatet e tyre me ato të ndonjë mënyre alternative dominimi, qoftë reale apo të imagjinuara. Tani që demokracia liberale është kthyer në normë në mbarë Europën dhe autokracia e hapur vazhdon vetëm në shtetet me kultura dhe struktura sociale shumë të ndryshme, standardet e vlerësimit se çfarë bëjnë qeveritë (dhe mënyrën e realizimit të atyre, që bëjnë) do të bëhen gjithnjë e më të “brendshme” për diskursin për teorinë e demokracisë normative, pra, për atë çka konceptime të ndryshme të demokracisë kanë premtuar në kohë dhe për çka qytetarë kanë luftuar kaq shumë në të shkuarën. Prandaj, duhet të jetë një tendencë drejt një konvergjence në institucionet formale dhe praktikatat informale brenda Europës, e cila nga ana e vet do të çojë drejt game më të ngushtë dhe më të lartë të standardeve politike.

Së dyti, demokracitë e reja në Europën Qendrore dhe Lindore dhe në pjesët perëndimore të ish-Bashkimit Sovjetik do ta kenë gjithnjë e më të vështirë të legjitimojnë vetveten duke pretenduar se janë kaq shumë të ngarkuara prej trashëgimive autokratike përkatëse, sa që ka mundësi të mos jenë në gjendje t’i respektojnë normat e sjelljes dhe të arrijnë nivelet e performancës të vendosura nga demokracitë e konsoliduara. Standardet, që qytetarët e tyre të çliuar para disa vitesh do të përdorin për të

vlerësuar qeveritarët e tyre, do të konvergojnë me shpejtësi me ato, që janë aktualisht në përdorim në pjesën tjetër të Europës³. Sistemet politike, që nuk arrijnë të përmbushin këto standarde, do të përballen më shpesh me rrëzime elektorale nga pushteti dhe ndoshta mund të kërcënohen nga rebelimi popullor, veç nëse qeveritarët e ardhur në pushtet rishtazi do të respektojnë rregullat e përcaktuara prej demokracive “të vërteta ekzistuese” në Perëndim.

Së treti, në të dyja rastet, sistemet politike të përfshira do të jenë zakonisht në gjendje të përmirësojnë cilësinë e institucioneve dhe praktikave të tyre demokratike respektive me anë të reformave të pjesshme dhe graduale. Për më tepër, këto reforma duhet të hartohen, miratohen dhe zbatohen sipas normave tashmë ekzistuese. Rrallë, ndoshta anjëherë, do të paraqitet rasti për një ndryshim më të thellë, në shkallë të gjerë apo “anormal”. Në fund të fundit, sa ndryshime të rregullave të demokracisë mund të priten prej qeveritarëve, të cilët kanë përfituar vetë prej këtyre rregullave? Rotacionet e zakonshme të partive dhe aleancave partiake brenda dhe jashtë pushtetit, në rastin më të mirë do të hapin mundësi modeste për ndryshim.

Së katërti, për këtë arsye ne duhet të udhëhiqemi nga “posibilizmi” në zgjedhjet tona në lidhje me reformat potenciale të institucioneve formale dhe praktikave informale. Ne do të merremi më pak me çfarë mund të dalë në mënyrë “probabiliste” prej sfidave dhe mundësive të ndryshme, me të cilat përballen demokracitë bashkëkohore, dhe do të merremi më shumë me atë, çka besojmë se është krejt e mundur për to – duke presupozuar që politikanët “e vërtetë ekzistues” mund të binden prej qytetarëve “të vërtetë ekzistues” që zbatimi i këtyre reformave do të çonte në një përmirësim të dukshëm të cilësisë së demokracive respektive.

Së fundmi, ne duhet të tregojmë vëmendje ndaj parimit të “efektit të tërthortë”, që nënkupton se ne nuk do të kufizohemi në vlerësimin vetëm të efekteve të mundshme të një reforme të vetme, por gjithmonë do të përpiqemi të duke përdorur aftësitë më të mira kolegjiale dhe ndërdisiplinore për të zbuluar ndërlidhjet dhe efektet e jashtme, që ka të ngjarë të shfaqen, nëse dhe kur disa reforma zbatohen ose njëkohësisht ose (çka është më e mundur) njëra pas tjetrës. Sikurse tha edhe njëri prej

³ Nuk ka nevojë të thuhet se rekomandimet dhe konventat e Këshillit të Europës duhet të luajnë një rol kyç në vendosjen dhe monitorimin e normave në të dyja këto grupe shtetesh.

autorëve gjatë diskutimeve “E rëndësishme është përzjerja e reformave” (cituar nga R.W.Rhodes).

Hipoteza jonë udhëzuese gjatë gjithë këtij libri do të jetë: e ardhmja e demokracisë në Europë mbështetet më pak në fortifikimin dhe përjetësimin e insitucioneve formale dhe praktikave informale ekzistuese dhe më shumë në ndryshimin e tyre. “Çfarëdolloj forme që të marrë, demokracia e pasardhësve tanë nuk do të jetë dhe nuk mund të jetë demokracia e paraardhësve tanë” (Robert Dahl). Me fjalë të tjera, me qëllim që të mbetet e njëjta, d.m.th. që të ruajë legjitimitetin e vet, demokracisë do t’i duhet të ndryshojë e të ndryshojë në mënyrë të dukshme – *pace* de Lampedusa – dhe kjo ka gjasa të ndikojë në të gjitha nivelet komplekse të bashkimit dhe pozicionet e vendimarrjes.

Këtu nuk ka asgjë të re. Demokracia i është nënshtruar një numri të madh transformimesh të rëndësishme në të kaluarën me qëllim ri-afirmimin e parimeve të saj kryesore: sovranitetit të qytetarëve të barabartë dhe llogaridhënien e qeveritarëve të pabarabartë. Kjo u rrit në shkallë nga qyteti-shtet në shtetin kombëtar; zgjeroi qytetarinë e vet nga një oligarki e ngushtë mashkullore në një publik të gjerë masiv të përbërë nga burra e gra; zmadhoi fushën e veprimtimit nga mbrojtja prej agresorëve dhe administrimin e drejtësisë në një shpallje të tërë politikash të shoqëruara me shtetin e mirëqenies.

Synimet tona në këtë libër janë:

- të identifikojmë sfidat dhe mundësitë, me të cilat përballtet demokracia bashkëkohore Europiane për shkak të ndryshimeve të shpejta dhe të pakthyeshme në kontekstet e saj kombëtare, rajonale dhe globale;
- të specifikojmë proceset dhe aktorët në insitucionet formale dhe praktikave informale, që po ndikohen prej këtyre sfidave dhe mundësive të jashtme si dhe prej rrymave të brendshme, që janë pjesë të vetë demokracisë.
- të propozojmë reforma potenciale dhe të dëshirueshme, që do të përmirësonin cilësinë e insitucioneve demokratike në Europë.

PJESA I

SFIDA DHE MUNDËSI

Nuk është aspak e pazakontë që demokracive Europiane u duhet të përballen me sfida dhe mundësi, që vijnë si pasojë e ndryshimeve të rëndësishme në mjediset e tyre të jashtme. Kjo ka ndodhur në mënyrë të përsëritur në të shkuarën dhe, pavarësisht nga kthimet mbrapa të rastësishme (këtu kujtojmë menjëherë periudhën midis dy luftërave botërore), ato kanë qenë shumë më të suksesshme se autokracitë në përballjen me kërcënime të tilla ndaj ekzistencës së tyre. Arsyet për këtë superioritet relativ janë të shumta.

E para, demokracitë gjenerojnë informacion më të saktë rreth interesave dhe pasioneve të qytetarëve të tyre. Ato mund të duken si më të diskutueshme dhe më pak eficiente në plan afatshkurtër – më saktë për shkak të lirive të tyre të të shprehurit, tubimin dhe peticionin - por ato do të jenë më të përgatitura për t'u përballur me ndryshime në preferencat dhe intensitetet individuale, kur u duhet të reformojnë institucionet dhe praktikatat e tyre.

E dyta, demokracitë kanë mekanizma të brendshëm të përgjegjshmërisë dhe gatishmërisë, çka nuk i lejon qeveritarët të reagojnë dobët apo në mënyrë të ekzagjeruar ndaj kërcënimeve të tilla të jashtme. Pavarësisht nga rreziku, shpesh i parë negativisht, i “populizmit”, interesat dhe pasionet e qytetarëve - të filtruara nëpërmjet konkurrencës dhe bashkëpunimit të politikanëve / përfaqësuesve të tyre - zakonisht rezultojnë në përgjigje më të matura dhe më të përshtatshme.

Me kalimin e kohës, dhe me shmangie të rastësishme, ata tentojnë të marrin vendime kolektive, të cilat konsiderohen legjitime, edhe prej atyre, që ndikohen negativisht prej këtyre vendimeve. Qytetarët mund të ankohen ndaj qeveritarëve të pavëmendshëm dhe joaktivë, por ata përgjigjen më me lehtësi ndaj asaj çka kërkohet prej tyre, në qoftë se do ta krahasonim me rastet më të përkryera të diktaturave dhe teknokracive, sepse të drejtat e tyre politike janë më të mbrojtura dhe, prandaj, ata kanë më shumë besim se do të jenë në anën e fituesve në të ardhmen.

Dikush mund të thotë se sfidat dhe mundësitë e inkomporuara në kontekstin e sotëm Europian janë jashtëzakonisht të ndryshme dhe të forta. Sigurisht që ne jemi të destinuar të jetojmë në “kohëra interesante”, në të cilat norma, shkalla dhe gjerësia e ndryshimit duken të

paprecendentë dhe, çka është më e rëndësishmja, përtej kufijve të njësive tradicionale, që kanë dominuar derimëtanë paisazhin e saj politik. Shumica e problemeve të sotme janë ose shumë të mëdha ose shumë të vogla për shtetet sovraane kombëtare të së shkuarës, dhe prandaj brenda Europës janë bërë një numër i pafund eksperimentimesh me krijimin e njësive më të vogla politike apo me integrimin në njësi më të mëdha. Për herë të parë, njohja e nivelit të bashkimit, në të cilin duhet të kryhen reformat, është bërë pothuaj po aq e rëndësishme sa edhe njohja e përmbajtjes së vetë reformave. Pyetja klasike *Que faire?* duhet të plotësohet me pyetjen *Ou faire?*

Për më tepër, për arsye se ato vijnë një “mjedis relativisht i paqtuar”, demokracitë në fjalë do të hasin vështirësi të mbështeten në masat e “emergjencës” apo në pezullimet “e përkohshme” me qëllim që të realizojë reforma, të cilat hasin në opozitë të fortë. Duke supozuar që qeveritarët do të jenë të tunduar të rrisin sensin e urgjencës duke nxjerrë në pah kërcënime të reja mbi sigurinë dhe përgjigjet ndaj tyre (të tilla si “lufta kundër drogës”, “lufta kundër terrorizmit”, apo “frika ndaj të huajve”), si dhe t’i shfrytëzojnë ato për të zbatuar reforma anti-demokratike. Por shumëllojshmëria e burimeve të informacionit dhe konkurrenca ndërmjet politikanëve duhet ta kufizojnë këtë mundësi në demokracitë, të cilat funksionojnë mirë. Problemi kyç është gjetja e vullnetit për të reformuar rregullat ekzistuese pikërisht me qeveritarët, të cilët kanë përfituar prej tyre dhe që zakonisht nuk mund të detyrohen për të vepruar kështu për shkak të një kërcënimi të jashtëm të fuqishëm në lidhje me sigurinë e tyre apo mbajtjen e postit.

Një çështje e përgjithshme dominon të gjitha spekulimet rreth të ardhmes së demokracisë: sa arrijnë të “përshtaten” institucionet formale të sanksionuara dhe praktikatat informale me dispozitat sociale, ekonomike, kulturore, dhe teknologjike, që e rrethojnë dhe ndryshojnë shumë shpejt, nga të cilat demokracia varet si në aspektin material ashtu edhe në atë normativ? Le të hedhim një shikim të shkurtër mbi “dyshimet e zakonshme” në atë kontekst rrethues.

Globalizimi

Përkufizim. Një tërësi transformimesh të kohëve të fundit në nivelin makro, të cilat tentojnë të grupohen sëbashku, të përforcojnë njëri-tjetrin dhe të prodhojnë një impakt të mbledhur pëshpejtues. Të gjitha këto ndryshime kanë të bëjnë me inkurajimin e numrit dhe variacionit të shkëmbimeve midis individëve dhe grupimeve sociale përtej kufijve

kombëtare duke i ngjeshur ndërveprimet e tyre në kohë dhe hapësirë, duke ulur kostot e tyre dhe duke kapërcyer barrierat e mëparshme – disa prej tyre teknike, disa gjeografike, por shumica politike. Mbas gjithë sa thuhet, forcat lëvizëse pas globalizimit janë ekonomike. Megjithatë, pas fuqisë së madhe së konkurrencës së rritur të tregut dhe inovacionit teknologjik për të mira materiale dhe shërbime shtrihen një seri vendimesh prej autoriteteve politike shtetërore për t'i toleruar, inkurajuar dhe ndonjëherë subvencionuar këto shkëmbime. Kjo është bërë shpesh duke hequr pengesat e mëparshme të lidhur me politikat, pra duke asociuar konceptin e globalizimit me atë të liberalizimit. Manifestimet e ditëpërditshme të globalizimit duken kaq të natyrshme dhe të paevitueshme sa që ne shpesh harrojmë se ato janë produkte të vendimeve të paramenduara prej qeverive, që mesa duket kuptuan pasojat e vendimeve për të *laisser passer* dhe *laisser faire*.

Hipoteza rivale udhëzuese: (1) Globalizimi ngushton mundësinë potenciale për t'u përgjigjur me politika, minon kapacitetin e shteteve (jo më) sovrane për t'u përgjigjur në mënyrë të autonome ndaj kërkesave të qytetarëve të tyre dhe, gjithashtu, dobëson legjitimitetin e ndërmjetësuesve politikë tradicionale dhe autoriteteve shtetërore; (2) Globalizimi zgjeron burimet e disponueshme për aktorët joqeveritarë, të cilët veprojnë përtej kufijve shtetërorë, zhvendos përgjegjësinë për politikat në një nivel më të lartë tek aktorët transnacionale, pothuaj shtetërorë. Të dyja këto minojnë dispozitat e vendosura oligarkike dhe nxisin përhapjen e normave të reja transnacionale për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe “qeverisjen e mirë”.

Integrimi European

Përkufizim. Ndikimi i drejtpërdrejtë i direktivave dhe rregullave të Bashkimit European mbi vendet anëtare, kandidatë dhe fqinje, dhe efekti i tërthortë i ndërveprimeve të vazhdueshme e të shumta të aktorëve Europeanë të rëndësishëm politikisht, këto tentojnë të prodhojnë një konvergencë graduale drejt normave dhe praktikave të përbashkëta, pra një pakësim të larmisë së vazhdueshme të normave dhe praktikave, që kanë karakterizuar “rajonin” European historikisht.

Hipoteza rivale udhëzuese. (1) Integrimi European tenton të minojë praktikën kombëtare të konsoliduara të pjesëmarrjes dhe përgjegjshmërisë demokratike pa i zëvendësuar ato me praktika mbikombëtare, që korrespondojnë nga natyra dhe rëndësia; (2) Integrimi European, nëpërmjet “kushtëzimit”, që imponon mbi shtetet kandidatë dhe anëtare,

dhe supremacisë ligjore të ligjit European mbi normat në shtetet anëtare ekzistuese, tenton të nxisë standarde më të larta dhe më uniforme të performancës demokratike në nivel kombëtar dhe nënkombëtar.

Migrimi ndërkulturor

Përkufizim. Zhvendosjet vullnetare apo jovullnetare të personave përtej kufijve kombëtarë, të cilët më parë ishin më të mbyllur dhe të ruajtur, dhe qëndrimi i përhershëm i një numri gjithnjë në rritje i të huajve, veçanërisht i atyre me origjinë jo Europiane, brenda shoqërive Europiane.

Hipoteza rivale udhëzuese. (1) Mërgimi dhe bashkëekzistenca e kulturave më parë të ndara nga njëra-tjetra tentojnë të gjenerojnë një reagim negativ në pjesën e banorëve “vendas” të vendeve Europiane më homogjene nga kultura. Kjo shprehet në lëvizjet ksenofobike, partitë politike ultra-nacionaliste dhe incidentet me motive raciale, të cilat minojnë autoritetin e organizmave dhe agjencive politike në vend dhe i detyrojnë qeveritë kombëtare (sipas rastit, edhe ato mbikombëtare) të adoptojnë politika frenuese përse i përket imigracionit. Kjo ka një impakt dytësor në të drejtat e qytetarëve e vendit dhe në stabilitetin e konkurrencës politike ekzistuese; (2) Mërgimi dhe bashkëjetesa e të huajve kanë një impakt pozitiv mbi praktikën e demokracisë në disa nivele të bashkimit, meqë ata diversifikojnë bazat e konkurrencës politike, detyrojnë qeveritarët t’u kushtojnë vëmendje çështjeve të injoruara më parë dhe, në afat të gjatë, kontribuojnë për formimin e identiteteve kolektive më të larmishme dhe për formimin e qytetarëve më tolerantë.

Prirjet Demografike

Përkufizim. Ndryshim në profilin demografik të shoqërive Europiane në drejtimin e nivelit më të ulët të lindjeve dhe rritjes së pjesës së moshuar të popullsisë.

Hipoteza rivale udhëzuese. (1) Njerëzit e moshuar janë më të prirur të votojnë, të anëtarësohen në shoqata dhe kështu të sigurojnë influencën politike, që u duhet për të përvetësuar një pjesë gjithnjë e më të madhe të fondeve publike dhe politikave përfituese veten e tyre. Kjo çon në pakënaqësinë e rinisë ndaj politikës pasi qeveritarëve u duhet t’u kushtojnë gjithnjë e më shumë vëmendje ndaj të moshuarve (edhe ata vetë janë gjithnjë e më të moshuar); (2) Lëvizjet demografike, veçanërisht në impaktin e tyre territorial (dhe kur kombinohen me kompensim nëpërmjet imigracionit të të huajve), po shkaktojnë ri-shpërndarje, që

duhet të ishin bërë shumë kohë më parë, në përfaqësimin politik dhe politikatat publike, të cilat do të rrisin legjitimitetin e regjimeve dhe forcojnë ecurinë ekonomike – duke supozuar që të rinjtë e pakënaqur politikisht bëhen më pas qytetarë të angazhuar.

Performanca ekonomike

Përkufizim. Efekti i kombinuar i disa komponentëve ekonomikë, përfshirë përqindjet e rritjes, nivelet e punësimit, përqindjet e inflacionit dhe shpërndarjet e të ardhurave dhe pasurisë, mbi perceptimet e qytetarëve për mirëqënien individuale dhe kolektive.

Hipoteza rivale udhëzuese. (1) Rënia e performancës ekonomike në Europë, veçanërisht në krahasim me atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, çon në perceptimin nga ana e qytetarëve se institucionet e tyre demokratike po u shërbejnë keq dhe se ato duhet të reformohen në një drejtim më shumë “amerikan”; (2) Rënia e performancës ekonomike relative dhe objektive nuk perceptohet si një rënie në cilësinë e jetesës, prandaj çon në ri-afirmimin e shquarjes dhe vlerës së institucioneve politike “më pak liberale” të Europës (kontinentale).

Ndryshimi teknologjik

Përkufizim. Difuzioni i shpejtë, i paparashikueshëm dhe i pakontrollueshëm i ndryshimeve në teknologji përtej kufijve politikë - qoftë nga dijet e përbashkëta apo nga konkurrenca tregtare - dhe impakti i këtij difuzioni në mënyrën si qytetarët, përfaqësuesit dhe qeveritarët shkëmbejnë informacion dhe komunikojnë midis tyre dhe me njëri-tjetrin.

Hipoteza rivale udhëzuese. (1) Përsheptimi në ndryshimet teknologjike, veçanërisht në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, ul koston absolute të shkëmbimeve, mbron autonominë e përdoruesve dhe ul pabarazitë relative në mundësitë e shfrytëzimit nga ana e qytetarëve dhe midis tyre, përfaqësuesve dhe qeveritarëve të tyre; si rrjedhim jo vetëm rritet barazia politike, por edhe bëhet më e lehtë për t'i mbajtur qeveritarët në pozita më të përgjegjshme; (2) Ky ndryshim i përshpejtuar teknologjik vetëm ul kostot e përçimit për një segment të privilegjuar personash në shtetet e favorizuara dhe krijon pabarazi më të mëdha midis atyre, që kanë mundësi, dhe atyre, që nuk kanë mundësi ta shfrytëzojnë atë; si rrjedhim, shtohen elemente të reja të diskriminimit dhe gabime (shmangie) në procesin politik.

Kapaciteti shtetëror

Përkufizim. Aftësia e institucioneve ekzistuese qeverisëse permanente, veçanërisht në nivel kombëtar, për të zbatuar në mënyrë efektive dhe autonome (“në një mënyrë sovrane”) detyrat, që qeveritarët u kanë caktuar dhe që qytetarët presin të përmbushen prej tyre.

Hipoteza rivale udhëzuese. (1) Në kontekstin e sotëm ndërkombëtar/ndërshtetëror (shiko në këtë listë veçanërisht titujt “globalizimi”, “integrimi European”, “ndryshimi teknologjik”, dhe “sensi i pasigurisë”) institucionet qeverisëse të shteteve më parë sovrane e kanë gjithnjë e më të vështirë për të nxjerrë burime të mjaftueshme, të rregullojnë sjelljen dhe, kështu, të përmbushin pritshmëritë e qytetarëve të tyre në mënyrë efektive dhe eficiente - dhe kjo shkakton një rënie në prestigjin dhe legjitimitetin e qeveritarëve; (2) Ndërsa ndryshimet e sipërpërmendura në kontekstin e jashtëm kufizojnë performancën e shteteve kombëtare, ato gjithashtu përmbajnë nxitshmëri për zhvendosur detyrat qeverisëse në të dyja nën- dhe mbikombëtare të e bashkimit dhe këto institucione “përtej dhe nën” shtetet kombëtare janë duke u bërë gjithnjë e më të afta për të përmbushur pritshmëritë e qytetarëve dhe po gjenerojnë legjitimitet politik.

Karakterizimi individual

Përkufizim. Kalimi - si pasojë e ndryshimeve në kushtet e punës, kontekstet e jetesës, mobilitetin personal dhe strukturën familjare – përsa i përket identitetit dhe veprimit kolektiv prej kategorive të mëdha “shumëpërfshirëse” social-politike të krijuara historikisht si klasa, raca, feja, ideologjia dhe kombësia në konceptime shumë më të fragmentuara dhe personalizuara të interesit vetjak dhe pasioneve kolektive.

Hipoteza rivale udhëzuese. (1) Karakterizimi individual në nivelin e interesave dhe pasioneve minon prirjen e qytetarëve për të mbështetur, për t’u bashkuar dhe vepruar së bashku me organizata politike më shumëpërfshirëse si partitë, sindikatat dhe lëvizjet nacionaliste; ai prodhon një strukturë të shoqatave ndërmjetësuese, që, ndryshe e nga në të kaluarën, është më e specializuar në qëllim dhe më pak e lidhur me veprimin; ai çon në një rënie në aftësinë e sistemeve politike ndjekur interesat kryesore “të përgjithshme” ose “publike” dhe, përfundimisht, në një rënie të legjitimitetit të demokracisë; (2) Karakterizimi individual mund të minojë format tradicionale të veprimeve kolektive, por ai ofron nxitshmëri të fuqishme për të krijuar struktura ndërmjetësuese të reja, të cilat janë më fleksibël, sigurojnë pjesëmarrje në vendimmarrjet e tyre, të

afta për të formuar (dhe riformuar) rrjete për prodhimin e të mirave publike me interes të përgjithshëm, dhe kjo çon në legjitimitetin e formave të reja të demokracisë.

Mediatizimi

Përkufizim. Prirja për të siguruar informacion rreth politikës dhe për të marrë mesazhe politike ekskluzivisht nga një shumicë burimesh në mediat masive, por veçanërisht nga televizioni dhe interneti, që janë në një garë komerciale me njëri-tjetrin për vëmendjen e konsumatorit dhe përfitimin e pronarëve.

Hipoteza rivale udhëzuese: (1) Mediatizimi shkatërron mekanizmat e vendosur më parë, me anë të të cilëve qytetarët diskutojnë rreth politikës direkt me njëri-tjetrin (dhe fëmijët e tyre) dhe përftonin informacion dhe një identitet të përafërt nëpërmjet ndërmjetësve veçanërisht publikë dhe politikë siç janë partitë, shoqatat dhe bashkësitë; ai i zëvendëson ato me një nyje lidhëse komerciale, që e banalizon informacionin rreth politikës dhe shfrytëzon më shumë veprimet e tyre personale sesa ato politike; (2) Numri në rritje i burimeve, privatizimi i pronësisë dhe konkurrenca ndërmjet firmave për vëmendjen e konsumatorit çliron mediat nga kontrolli i qeveritarëve dhe i izolon ato prej manipulimeve partizane; si rrjedhim krijohet një “sferë publike” më e larmishme dhe më e kapshme, prej së cilës qytetarët mund marrin informacion më lehtë dhe në të cilën ata mund të marrin pjesë virtualisht me një kosto më të ulët dhe me më pak mund.

Ndjesia e pasigurisë

Përkufizim. Një rritje në perceptimin e rreziqeve të mënjanueshme dhe përmasave të pasojave të mundshme për individë dhe grupime të cënueshme, shkaktuar ose nga kërcënimet e jashtme ndaj një shoqërie të caktuar, ose nga sjelljet shkatërrimtare të bashkëqytetarëve në të njëjtën shoqëri.

Hipoteza rivale udhëzuese: (1) Manipulimi nga ana e qeveritarëve e kësaj ndjesie pasigurie, veçanërisht i ndjesisë së shkaktuar nga aktorë të huaj jo-shtetërorë (siç janë terroristët), kufizon liritë bazë dhe promovon sjellje agresive (“parandaluese”), që minon institucionet e përgjegjshmërisë së qeveritarëve ndaj qytetarëve dhe shtrembëron konkurrencën dhe bashkëpunimin e përfaqësuesve demokratikë; (2) Përpjekjet e qeveritarëve për të shfrytëzuar pasigurinë me qëllim shmangien e përgjegjshmërisë do të çojnë në një reagim nga grupet

deritani apatike të qytetarëve, të cilët do të ringjallin partitë e mëparshme, shoqatat dhe (veçanërisht) lëvizjet në mbrojtje të lirive të kërcënuara dhe të hedhë bazat për krijimin e organizatave të reja ndërmjetësuese.

PJESA II

PROCESE DHE AKTORË

Mes teoricienëve dhe profesionistëve të Europës bashkëkohore qarkullojnë të paktën tre “modele” të përgjithshme për demokracinë. Çdonjëri prej tyre e vendos përgjegjësinë kryesore tek llojet e ndryshme të aktorëve dhe proceseve të vendimmarrjes. Për të drejtuar mendimin tonë kolektiv në lidhje me sfidat dhe mundësitë, që hasen nga këta aktorë dhe procese, ne propozojmë që të përdorim një përkufizim të përgjithshëm funksional, që nuk na “mbërthen” tek ndonjë format institucional i veçantë apo rregulla të veçanta të vendimmarrjes.

Duke lënë të hapura çështjet kryesore siç janë mënyra se si qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre, cilat janë mekanizmat më efikase të dhënies së llogarisë dhe si merren vendimet, që janë të detyrueshme për të gjithë, ky përkufizim nuk përjashton vlefshmërinë e atyre, që ne më vonë do t'i quajmë demokraci “numerike”, “negociuese” apo “të vullnetshme”. Këto do të zhvillohen në Pjesën e III-të.

Demokracia politike moderne është një regjim ose sistem qeverisjeje, ku sunduesit japin llogari për veprimet, që bëjnë në jetën publike, para qytetarëve, të cilët veprojnë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nëpërmjet konkurrimit dhe bashkëpunimit të përfaqësuesve të tyre.

Ky përkufizim na jep një ndarje pune trepalëshe. Tre lloje aktorësh kombinohen në një seri procesesh për të prodhuar *summum bonum* të demokracisë politike, bëhet fjalë për dhënien e llogarisë. Prandaj, ne e kemi ndarë analizën e transformimeve dhe reagimeve mes atyre, që ndikojnë në qytetarinë, përfaqësimin dhe vendimmarrjen.

Qytetaria

Pakënaqësia politike

Sot, një ndër tiparet më spikatese të demokracive europiane është prania e një ndjenje të pakënaqësisë politike, distancimit, skepticizmit, mospërmbushjes dhe cinizmit, mesa duket goxha e përhapur ndër qytetarë europianë. Këto reagime nuk janë, ose nuk janë vetëm, të përqendruara tek një parti politike, qeveri apo politikë publike e caktuar. Ato vijnë si rezultat i një perceptimi negativ, madje armiqësor, për


politikanët, zgjedhjet, parlamentet dhe qeveritë në përgjithësi. Pra, për të gjithë spektrin politik.

Pakënaqësia politike manifestohet në opinione, qëndrime apo veprime. Disa qytetarë i shprehin zhgënjimet e tyre politike ose inatet politike në bisedat e përditshme me miqtë apo të afërmit. Studiuesit e shkencave sociale përpiqen që t'i analizojnë këto opinione me anën e sondazheve ose intervistave të hollësishme. Sa më të forta që të jenë këto opinione dhe qëndrime, aq më shumë është e mundshme që këto të çojnë drejt veprimeve konkrete. Në sferën politike këto veprime janë shpesh “mosveprime”. Shumë qytetarë të pakënaqur apo të inatosur refuzojnë që të votojnë ose të përfshihen në parti politike. Disa të tjerë thonë se janë aq shumë të inatosur me politikanët (e vjetër) apo partitë politike (të konsoliduara) sa kanë ndërmend që t'ia japin votën dikujt jashtë këtyre strukturave apo ndonjë partie politike radikale ose protestuese. Prandaj ka më shumë mundësi që votuesit e pakënaqur të bëjnë zgjedhje elektorale të paqëndrueshme, gjë që shpjegon pjesërisht nivelin e lartë e të paprecedentë të përmbysjes së përbërjes së qeverive.

Pavarësisht në janë të shprehura me anën e bisedave, sondazheve apo intervistave, opinionet mund të jenë (pak a shumë) të brishta, të ndryshueshme, të varura nga konteksti, madje edhe artificiale. Për këtë arsye veprimet janë më të rëndësishme sesa fjalët. Edhe pse pjesëmarrja në zgjedhje ndikohet nga shumë faktorë dhe nuk mund të shpjegohet vetëm me kënaqësinë apo pakënaqësinë politike, evoluimi i pjesëmarrjes elektorale mund të na japë një këndvështrim të përgjithshëm, por informativ, mbi përhapjen dhe rritjen e pakënaqësisë politike.

Pjesëmarrja “europiane” në votime u pakësua nga 88% në 1980 në 74% në 2002, madje edhe 70% në 2000. Pjesëmarrja në zgjedhje është duke rënë – ka marrë një tatëpjetë të butë në të gjitha vendet, përveç Danimarkës. Nëse bëjmë një përlllogaritje duke patur parasysh prirjen e deritanishme, pjesëmarrja në vitin 2020 do të jetë afërsisht 65%, madje edhe më e vogël, nëse do të kemi parasysh moshën e votimit të popullsisë dhe jo votuesit e regjistruar. Rënia e pjesëmarrjes në zgjedhje është akoma më e madhe në Europën Qendrore dhe Lindore. Në këtë rajon mesatarja e pjesëmarrjes lëviz prej rreth 70% në fillimin e viteve 1990 tek 60% vetëm dhjetë vite më pas. Mund të zbrësë tek rreth 45% në fillim të viteve 2020-të, nëse përlllogarisim ritmin e evoluimit gjatë kësaj periudhe të shkurtër. Këto konkluzione mbështeten edhe nga sondazhet e opinionit publik, të cilat tregojnë një prirje të qartë në rënie të besimit për parlamentet në Europë.

Figura 1 - Pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare në Europën Perëndimore dhe Lindore.



Burimet: Banka e të dhënave e International Idea - Pjesëmarrja në votime prej 1945 deri në ditët e sotme (<http://www.idea.int/vt/index.cfm>) dhe banka e të dhënave të Universitetit të Essex-it – Transformimi politik dhe procesi elektoral në Europën postkomuniste (<http://www.essex.ac.uk/elections/>)

Figura 1 mat evoluimin e mesatares së përvitshme të pjesëmarrjes në zgjedhjet parlamentare të të gjitha vendeve të Këshillit të Europës duke nisur nga viti 1980. Bazohet tek të dhënat elektorale të vendeve anëtare, që kanë një popullsi më të madhe se një milion dhe që ishin anëtare të Këshillit të Europës para vitit 1980 (Austria, Belgjika, Danimarka, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar). Ky grupim është padyshim artificial, por ilustron prirjen e përgjithshme të rënies së pjesëmarrjes elektorale në Europë dhe, për pasojë, ilustron pakënaqësinë elektorale në rritje, që shkakton pjesërisht pjesëmarrjen në votime. Në mënyrë të ngjashme janë përpunuar edhe të dhënat për Europën Lindore dhe Qendrore duke marrë parasysh pjesëmarrjen në votime gjatë zgjedhjeve elektorale në shtatë shtete (Bullgari, Çeki, Hungari, Lituan, Poloni, Rumani, Sllovaki). Janë përzgjedhur këto shtete, sepse kanë popullsi prej më shumë se një milion banorësh dhe kanë qenë anëtare të Këshillit të Europës për më shumë se dhjetë vite pas 1990-ës.

Megjithatë, qëndrimet ndaj sferës politike janë më të paqarta sesa mund të duket nga opinionet e pakënaqësisë. Partitë politike kombëtare dhe politikanët e nivelit qendror, të cilët mund të quhen ndryshe aktorë politik të specializuar dhe të profesionalizuar, kritikohen më shumë sesa ata, që janë në nivel vendor. Me fjalë të tjera, njerëzit bëjnë dallime, kur bëhet fjalë për nivele apo dimensione politike. Disa prej tyre, që u përkasin kryesisht shtresave social-kulturore mbimesatare, vënë re ndryshime midis komponentit të “bërjes politike”, gjë që nënkupton partitë, politikanët, zgjedhjet, rivalitetet dhe luftën për pushtet, dhe një aspekti jo-politik ose më pak politik, që lidhet me projektet, programet, çështjet, idetë, parimet, bindjet dhe përpjekjet për të zgjidhur problemet. Kur njerëzit e kësaj kategorie kritikojnë politikën, ata zakonisht (në mënyrë të heshtur) e kanë fjalën për dimensionin e parë dhe nuk kritikojnë dimensionin e fundit. Disa nga këta qytetarë të pakënaqur janë të gatshëm që të besojnë tek politika, kur një lider ose parti u duket “ndryshe” ose kur bëhet fjalë për çështje të rëndësishme (terrorizëm, fashizëm, shtet social).

Mënyra sesi njerëzit perceptojnë dhe kritikojnë sferën politike varet nga investimet dhe shprehjet e tyre politike. Mund të dallohen dy lloje të ndryshme pakënaqësie: një lloj, që është i përhershëm dhe goxha i thjeshtë, dhe një lloj tjetër, që është më i ndërlikuar. Lloji i parë ka qarkulluar për një kohë të gjatë para se politikanët dhe politologët të fillonin të shqetësoheshin për mosbesimin ndaj institucioneve dhe aktorëve politikë. Është më i vjetër sesa ndryshimet politike (për shembull globalizimi, “de-lokalizimi”, “kriza” e kapaciteteve të shtet-kombeve, papunësia në rritje, integrimi evropian), që shpesh konsiderohen si shpjegues të pakënaqësisë politike. Pakënaqësi të këtij lloji dallohen lehtë, mbase tepër lehtë, nga sondazhet e opinionit publik. Të intervistuarit, që kanë këto pikëpamje u përkasin, të paktën në aspektin statistik, segmenteve të caktuara të publikut, që karakterizohen nga:

- një nivel relativisht i ulët (por disi i pabarabartë) i arsimit, i statusit social, i informimit politik dhe sofistikimit si dhe nga një ndjesi paaftësie politike personale;
- mungesa e një preference politike të qartë dhe nga paaftësia për të kuptuar dallimet, që ekzistojnë midis politikanëve dhe partive;
- frika e të qenurit pronë e politikanëve si pasojë e kësaj paaftësie;
- një mungesë interesi për politikën, që i çon të mendojnë dhe të deklarojnë se politika nuk e meriton vëmendjen e tyre;

- një vizion i cekët i politikës, që ka të bëjë kryesisht me dimensionin e sipërpërmendur të “të bërit politikë”, si pasojë dhe si shkaktar i kësaj mungese interesi;
- kushte jetese shumë të këqija, që i shtynjë njerëzit të mendojnë se politikanëve nuk u bëhet hiç vonë për ata dhe, për këtë arsye, politika nuk ka rëndësi.

Në të njëjtën kohë ka njerëz të tjerë, që shprehin ndjenja pakënaqësie më të sofistikuara. Ndryshe nga ata, që mund të bëjnë pjesë në kategorinë e mëparshme, këta njerëz u referohen lëvizjeve të ndryshme të sferës politike. Ata thonë, për shembull, që “sot nuk ka shumë dallime midis partive politike”, “partitë e majta dhe të djathta në këtë kohë janë shumë të ngjashme; ato ndjekin dhe drejtojnë të njëjtat politika”, “politika është gjithnjë e më e zbehtë”, “ajo nuk është më e rëndësishme, ajo, që ka rëndësi tanimë, është ekonomia”, “shtet-kombet nuk mund të bëjnë gjë ndaj firmave, që vendosin që të zhvendosen”, ose që “BE-ja vendos për gjithçka”. Këto janë opinionet e atyre, që thonë se dikur ishin të interesuar për politikën, por tani janë shumë më pak të interesuar dhe se preferencat e tyre politike janë venitur. Megjithatë, ata kanë preferenca të forta negative, domethënë kundërshtojnë me forcë disa parti politike. Gjithashtu, ata i kushtojnë mjaftueshëm vëmendje politikës sa të mund të kritikojnë aktorët duke përdorur argumente të mbështetura në fakte. Njerëzit, që mund të klasifikohen në këtë kategori kanë një nivel shkollimi më të lartë (jo patjetër shumë të lartë). Në lidhje me politikën ata kanë më shumë interes, janë më të informuar dhe janë më të sigurtë se mund ta menaxhojnë politikën më mirë se ata, që janë në kategorinë e parë, si dhe kanë një këndvështrim më kompleks, diakronik bile dhe vlerësues për të.

Shkaqet dhe shpjegimet e pakënaqësisë politike

Pakënaqësia politike rrjedh prej një serie faktorësh, që konvergojnë me njëri-tjetrin.

Arsimi. Sa më i lartë të jetë niveli i arsimimit, aq më i lartë është niveli i kompetencës politike. Sa më të larta të jenë aftësitë politike subjektive dhe objektive, aq më të larta janë kapacitetet dhe prirjet për të kritikuar. Rritja e kompetencës konjitive mes qytetarëve çon në rritjen e kapaciteteve për kriticizëm si dhe në gatishmërinë për të kritikuar, nëse diçka shkon keq. Një popullsi më e arsimuar ka një mendje më kritike dhe

ka potencialisht më shumë kërkesa nga liderët dhe përfaqësuesit e saj politik. Gjithashtu, qytetarët më të arsimuar në mënyrë të heshtur dëshirojnë të jenë më aktivë edhe pse ata nuk janë gati që të investojnë kohë dhe energji, kur atyre u kërkohet realisht që të marrin pjesë në diçka. Për këtë arsye ka kërkesa reale për forma më domethënëse dhe të drejtpërdrejta, paçka se janë disi të dykuptimshme. Një ndër efektet reale është mbase fakti që rëndësia e të votuarit për përfaqësuesit, që është forma kryesore e pjesëmarrjes politike, do të bjerë. Një numër i vogël, por mesa duket në rritje, qytetarësh (relativisht) të arsimuar, janë duke kërkuar pak a shumë për më shumë mundësi për të shprehur opinionin e tyre dhe për të vendosur vetë për çështje me rëndësi.

Ndryshimi i vlerave. Qytetaritë europiane, ose të paktën segmente të mëdha të tyre, duket se kanë lëvizur nga respekti për autoritetin dhe autoritetet tek skepticizmi ndaj elitave dhe institucioneve. Po për arsye të shumta dhe të ndërlikuara, për një kohë të gjatë është përhapur një tolerancë gjithëpërfshirëse si dhe një refuzim i normave dhe autoritetit social. Një kulturë gjithnjë në rritje e të drejtave, barazisë, autonomisë personale bie në një farë mënyre në kontradiktë me respektin, përlulen, disiplinën, hierarkinë dhe lidërsipin, që organizon marrëdhënien qytetar-përfaqësues në një demokraci përfaqësuese.

Lëvizjet ekonomike. Rritja ekonomike ka qenë e dobët gjatë tre dekadave të fundit. Papunësia është rritur. Për vite me radhë rrogat reale kanë mbetur në të njëjtin nivel ose janë rritur shumë pak. Rënia e barrierave tregtare, kostove të transportit dhe përmirësimi i komunikimit ka rritur rolin e tregtisë dhe investimit ndërkombëtar në të gjitha ekonomitë. Konkurrenca globale sjell avantazhe të ndryshme për një kategori, por sjell gjithashtu zhvendosjen e firmave në vende ku rrogat janë të ulta, uljen e rrogave në vendet e zhvilluara dhe presione konkurruese nga lart-poshtë mbi standardet e punës. Teknologjitë e reja janë gjithashtu duke gërryer rrogat e krahut të specializuar të punës edhe pse ato ndihmojnë në të njëjtën kohë, që të krijojnë vende të reja pune për njerëz të përgatitur. Globalizimi ka sfiduar mundësinë e shteteve për të vendosur rregulla efektive në fushën ekonomike dhe sociale. Institucione të reja si Bashkimi Europian dhe Organizata Botërore e Tregtisë kanë dobësuar autoritetin për bërje politikash nga ana e shtet-kombeve. Ato gjithashtu kanë sugjeruar se shtet-kombet mund të bëhen aktorë kolektivë më pak të rëndësishëm. Shtet-kombet janë zhvlerësuar gjithashtu edhe nga liberalizimet dhe privatizimet. Në të njëjtën kohë qeveritë janë përballur me një “krizë fiskale” dhe janë përpjekur që të balancojnë

buxhetet duke kufizuar shpenzimet e sektorit publik. Shërbimet sociale janë zvogëluar ose të paktën zgjerimi i tyre ka marrë fund.

Një numër gjithnjë e më i madh qytetarësh janë përballur gjithnjë e më shpesh me probleme, që vijnë si rezultat i konkurrencës ekonomike globale, krizës ekonomike dhe pakësimit të mbrojtjes sociale. Ata, që në mënyrë personale ose nëpërmjet të afërmeve kanë pësuar ose kanë frikë nga papunësia, si dhe ata, që mendojnë se gjendja e tyre ekonomike do të përkeqësohet, kanë prirje që të kenë një perceptim më negativ për politikën. Njerëzit, që tashmë kanë menduar se politika nuk mund të përmirësojë jetën e tyre dhe se nuk ke se çfarë të presësh nga politika, kanë vënë re se opinionimi i tyre është vërtetuar.

Dhimbjet dramatike apo shumë të mprehta, qofshin “objektive” apo “të imagjinuara” siç janë rëniet ekonomike, rritja e imigracionit, humbja e kontrollit lokal, papunësia dhe pasiguria, kanë bërë që disa segmente të publikut të dalin në përfundimin se qeveria i ka trajtuar me paaftësi problemet dhe nuk ka arritur që të mbajë premtimet. Kjo pavarësisht nëse ata ishin ndikuar personalisht ose jo dhe pavarësisht nga sukseset e arritura në fusha të tjera.

Për segmente më të sofistikuara të publikut niveli i pakënaqësisë politike lidhet me vlerësime më të ndërlikuara të ecurisë së qeverive. Politikat e suksesshme ekonomike gjatë tridhjetëvjeçarit të parë pas Luftës së Dytë Botërore dhe rënia, që vijoi në mesin e viteve 1970-të, ka rritur dhe pastaj zhgënjyer pritshmëritë ndaj kapaciteteve shtetërore për t'u marrë me rritjen ekonomike, inflacionin dhe punësimin. Ecuria e dobët ose më e dobët e shteteve gjatë dekadave të fundit, me sa duket, është peshuar duke pasur si referencë bumin ekonomik të tridhjetë viteve “të lavdishme” të pasluftës si dhe duke patur parasysh pritshmëritë që janë krijuar nga zgjerimi i ndërhyrjeve publike gjatë një shekulli.

Segmentet më të sofistikuara të publikut janë më shumë në dijeni për ndryshimet ekonomike dhe sociale, që kanë ngjarë gjatë dekadave të fundit. Ato nuk arsyetojnë sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Ata mendojnë se shtet-kombi nuk është më i aftë që të përballojë vështirësitë e mëdha ekonomike, se nuk mund të kundërshtojë vendimet e kompanive të mëdha ndërkombëtare dhe të parandalojë zhvendosjen e industrisë. Pritshmëritë e tyre për gjërat, që qeveria mund të bëjë, sa vijnë e zvogëlohen. Megjithatë, ata vazhdojnë të mbeten të pakënaqur me politikën, pasi në mënyrë të nënkuptuar krahasojnë ecurinë e qeverive të tanishme me ecurinë e qeverive të mëparshme ose me këndvështrimet e tyre të zhvilluara lidhur me çfarë i takon qeverisë që të bëjë. Prandaj, si

pritsmëritë normative, ashtu dhe ato ideologjike shërbejnë si burime të rëndësishme kritike, që aktivizohen nga ato, që duken si dështime të qeverisë. Kombinimi i burimeve të kritikës, që janë në rritje për shkak të niveleve më të larta të arsimit, me zhgënjimet e shumta politike krijon tek shtresa e politizuar e publikut një natyrë të qëndrueshme kritike. Këto tendenca kritike aktivizohen, kur njerëzit përballen me vështirësi personale në jetën e tyre, çfarëdo qofshin këto vështirësi.

Konteksti Politik. Kur njerëzit shpjegojnë zhgënjimin e tyre politik, ata u referohen ose nënkuptojnë elementet e ndryshme të konteksteve sociale dhe politike për të justifikuar deziluzionimin e tyre. Vihet re qartë që demaskimet e mprehta të korrupsionit politik dhe skandaleve në shumë vende kanë nxitur një klimë të mosbesimit etik.

Distancat ideologjike dhe politike midis partive politike janë zvogëluar. Në vende të ndryshme Europiane politika ka qenë parë, por jo më, si një betejë mes këndvështrimesh të ndryshme, madje utopike, për shoqërinë dhe të ardhmen e saj. Që prej kolapsit të sistemit socialist “të vërtetë ekzistues” pothuaj asnjë parti e konsoliduar nuk ka ndërmend që të përmbyset sistemin e ekonomisë së tregut, kapitalizmit dhe liberal-demokracisë. Për arsye të ndryshme të përmendura më sipër, hapësira e veprimit të qeverive është kufizuar. Kjo ka bërë që disa segmente të publikut të dalin në përfundimin që politika nuk ka më rëndësi, se nuk ia vlen që të harxhohet kohë për të vendosur midis partive të ngjashme, që mbështesin politika të ngjashme, si dhe që partitë dhe politikanët janë duke konkurruar vetëm për të rritur pushtetin dhe privilegjet e tyre. Atyre, që kanë pasur disa lidhje partizane, u vjen keq që partitë e majta janë duke mbështetur ato politika, që, sipas tyre, janë “neo-liberale të djathta”, ose që partitë e djathta kur vijnë në pushtet lënë të pandryshuara politikat “socialiste të majta”. Disa qytetarë mendojnë se politika ka humbur origjinalitetin e saj dhe gjithnjë e më shumë është duke u drejtuar nga interesa vetjake dhe motive të fshehta. Ata shpesh akuzojnë sondazhet e opinionit publik dhe specialistët e komunikimit si shkaktarë të këtyre ndryshimeve.

Episodet e zakonshme të jetës politike, që më parë konsideroheshin neutrale ose normale, tani nxisin mosbesimin politik, kur ky mosbesim është bërë aq i madh sa ka shkaktuar një përçmim kundër vetë politikës. Goditjet e shpeshta, përfoljet dhe akuzimet, që i bëhen “qeverisë” nga përfaqësues të zgjedhur dhe të përzgjedhur ndihmojnë në forcimin e një perceptimi gjithnjë e më negativ tek

segmentet e opinionit publik, të cilat tashmë e konsiderojnë politikën si “të bërit politikë” sikurse përmendet më sipër.

Për të maksimizuar audiencën media ka prirjen që të thjeshtëzojë, të personalizojë, të dramatizojë dhe të theksojë aspektet “spektakolare” të ngjarjeve politike. Media mbulon më shumë politikën sesa politikën, fokusohet tek skandalet, taktikat dhe rivalitetet personale dhe i përshkruajnë fushatat zgjedhore si të ishin “gara me kuaj”. Kandidatët dhe zyrtarët publikë portretizohen si të pafytyrë, që i shërbejnë vetëm vetes. Media ka prirjen që të përforcojë dyshimet dhe paragjykimet e atyre konsumatorëve mediatikë, që e shikojnë politikën thjesht si “bërje të politikës”, pasi kjo gjë e bën informacionin më zbavitës dhe më të lehtë për t’u kuptuar. Kjo është veçanërisht e vërtetë për ata “qytetarë konsumatorë”, që kanë shumë pak interes për politikën dhe kanë një prirje për të patur mosbesim tek politika si pasojë e predispozicionit të tyre për të qenë shpërfillës, marginalizimit social dhe mungesës së besimit ndaj institucioneve.

A ka rëndësi pakënaqësia politike?

Mos ndoshta niveli në rritje i pakënaqësisë politike po kërcënon legjitimitetin e politikës Europiane? Pikësëpari, pakënaqësia politike është e paqartë dhe zhgënjimi i tanishëm ka mundësi që të jetë i kthyeshem. Një pikë e dytë është se ka një rënie të paqartë të besimit për politikanët, partitë, zgjedhjet, legjislaturat dhe qeveritë, por nuk ka një mosbesim të përgjithshëm të dukshëm për format e tjera të politikës Europiane. Legjitimiteti i sistemit politik varet nga ekzistenca e një sistemi politik ose e një utopie alternative dhe konkurruese, porse lufta midis formave të ndryshme të qeverisë dhe organizimit shoqëror është zhdukur prej vitit 1989. Disa studiues mendojnë se prej rrënimin të sistemit socialist mbështetja e qytetarëve për demokracinë është duke krijuar një varësi ndaj ecurisë së qeverisë, sidomos në vendet ish-socialiste. Prandaj sistemet demokratike duken më të brishta, por në të njëjtën kohë duken edhe më të forta dhe të pacënuara.

Për të njëjtat arsye, një nivel gjithmonë e më i lartë i mosmarrjes pjesë në votime në vetvete nuk është një kërcënim i sistemit politik. Por, ndërsa abstenimi shtohet duke përfshirë më shumë shtresa sociale të ulta dhe ndërsa politikanët janë më të etur për të marrë parasysh pritshmëritë e votuesve dhe jo atë të jo-votuesve, zvogëlimi i pjesëmarrjes në zgjedhje do të tentojë që të sjellë ose përforcojë anësitë klasore në politikën publike.

Mungesa e besimit për institucionet politike vë në pikëpyetje gatishmërinë e publikut për të zbatuar ligjet, për të paguar taksat dhe për t'u punësuar në administratë. Disa akte dhune të izoluara, që janë ndërmarrë në disa vende kundër politikanëve dhe zyrtarëve mund të kenë të bëjnë me rritjen e pakënaqësisë politike. Mosbesimi në etikën e politikanëve tashmë është bërë një problem, pasi dobëson gatishmërinë për t'u përmbajtur rregullave dhe ligjeve. Për shembull, ka kriminelë të rinj, që thonë se atyre nuk u vjen turp për vjedhjet, grabitjet ose trafiket e drogës, që bëjnë, sepse “ liderët politikë kanë vjedhur shumë më shumë se ne”.

Identiteti kulturor dhe protesta

Migracioni, i cili përkufizohet si lëvizja e njerëzve nga një rajon ose vend në një tjetër, pavarësisht nga motivimi, shkakton ndryshme të rëndësishme tek popullsia, të cilat ndikojnë në jetën politike në Europë. Migracioni e bën më të larmishme përbërjen e *demosit* europian; pasi bën që njerëz me statuse ligjore të ndryshme të bashkëjetojnë nën të njëjtën çati demokratike; bashkë me qytetarët nënshtetas ka punëtorë sezonalë, rezidentë të vendosur prej një kohe të gjatë, azilantë si dhe imigrantë; që nuk kanë dokumente. Si pasojë e statusit ligjor, të gjitha këto grupe njerëzish u nënshtrohen grupeve të ndryshme të të drejtave dhe detyrimeve.

Demokracia, nënshtetësia dhe të drejtat

a. Nivele dhe karakteristika të migracionit

Prej vitit 1989 migracioni neto ka qenë faktori kryesor ndikues tek ndryshimi i popullsisë në vendet anëtare të Këshillit të Europës. Le të analizojmë prirjet në ndryshimin e sasisë së përqindjes, që zënë popullsitë e huaja tek popullsia totale e pesëmbëdhjetë vendeve të Europës. Gjendja totale e regjistruar e popullsisë së huaj në vitin 1999 është afërsisht 21 milion, që përbën rreth 2.6% të popullsisë totale të të gjitha vendeve. Të dhënat tregojnë se proporcioni më i lartë i të huajve në lidhje me popullsinë totale ishte në Zvicër (19.3 % ku dy të tretat ishin nënshtetas të huaj, që vinin nga BE-ja). Pjesa më e madhe e të huajve ndodhet e vendosur në Europën Perëndimore, ndërkohë që në Europën Qendrore dhe Lindore proporcioni është relativisht i vogël (më pak se 2%). Imigracioni neto në të dyja rajonet ishte relativisht i lartë në fillim të viteve 1990, me Republikën Federale të Gjermanisë, që përjetoj rritjen

absolute më të lartë. Në fund të viteve 1990 në disa vende të Europës Perëndimore proporcioni ose ka rënë ose është ka ngelur i pandryshuar. Prej vitit 1998, në shumicën e vendeve përqindja e të huajve ka ardhur duke u rritur edhe pse në nivele më të ulta në Europën Qendrore dhe Lindore (ndër vendet e Europës Qendrore dhe Lindore numrat më të lartë janë hasur në Republikën Çeke). Për Europën Perëndimore të dhënat nxjerrin në pah dallime të konsiderueshme përsa i përket origjinës së imigrantëve të huaj. Shumica e popullsisë së huaj vjen nga jashtë Zonës Europiane Ekonomike dhe Zvicrës. Migrantë të rajoneve të ndryshme zgjedhin vende të ndryshme si destinacion. Për shembull, Afrika është një burim i rëndësishëm migrantësh për Francën, ndërsa për Spanjën dhe Portugalinë burimi kryesor është rajoni i Amerikës Latine. Aziatikët migrojnë në vende të ndryshme Europiane për arsye të ndryshme; ata, që vijnë nga subkontinenti indian zakonisht shkojnë në Mbretërinë e Bashkuar, filipinasit shkojnë për punësim të përkohshëm në Itali dhe Greqia thith imigrantë prej rajonit të Lindjes së Mesme. Gjermania qëndron si destinacioni më i zakonshëm për nënshtetasit, që vijnë nga vendet europiane, që nuk bëjnë pjesë në BE. Migrantët tranzit dhe ata të përkohshëm përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së Europës Qendrore dhe asaj Lindore.

Duke filluar nga fundi i viteve 1950 në Europë u thithën në mënyrë aktive nga jashtë punëtorë migrantë, prej të cilëve nuk pritej që të qëndronin në mënyrë të përhershme në vendin pritës. Punësimi i krahut të huaj të punës u ndërpre zyrtarisht në Europën Perëndimore prej mesit të viteve 1970. Megjithatë numri i popullsisë së huaj nuk u ul si pasojë e niveleve të ulta të kthimit dhe bashkimeve familjare. Shumë ish-punëtorë të ftuar kanë përfituar statusin e rezidentëve, që nuk janë nënshtetas. Kjo kategori njerëzish, që shpesh quhen “jo-shtetas”⁴, gëzon një status të ndërmjetëm midis nënshtetasit dhe imigrantit. Ata janë përfshirë në struktura të ndryshme sociale, ekonomike dhe ligjore, ndërkohë që nuk gëzojnë të drejta të plota të pjesëmarrjes politike. Rregullat për të dhënë këtë status si dhe të drejtat dhe përfitimet, që lidhen me këtë status, ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin. Megjithatë ky status është shndërruar në një tipar të qëndrueshëm dhe të rëndësishëm në të gjitha demokracitë e Këshillit të Europës dhe ka çuar në rishikimin e faktit se kush ka të drejtë që të marrë pjesë në politikë dhe si.

⁴ Termi i përdorur në anglisht nga autorët është “denizens”.

b. Jo-shtetësia dhe kombësia

Vazhdimësia midis njerëzve dhe vendit, kombësisë dhe *demos*, është një premisë e rëndësishme e demokracive moderne. Nënshtetësia e Bashkimit Europian është një shembull i gjetur për të treguar sesi kufijtë e anëtarësisë politike mund të zgjerohen dhe *demos-i* të zgjerohet përtej kufijve kombëtarë. Megjithatë, edhe në shtetet anëtare të BE-së nënshtetësit e vendeve të treta nuk janë përfshirë në statusin përmbushës të nënshtetësisë së BE-së sikurse përkufizohet nga traktati i Mastroihtit. Kjo tregon se deri tani përpjekjet për të zgjeruar të drejtat e nënshtetësisë përtej kombësisë nuk po sigurojnë një strukturë gjithëpërfshirëse për t'u përballur me çështje, që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen politike të nënshtetasve të vendeve të treta. Kjo gjë kërkon një sistem novator të të menduarit mbi përbërjen e elektoratit politik, nënshtetësisë dhe mekanizmave të pjesëmarrjes politike.

Në fakt, në BE të drejtat civile dhe sociale janë zgjeruar edhe tek nënshtetësit e vendeve të treta. Kjo prirje tregon se nënshtetësia nuk është më mënyra e vetme për të përfituar nga të mirat e nënshtetësisë në një vend dhe për t'u bërë anëtar plotësisht i integruar në një komunitet. Megjithatë, të drejtat politike ngelen privilegj i nënshtetasve. Ky privilegj është i rëndësishëm, pasi, për shembull, rregullat mbi shpërndarjen e të drejtave sociale dhe civile bëhen dhe ndryshohen nga ata, që kanë dhe ushtrojnë të drejtat politike, pra, nga nënshtetësit "vendas". Kjo është veçanërisht problematike, për shembull, në periudha të krizave ekonomike, kur nënshtetësit dhe përfaqësuesit e tyre mund të vendosin që të pakësojnë përfitimet sociale të rezidentëve, që nuk kanë nënshtetësinë, këta të fundit janë të përjashtuar nga procesi i vendimmarrjes.

Sidoqoftë, rezidentët jo-shtetas japin një kontribut të çmuar për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit ku qëndrojnë, paguajnë taksat dhe u takon të zbatojnë ligjet e vendit. Me fjalë të tjera, ata ndajnë barrën dhe përfitimet e bashkëpunimit social. Duke u mohuar të drejtat e plota politike duket sikur atyre u dhunohet një ndër parimet demokratike themelore (normative), që thotë se ata, që ndikohen nga një grup institucionesh sociale dhe politike, duhet të kenë të drejtë që të lejohen të ndikojnë mbi këto institucione dhe politika. Duke e njohur mungesën e këtyre të drejtave politike si një formë të deficitit demokratik, disa qeveri kanë nxitur kanale të ndryshme të pjesëmarrjes politike të jo-shtetasve si alternativa të së drejtës për të votuar. Në disa vende të Këshillit të Europës jo-shtetasve u jepen mundësi për të influencuar në mënyrë jo të drejtpërdrejtë vendimmarrjen nëpërmjet organizatave, njësieve dhe

bashkësive konsultative, që janë themeluar nga qeveria. Këto modele zakonisht lëvizin fokusin e ushtrimit të demokracisë nga niveli kombëtar tek niveli vendor. Duke u angazhuar në aktivitete civile në nivelin vendor, rezidentët jo-shtetas bien në kontakt me institucionet përfaqësuese, shoqatat dhe grupet e lobingut, të cilat mund t'u japin atyre zë edhe në nivel rajonal dhe kombëtar. Për më tepër, pjesëmarrja në nivelin vendor mund të sjellë aftësi, që do ta rrisin pjesëmarrjen në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare.

Duke u dhënë rezidentëve jo-shtetas të drejta politike, për shembull, të drejtën për të zgjedhur një përfaqësues në zgjedhjet vendore, siç ka ndodhur në Irlandë, Suedi, Norvegji, Danimarkë, Hollandë, Finlandë dhe Luksemburg, parashtrohet një ndryshim i madh në lidhje me konkurrencën politike. Me fjalë të tjera, kandidatët, që fitojnë zgjedhjet, duhet që të japin llogari para një elektorati më të larmishëm dhe të jenë të ndjeshëm ndaj nevojave të një sektori të popullsisë, që më parë ishte i përjashtuar nga jeta politike. Përveç kësaj, çështje të reja (për shembull, në fushën e arsimit dhe shëndetit) shfaqen dhe fitojnë përparësi në rendin e ditës së politikës.

Gjithashtu, duke u dhënë zë jo-shtetasve, jepet një mundësi për të zgjidhur konfliktet potenciale etnike dhe kulturore nëpërmjet procedurave demokratike. Në këtë mënyrë konfliktet nuk anashkalohen, por ballafaqohen dhe zgjidhen. Kjo gjë bën të mundur një përballje të lirë të ideve nëpërmjet dialogut të hapur dhe të matur duke forcuar vetë-reflektimin dhe multikulturalizmin kritik në shoqërinë pritëse.

Fakti, që kjo kategori migrantësh do të qëndrojë në mënyrë të përhershme në vendin, pritës është parë si justifikim për të ndërmarrë një projekt të nënshtetësisë multikulturale, ku të drejtat politike mund të shijohen si nga nënshtetasit ashtu edhe nga jo-nënshtetasit.

c. Minoritetet

Disa rezidentë jo-nënshtetas dhe grupe kombëtare brenda një shteti kërkojnë gjithnjë e më shumë njohje kolektive si dhe pjesëmarrje politike në procese, p.sh. si “minoritete”. Kushtet për të dëgjuar këto pretendime favorizohen nga pjesëmarrja e tyre e konsiderueshme numerike në disa vende, nga konventat ndërkombëtare, që mbështesin njohjen e minoriteteve si dhe shqetësimi i përgjithshëm për të siguruar të drejtën për të marrë pjesë në jetën sociale dhe ekonomike për një pjesë të popullsisë, që më parë ka qenë e përjashtuar. Nga njëra anë, shumica e vendeve të Këshillit të Europës shprehin zotimin për të njohur dhe respektuar të

drejtat e grupit (për shembull, në vendet, që dolën nga ish-Jugosllavia). Nga ana tjetër, disa vende (si Franca) nuk pranojnë që t'i njohin këto grupe si “minoritete” dhe t’u japin atyre të drejtat e grupit edhe kur këto vende e njohin barazinë e njerëzve, që kanë origjinë të ndryshme kulturore dhe etnike. Disa shtete (si Kroacia) kanë futur kuotat për minoritetet gjuhësore në përfaqësitë rajonale dhe vendore, ndërsa të tjerë mbajnë njësi konsultative, p.sh. një dhomë të dytë në parlament ose mekanizma “vetoje” për “komunitetet” kombëtare dhe fetare. Sidoqoftë, anëtarët e “vegjël” dhe territorialisht të shpërndarë të minoriteteve kombëtare, sidomos Romët, ngelen të përjashtuar nga pothuaj të gjitha skemat.

d. Migracioni ilegal

Gjatë fiteve të fundit, përllogaritjet e migracionit ilegal kanë arritur nivele shqetësuese, sidomos në vendet e Europës Jugore. Migrantët e papajisur me dokumente, të cilët zyrtarisht e kanë të ndaluar që të punësohen, furnizojnë një pjesë të mirë të krahut të punës në ekonominë e “fshehura” ose të “zeza” të këtyre vendeve. Migracioni i parregullt është i dobishëm për punëdhënësit e vendeve pritëse, të cilët përfitojnë nga migrantët, që janë pa dokumente duke i paguar më pak dhe duke i mbajtur për orare pune më të fleksible dhe të zgjatura. Si shteti, ashtu edhe sistemi juridik nuk marrin pjesë në këtë sektor informal të tregut. Kërkesa për më shumë punëtorë, që janë migrantë pa dokumente, nxit trafikun njerëzor dhe klandestin dhe rritjen dramatike të industrive të zeza, që në këtë treg i trajtojnë njerëzit si mallra. Çdo vit mijëra njerëz, sidomos gra dhe fëmijë, bien pre të trafiqeve, që kanë si qëllim shfrytëzimin seksual dhe forma të tjera shfrytëzimi, gjë që mund të quhet ndryshe një formë e re skllavërie.

Qëndrimet ndaj migracionit

Vëzhguesit kanë vënë në dukje se qëndrimet anti-migrante në vendet anëtare të Këshillit të Europës janë duke u rritur në mënyrë alarmante. Konferenca Botërore e Kombeve të Bashkuara kundër Racizmit, Diskriminimit Racor, Ksenofobisë dhe Intolerancës Përkatëse, e ka vendosur këtë problem në qendër të vëmendjes. Organizata ndërkombëtare si Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, Organizata Ndërkombëtare e Punës dhe Qendra Europiane për Racizmin dhe Imigracionin kanë nxjerrë në pah se ka një rritje të qëndrimeve

negative ndaj migrantëve, që vijnë nga jashtë BE-së. Këto qëndrime përforcohen nga stereotipat racorë, që përhapen nga media dhe nga disa liderë politikë. Të dhënat, që vijnë nga Qendra Europiane për Monitorimin e Racizmit dhe Ksenofobisë (EUMC) tregojnë se sulmet e motivuara nga racizmi janë shtuar në shumicën e vendeve anëtare të BE-së. Për disa, statistikat zyrtare tregojnë një rënie të mundshme të krimeve gjatë dy viteve të fundit. Lidhur me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, Amnesty International ka raportuar një rritje të qëndrimeve ksenofobike dhe të dhunës racore gjatë fundit të viteve 1990-të.

Në të gjitha vendeve e Këshillit të Europës shkaktarët tipikë të krimeve racore janë vazhdimisht djem të rinj (18-26) me nivele të ulta arsimimi. Megjithatë, disa OJQ (organizata jo-qeveritare) kanë raportuar tek QEMRK se disa raste shqetësuese akte raciste dhune janë kryer nga ruajtësit e rendit. Kjo tregon se racizmi manifestohet edhe brenda strukturave institucionale të konsoliduara. Partitë e ekstremist të djathtë, suksesi elektoral i të cilave ka ardhur në rritje që prej viteve 1980, gjatë fushatave politike, shpesh kërkojnë te zgjojnë ndjenjat ksenofobike të njerëzve. Ata gjithashtu bazojnë strategjitë e tyre elektorale tek pretendimi se migrantët janë duke kërcënuar kulturën kombëtare dhe simbolet e saj (siç janë kryqet në Itali dhe Gjermani) si dhe hamendësojnë që ka një lidhje midis papunësisë dhe numrit të migrantëve në vendet përkatëse.

Nuk ka prova empirike dhe teorike për të mbështetur pretendimin se imigracioni shkakton papunësi. Përkundrazi, disa studime tregojnë se qytetarët, që janë zëvendësuesit e mundshëm më të afërt të punës, që bëjnë imigrantët, nuk kanë probleme si pasojë e rritjes së imigracionit. Gjithashtu, studime të ndryshme të prirjeve demografike kanë identifikuar migracionin si një zgjidhje të mundshme për të përballuar “deficitin demografik” të Europës dhe problemet, që vijnë si pasojë e këtij deficiti. Ka pasur argumente, që thonë se imigracioni mund të jetë një rrugë politike për të përmbushur synimet strategjike ekonomike dhe sociale, që përforcojnë ekonominë e tregut të Europës.

Një tjetër çështje, që ngrihet shpesh nga liderët e partive ksenofobike, është që imigracioni përbën një kërcënim për stabilitetin politik dhe social. Gjithashtu, ekziston një perceptim shumë i përhapur se nivelet e krimit janë rritur si pasojë e imigracionit. Frika nga migracioni është përkeqësuar nga ngjarjet e 11 shtatorit 2001 dhe 11 marsit 2004. Dyshimet dhe frika u drejtohen kryesisht migrantëve, që vijnë nga vendet arabe dhe nga Europa Juglindore.

Këto perceptime negative shpesh përforcohen nga imazhi i migrantëve, që portretizohet në media. Programet e lajmeve raportojnë për krimet duke thënë se keqbërësit janë identifikuar si anëtarë të një grupi minoritar. Në një linjë të ngjashme, programet artistike, që kanë tema mbi krimin, i karakterizojnë vrasësit dhe keqbërësit si njerëz me origjinë të huaj.

Në të njëjtën kohë, media përbën një mundësi shumë të rëndësishme për pjesëmarrjen dhe integrimin e rezidentëve jo-nënshtetas. Disa vende kanë nënvizuar efektet pozitive, që media mund të ketë në perceptimet dhe qëndrimet e publikut si dhe në vetë-perceptimin e migrantëve, nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm siç janë financimi i programeve multikulturale.

Përfaqësimi Partitë politike

Asnjë demokraci nuk ekziston pa partitë politike edhe nëse partitë dallojnë përsa i përket strukturës organizative, ideologjisë, përmasave, funksioneve dhe qëllimeve. Ato veprojnë si ndërmjetës midis votuesve (nënshtetasve) dhe autoriteteve publike (sunduesve). Duke strukturuar fushën politike ata ndihmojnë votuesit në bërjen e zgjedhjes së tyre dhe ndihmojnë pushtetarët për ndërtimin e qeverive. Ekzistojnë shumë përkufizime për partitë politike, që variojnë nga më të përgjithshmet tek ato shumë specifike. Shpesh, përkufizimet bazohen tek një ose më shumë funksione të partive politike. Kriteri më i zakonshëm është që partitë duhet të konkurrojnë në arenën politike, të përpiqen që të sigurojnë zgjedhjen e kandidatëve të tyre dhe të luajnë një rol në formimin e qeverive. Partitë mund të përmbushin një valë të gjerë funksionesh, edhe pse jo të gjitha partitë angazhohen në të gjitha funksionet dhe, padyshim, jo në të njëjtën masë. Ato mund të luajnë një rol thelbësor në anëtarësimin dhe përzgjedhjen e elitës politike duke emëruar kandidatë për poste, që votohen, si dhe duke plotësuar pozicionet qeverisëse. Ato mund të luajnë gjithashtu një rol integrues në shoqëri duke mobilizuar dhe ofruar një identitet kolektiv për votuesit, duke sintetizuar dhe artikulluar interesat sociale si dhe duke përforcuar legjitimitetin e sistemit politik. Gjithashtu, ato mund të angazhohen në socializmin e votuesve, në strukturimin e çështjeve dhe në përfaqësimin social. Sidoqoftë, në një demokraci një parti nuk mund të përfaqësojë gjithë shoqërinë, sikurse edhe e ilustron mirë origjina e emrit “*pars*” (pjesë). Për të shmangur

deficitet demokratike, në sistemet demokratike pritet që vetë partitë të jenë demokratike dhe transparente si dhe të ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme dhe të rregulluara ndërmjet liderëve të partisë dhe anëtarësisë.


Anëtarësia e partisë, përmasa dhe organizimi

Edhe pse shihet një prirje në rënie të anëtarësisë në parti në Europë, ky fenomen është më shumë i vërtetë për demokracitë tradicionale jetëgjata të Europës Perëndimore sesa për vendet e Europës Jugore, Qendrore dhe Lindore, që janë demokratizuar kohët e fundit. Në të gjitha vendet e Europës Perëndimore ka një rënie të numrit të anëtarëve të partive. Vendet, që i përkasin valës së tretë të demokratizimit, paraqesin më shumë luhajtje, madje duke pasur edhe vende, ku vihet re rritje (Greqia, Hungaria, Republika Sllovaqe dhe Spanja). Kjo tregon se rënia e anëtarësisë është një prirje e përgjithshme në demokracitë e konsoliduara. Kjo situatë ngre një shqetësim për pjesëmarrjen e qytetarëve në çështjet publike: demokracia është në rrezik, nëse njerëzit janë kaq të plogësht dhe të zhgënjyer me demokracinë, sa nuk denjojnë që të përfshihen në një ndër institucionet më të rëndësishme të saj. Sa më pak që të anëtarësohen në parti, aq më pak mundësi ka që njerëzit të votojnë; dhe kur ata nuk bëjnë asnjë prej këtyre gjërave, atëherë qeveritë do jenë më pak të kontrolluara, të drejtat e individit do të jenë më pak të siguruara, ndërkohë që më pak kërkesa të individëve dhe grupeve do të jenë të përfaqësuara në procesin e bërjes së politikave. Në përfundim, sa më shumë njerëz të vendosin që të mos përfaqësohen në procesin e vendimmarrjes, aq më pak do t'i konsiderojnë ata si legjitime veprimet e qeverive të tyre demokratike.

Sidoqoftë, rënia e anëtarësisë në vetvete nuk është shqetësuese. Rënia e anëtarësisë nuk është detyruesisht një shenjë e rënies së përgjithshme të pjesëmarrjes politike: rënia e anëtarësisë partiake mund të shpjegohet; të paktën pjesërisht; nga shfaqja e formave të reja të pjesëmarrjes (sikurse janë shkrimi i peticioneve, bojkotimi i disa produkteve për qëllime politike, demonstrata pro ose kundër një politike të caktuar); që janë më tërheqëse për individët dhe që janë forma më të pranueshme sociale. Përveç kësaj, nxitja për t'u anëtarësuar nëpër parti dobësohet edhe ngaqë partitë janë duke u përballur me konkurrues të ndryshëm, që po zëvendësojnë funksione të ndryshme të partive, ndërkohë që këta konkurrues kanë më pak kërkesa ndaj qytetarëve dhe

sigurojnë një përfshirje më të lehtë të tyre. Edhe kërkesa e partive për anëtarë është duke u zbehur në mënyrë të ngjashme: ndryshimi i natyrës së bërjes së fushatës elektorale (rritja e përdorimit të medias shoqëruar nga ulja e formës tradicionale të bërjes së fushatës, që mbështet tek vullnetarët) si dhe ristrukturimi i financimit të partive (mbështetja gjithnjë e më e madhe tek fondet publike dhe, për rrjedhojë, më pak te kuotat e anëtarësisë) e kanë ulur rëndësinë e mbajtjes së një anëtarësie të madhe. Kjo do të thotë që partive nuk u duhet më që të organizojnë programe të rregullta dhe të plota për anëtarësinë përveç atyre, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjedhjet. Së fundmi, një anëtarësi e gjerë partiake mund të mos e bëjë sistemin më të aftë për të reaguar ndaj kërkesave të qytetarëve: sa më e madhe të jetë anëtarësia aq më e vogël mund të jetë edhe mundësia për të ndikuar lidhshpërndarjen e partisë.

Figura 2 - Anëtarësia në partitë politike në Europën Perëndimore dhe Lindore



Burimi: Tabela nga Peter Mair dhe Ingrid van Biezen (2001), "Party membership in twenty European democracies, 1980-2000", *Party Politics*, vol. 7, Nr. 1.

Skandalet, që kishin të bënin me financime të paligjshme të partive, ishin të shpeshta në gjithë Europën gjatë viteve '90. Pavarësisht nga sistemi politik apo partiak, organizimi i partisë ose orientimi ideologjik, korrupsioni politik, që lidhet me financimin e partive është bërë një problem i vazhdueshëm. Me gjithë rregullimet institucionale dhe ato të politikave, pothuaj çdo demokraci europiane ka pasur vështirësi

serioze në realizimin e financimit në mënyrë mjaftueshme të partive dhe në sigurimin e një shpërndarjeje të ndershme të këtyre fondeve.

a. Shpenzime partiake më të larta (e që vazhdojnë të rriten), që kalojnë të ardhurat e ligjshme

Gjatë viteve 1970 partitë kishin ndërtuar burokraci të përhershme dhe me përmasa të konsiderueshme. Këto aparate administrative ishin të shtrenjta sidomos gjatë viteve, kur nuk kishte zgjedhje, kur dhuratat nuk ishin dhe aq të bollshme. Paralelisht me këtë rëndësia e zyrave qendrore-kombëtare ka kapërcyer rëndësinë e degëve lokale të partisë dhe kjo gjë ka sjellë rritjen e nevojës për ekspertizë të profesionalizuar (të shtrenjtë).

Fushatat elektorale u bënë gjithnjë e më të shtrenjta. Së pari, teknikat e fushatizmit u ndryshuan si pasojë e përparimeve teknologjike, të cilat e bënë më pak efektive punën e vullnetarëve. Jo vetëm që ra rëndësia e militantëve partiakë, por zëvendësuesit e militantëve - reklamimi në televizion, radio dhe gazeta - ishin shumë më të shtrenjta dhe efikase në ndikimin e sjelljes elektorale. Së dyti, natyra e politikës elektorale, që bëhej gjithnjë më konkurruese dhe më e orientuar nga tregu si dhe tendenca për fushata më të zgjata, detyruan organizatat qendrore të partive që të investonin më shumë para tek burimet profesionale në përpjekje për të kapur sa më shumë vota që të mundnin, pavarësisht nga përkatësia dhe besnikëria e këtyre votave. Rritja e nevojës për të arritur mbështetës të tjerë përtej mbështetjes tradicionale e shndërroi çdo votë shtesë në një votë më të shtrenjtë.

Për më tepër, në Europë partitë historikisht kanë ndjerë nevojën për të ruajtur në periudhën midis zgjedhjeve një nivel pjesëmarrjeje në asambltetë politike kombëtare, dhe disa here edhe në ato rajonale dhe lokale, në organizatat shoqërore, grupet studimore, fondacionet përkrahëse dhe në akademitë intelektuale, dhe këto duhej të financoheshin nga buxhetet e partive (edhe pse ndonjëherë me ndihmën e subvencionimeve publike). Megjithëse është e vështirë që të mblidhen të dhëna të besueshme për shumën, për të cilat bëhet fjalë, në dekadat e fundit partitë e Europës Perëndimore, qofshin këto të së Majtës apo të së Djathtës, kanë qenë të angazhuara në mbështetjen e partive ose grupimeve politike "simotra" në vendet e huaja, që janë duke kaluar procese të liberalizimit dhe demokratizimit politik. Sërish fondet qeveritare shpesh janë kanalizuar nëpërmjet organizatave partiake për këtë qëllim, por këto aktivitete ndërkombëtare, padyshim, kanë ndikuar në profesionalizimin e personelit të përhershëm të këtyre organizatave.

Edhe pse nëpër Europë legjislacioni mbi burimet e ligjshme të financimit të partive ndryshon nga njëri vend në tjetrin, disa prirje të përgjithshme mund të vihen re pothuaj kudo. Përbërja dhe burimet e të ardhurave kanë ndryshuar në mënyrë të ndjeshme prej viteve 1970. Kuotat e anëtarësisë kanë më pak rëndësi për buxhetet e partive. Së pari, sepse me rënien e anëtarësisë partitë thjeshtë nuk mund të mbledhin aq para sa më parë nga ky burim. Së dyti, nevoja e madhe, që sa vjen e rritet, për para i shtyn partitë që të kërkojnë tjetërkund mbështetje financiare. Dhe së treti, në demokracitë e reja të Europës Jugore dhe Lindore kuotat e anëtarësisë asnjëherë nuk kanë fituar rol qendror. Kjo gjë i detyrohet pjesërisht rrethanës historike të sistemeve njëpartiake me forma të ndryshme të kontributeve të detyruara dhe pjesërisht i detyrohet vetë kohës, kur ndodhën proceset e ndryshimit të sistemit.

Një tjetër burim i rëndësishëm i të ardhurave të partive kanë qenë dhurimet. Këto mund të vijnë nga aktorë të ndryshëm: individë privatë, firma biznesi, sindikata ose organizata të shoqërisë civile. Disa nga donacionet janë ndaluar ose kufizuar me ligj, por dredhitë nuk kanë qenë të vështira për t'u gjetur. Dhurimet nga qeveritë, partitë, firmat dhe individët e huaj janë të ndaluara në shumicën e vendeve europiane, por sërish sasi të panjohura, mesa duket, ia dalin që të kapërcejnë pengesën, sidomos kur bëhet fjalë për ryshfete, që dalin nga kontrata të ndihmës së huaj dhe firma shtetërore, që veprojnë jashtë vendit. Kuptohet që gjatë viteve të fundit shumë prej skandaleve të financimit të partive kanë dalë prej kësaj fushe dhurimesh kaq të errët dhe të vështirë për t'u kontrolluar.

Partitë tradicionalisht kanë përfituar para nga një larmi firmash, që kanë qenë në zotërimin e tyre ose kanë qenë pranë tyre, siç janë shtypshkronjat, gazetatat, shtëpitë e botimit, agjenci udhëtimesh, konsulencat, zyra planifikimi, institute kërkimore, shoqëri argëtimi, klube sportive dhe, kohët e fundit, fondacionet e partive. Ndërsa është e vështirë që të jepet një gjykim mbi evoluimin e këtyre burimeve financiare, të krijohet përshtypja se ato kanë rënë si pasojë e prishjes së solidaritetit ideologjik dhe e konkurrencës tregtare. Për shembull, zor se mund të besohet se një gazetë apo shtëpi botuese partiake të jetë duke nxjerrë aq fitim sa të shndërrohet në një burim të rëndësishëm financimi për partitë.

Subvencionimet publike për partitë kanë zënë një rol të rëndësishëm prej viteve 1970. Ndërsa tre dekada më parë subvencionimet ishin të rralla, sot ato janë një burim thelbësor i të ardhurave të partisë në mbarë Europën. Legjislacioni në çdo vend përcakton se si duhet të shpërndahen këto subvencione, si mund të shpenzohen dhe si duhet të

monitorohen. Ato mund të derdhen drejtpërdrejt në formë monetare ose në mënyrë të tërthortë në formën e përdorimit falas të televizionit apo mediave të tjera.

b. Korrupsioni

Financimet e paligjshme të partive kanë qenë prej një kohe të gjatë një fenomen i zakonshëm në të gjitha demokracitë europiane, por duket se vetëm në kohët e fundit ato janë shndërruar në një kërcënim për legjitimitetin e tyre dhe një burim, që nxit rënien e besimit publik. Se çfarë konsiderohet e ligjshme, kjo është e përcaktuar nga legjislacioni kombëtar: ajo, që konsiderohet e ligjshme në një vend, mund të jetë krejt e paligjshme në një vend tjetër. Të ardhurat mund të jenë të paligjshme, nëse vijnë nga organizma, kontributet e të cilave janë të ndaluara me ligj (si firmat apo qeveritë e huaja), nga krimi i organizuar, nga kontribute individuale, që kapërcejnë kufijtë e lejuar ose që anashkalojnë detyrimet ligjore për regjistrim. Dy burime të përhershme të paligjshme janë përqindjet, që vijnë si ryshfete për kontratat publike të dhëna dhe ryshfetet, që zakonisht u jepen partive, që janë në pushtet në shkëmbim të trajtimit me politika favorizuese.

Nuk ka ndonjë mënyrë të besueshme dhe objektive për të vlerësuar nëse partitë janë bërë më shumë ose më pak të korruptuara gjatë tridhjetë viteve të fundit. Boshllëku i sipërpërmendur, që ekziston midis kërkesës për më shumë fonde dhe furnizimit të kufizuar nga burimet tradicionale, lë të mendosh se ka më shumë stimulim material se në të kaluarën për të përdorur mjete financiare të dyshimta. Ajo, që duket qartë, është se ka rënë toleranca publike për financime të paligjshme, edhe kur këto financime nuk kanë të bëjnë me përfitim apo vjedhje personale. Me sa duket qytetarët janë duke zbatuar standarde më të larta të sjelljes etike ndaj përfaqësuesve dhe sunduesve të tyre dhe se ata janë më të informuar për praktikat korruptive falë internetit dhe indikatorëve krahasues si ato, që nxirren nga Transparency International. Media është më e gatshme që të publikojë skandalet e financimeve; gjyqësori është më i gatshëm që të ndëshkojë ata, që përfshihen në veprime të tilla, qytetarët janë më të prirur që të reagojnë duke ndëshkuar edhe ata, që thjesht dyshohen për korrupsion. Pavarësisht se çfarë impakti ka kjo gjë për të ardhmen afatgjatë të demokracisë, pasojat e menjëhershme janë serioze. Regjimet bashkëkohore në Europë kanë një problem serioz me “ekonominë e brendshme politike”. Demokracia kushton gjithnjë e më shumë para sa herë që luhet loja elektorale. Përfituesit finalë, qytetarët, janë më pak të

gatshëm që të paguajnë këto kosto, qoftë nëpërmjet kontributeve vullnetare private, qoftë nëpërmjet subvencioneve të detyrueshme publike. Duke qenë se partitë janë e vetmja formë e njohur për të strukturuar konkurrencën elektorale dhe formimin e qeverisë, ato nuk mund të falimentojnë dhe të zhduken, përndryshe edhe demokracia, që njohim ne ka për t'u zhdukur.

c. Partitë janë duke u larguar nga shoqëria civile dhe duke iu afruar shtetit

Kjo vjen si pasojë e shumë faktorëve, përfshi këtu rënien e anëtarësisë partiake, ndryshimin e teknikave të fushatës dhe varësinë ndaj shtetit për financimin e shpenzimeve, që sa vijnë e rriten. Puna vullnetare për partitë doli nga moda sapo partitë u përpoqën që të arrinin tek njerëzit kryesisht nëpërmjet televizionit. Gjithashtu, dhurimet personale si një formë pasive e pjesëmarrjes kanë rënë. Një numër i vogël i dhurimeve të majme ka prijten që të zëvendësojë numrin e madh të dhurimeve të vogla. Në të njëjtën kohë, sikurse kemi parë më sipër, partitë janë bërë gjithnjë e më shumë të varura financiarisht nga fondet publike dhe në disa raste nga firmat e mëdhaja të biznesit. Shteti është thelbësor, jo vetëm sepse në Europë është bërë furnizuesi kryesor i fondeve të partive, por edhe sepse partitë, që janë në pushtet mund të shtien në dorë burime të tjera (shpesh të paligjshme) të ardhurash. Nga njëra anë, avantazhi i të qenurit në pushtet është rritur dhe për rrjedhojë është rritur mundësia për oligarki. Nga ana tjetër, të gjitha partitë kanë më pak fonde dhe për rrjedhojë rritet edhe perspektiva e parëndësisë dhe fragmentimit, kur asnjë prej tyre nuk ia del që të lidhet me publikun e synuar.

d. Largimi i qytetarit nga politika dhe plogështia politike

Problemi nuk ka thjesht të bëjë me rënien e pjesëmarrjes së njerëzve në jetën e partive (forma të tjera të pjesëmarrjes politike mund ta zëvendësojnë këtë) ose me faktin që dhurimet private janë duke u zvogëluar (të tjera burime, sidomos burimet publike janë rritur). Cinizmi lidhur me motivet dhe praktikat e politikanëve është rritur aq shumë, sa një pjesë e popullsisë mendon se korrupsioni politik është “biznes i zakonshëm”.

Këto probleme janë pjesërisht probleme të brendshme të demokracive “të vërteta”. Ato janë, gjithashtu, të lidhura ngushtë me sfidat dhe mundësitë e jashtme të ravijëzuara në Pjesën I.

Globalizimi dhe pasojat e tij përbëjnë një nga sfidat më të mëdha të partive në Europë. Së pari, liberalizimi i tregtisë do të thoshte që paratë mund të lëviznin gjithnjë e më lirshëm përtej kufijve kombëtarë, çka shtoi mundësitë e partive për të siguruar mbështetje financiare dhe kjo gjë dëshmoi se ishte jetësore për opozitën, që luftonte për demokracinë në vendet post-komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore dhe ish-Bashkimit Sovjetik. Gjithsesi, liberalizimi i tregtisë parashtron gjithashtu një dilemë për demokracitë e konsoliduara, të cilat përpiqen që t'i bëjnë rezistencë depërtimit të fondeve të huaja në zgjedhjet e vendit të tyre dhe në procesin e tyre politik. Së dyti, globalizimi përqendron paratë në duart e korporatave shumëkombëshe dhe individëve të pasur, që e bëjnë mbledhjen e fondeve më të lehtë për partitë. Megjithatë, kjo gjë i bën partitë më të ekspozuara ndaj akuzave se partitë janë bërë në mënyrë të tepruar të varura nga interesat e bizneseve. Kur kjo gjë ndodh në gjithë spektrin politik, përforcohet perceptimi popullor se “të gjitha partitë njësoj janë” dhe, për rrjedhojë, është e kotë që të përpiqesh të zgjedhësh mes tyre.

Integrimi European paraqet një sfidë të ngjashme. Prirja për të integruar në shkallë rajonale tregjet, profesionet dhe politikat bie në kundërshtim me një nga premisat kryesore të sistemit ekzistues të partive: që partitë kanë përgjegjësinë për të organizuar konkurrencën politike bazuar në një njësi territoriale sovraane, në shtetin komb. Për shembull, njerëzit, që jetojnë dhe punojnë në një vend të ndryshëm nga vendi i nënshtetësisë së tyre, shpesh e kanë të ndaluar që të financojnë partitë e shtetit ku banojnë. Ndërkohë që firmat e çdo vendi anëtar të BE-së kanë të drejtë që të bëjnë dhurime për partitë, përjashtoj ato në zotërim të huaj nga jashtë BE-së.

Ndryshimet Teknologjike kanë revolucionarizuar me të vërtetë fushatat dhe në disa vende janë duke ndikuar dhe në mbledhjen e fondeve. Televizioni e ka vendosur veten si mjete kryesor për të komunikuar me publikun e gjerë gjatë zgjedhjeve. Në varësi të përzierjes së kanaleve private dhe publike si dhe të përmbajtjes së rregullave për dhënien e licencës, kjo gjë ka ngritur në mënyrë të ndjeshme koston

financiare të fushatave dhe ka zhvlerësuar rëndësinë e punës vullnetare të anëtarëve të partisë. Kjo gjë ka rritur gjithashtu fokusin tek personaliteti i kandidatëve në kurriz të popullaritetit të platformave të partive, pasi personaliteti i kandidatëve është gjëja, që projektohet më mirë nga kjo formë komunikimi masiv, që varet në mënyrë të tepruar nga koha e transmetimit.

Është shumë herët që të thuhet nëse informacioni dhe teknologjia e komunikacionit, në mënyrë të veçantë interneti, do të provokojnë një revolucion të ngjashëm. Interneti, me sa duket, ka potencialin që të zbrapsë priren drejt kostove marramendëse dhe, për rrjedhojë, të vendosë në kushte të barabarta konkurrencën mes partive të vogla dhe atyre të mëdha, partive të varfra dhe atyre të mirëfinancuara. Gjithashtu, ka shenja të qarta që tregojnë se partitë po provojnë gjerësisht këtë mjet për të komunikuar me anëtarësinë, donatorët potencialë dhe me votuesit e mundshëm. Asnjë parti nuk mund t'ia lejojë vetes që të mos ketë një faqe interneti. E njëjta gjë vlen edhe për kandidatët individualë dhe për përfaqësuesit e zgjedhur. A do të ketë zgjerimi i shpejtë i komunikimit të drejtpërdrejtë (dhe për rrjedhojë edhe i votimit elektronik) si efekt dëmtrimin e mëtejshëm të formave tradicionale të organizimit dhe anëtarësisë në parti?

Ndjesia e pasigurisë ka një efekt domethënës jo të drejtpërdrejtë mbi organizimin dhe aktivitetin partiak. Siç kemi parë më sipër, rritja e kërkesës për para (dhe ulja e furnizimit me anëtarë) i bën partitë më të zbuluara ndaj praktikave të korruptuara, të cilat mund të rrisin ndikimin e krimin të organizuar, i cili është një burim potencial për fondet e munguara. Dhe, me thënë të drejtën, disa teknika të financimit të paligjshëm të partive, u ngjajnë shumë pastrimit të parave dhe disa mjeteve të tjera për të siguruar para me forma, që nuk dallojnë shumë nga shantazhi dhe gjobat.

Sa më shumë që partitë të përdorin këtë burim të fshehtë financimi, aq më shumë do të përforcohet tendenca tashmë ekzistuese për t'i konsideruar partitë aq shumë të korruptuara, sa e kanë të pamundur që të luftojnë krimin e organizuar.

Askush nuk është i aftë të gjykojë se sa janë duke ndikuar sjelljen dhe statusin e partive në Europë burimet e huaja të pasigurisë, shtetet armiqësore dhe organizatat kërcënuese joshtetërore. Në një të kaluarë jo dhe aq të largët, “kontributet” e fshehta të Bashkimit Sovjetik u përdorën për të diskredituar partitë komuniste kombëtare, po ashtu sikurse ndodhi në periudhën mes dy luftërave botërore me “transferimet” ndërkombëtare

të fashistëve dhe nacional-socialistëve. Në kontekstin bashkëkohor, financimi transnacional i organizatave simpatizante dhe të shoqërisë civile në shtetet në proces demokratizimi, është bërë një praktikë e njohur haptazi, e cila nuk duket se ka çenuar reputacionin e përfituesve. Qarkullimi i parave në drejtimin e kundërt, pra, nga qeveri autokratike tek parti të vendeve demokratike, është një një krejt tjetër. “Lufta kundër terrorizmit” dhe “lufta kundër drogës” kanë përqendruar shumë vëmendje tek trafiku ndërkombëtar i financimeve të fshehta, por deri tani partitë politike europiane kanë shpëtuar nga ndonjë zbulim i sikletshëm.

Një sistem partiak europian : një digresion

Partitë politike europiane mund të ofrojnë një përgjigje ndaj rënies së autonomisë së shtet-kombit dhe ndaj rënies paralele të anëtarësisë në partitë politike kombëtare. Zhvillimi i një sistemi partiak të mirëfilltë në vendet anëtare të BE-së do të përbënte një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një *demos-i* europian me një nënshtetësi dhe elektorat të dallueshëm. Duke patur parasysh asimetrinë, që ekziston midis rëndësisë dhe funksioneve të parlamenteve kombëtare dhe Parlamentit Europian, mund të themi se për një të ardhme të afërt, këto parti vështirë se do të zëvendësojnë partitë e konsoliduara kombëtare. Për të mos folur pastaj për vështirësitë thelbësore, që ekzistojnë për krijimin e identiteteve partiake në një shkallë kaq të gjerë dhe për një popullatë me tipare gjuhësore dhe kulturore kaq heterogjene.

Transferimi i kompetencave ekonomike dhe politike prej nivelit kombëtar tek ai europian nuk është shoqëruar (deri tani) nga një transferim i legjitimitetit demokratik. Institucioneve të BE-së u mungon legjitimiteti i partnerëve të tyre kombëtare dhe hendeku midis qytetarëve të BE-së dhe institucioneve europiane, me sa duket, sa vjen e rritet. Anketat e opinionit publik tregojnë se shumë njerëz i konsiderojnë institucionet e BE-së si të largëta, burokratike dhe jodemokratike. Deficiti demokratik thellohet nga politikanët kombëtarë, të cilët kanë prirjen që të përdorin Bashkimin Europian si kokë turku, dhe nuk shpjegojnë rolin e tyre në përqafimin e legjislacionit europian. Mungesa e një *demos-i* europian demonstron qartë nga diferenca midis pjesëmarrjes në votimet për zgjedhjet e parlamentit kombëtar dhe atij europian.

Ekzistenca e një *demos-i* europian fillimisht do të kërkonte një rritje të rëndësisë së çështjeve politike europiane (përkundrejt atyre kombëtare). E ngjeshur midis dallimit tradicional, që ekziston ndërmjet politikave të

brendshme dhe atyre të jashtme, rëndësia e dimensionit të ri rajonal nuk është e qartë sa duhet për ata, që ndikohen nga ky dimension. Sikur ta dinin europianët se sa shumë çështje, që dikur i takonin kategorisë së politikave të brendshme, janë transferuar në një nivel rajonal, ata do të ishin më të gatshëm që të organizoheshin përtej kufijve kombëtarë për të themeluar dhe financuar parti transnacionale. Me sa duket ata nuk janë dhe aq në dijeni të faktit që interesat e tyre strukturohen në zgjedhjet europiane dhe në Parlamentin European nga “federata” të partive kombëtare, që nuk kanë një platformë të përbashkët. Kjo gjë thjesht përmbledh dhe riprodhon në mënyrë sipërfaqësore divergjencat, që janë krijuar historikisht brenda çdo shteti anëtar, dhe nuk respekton dhe nuk reflekton divergjencat, që kapërcejnë këta kufij kombëtarë.

Një arsye, që ka çuar në mungesën e partive të pastra europiane lidhet me mënyrën se si zhvillohen zgjedhjet për Parlamentin European. Ato nuk zhvillohen në mënyrë të njëjtë në vendet anëtare. Edhe pse në zgjedhjet e fundit të gjitha vendet kanë përdorur pak a shumë të njëjtin sistem të përfaqësimit proporcional, rregullat për përcaktimin e vendeve dhe të zonave elektorale vazhdojnë të jenë të ndryshme. Zgjedhjet nuk zhvillohen në një ditë, dhe ato herë rastisin dhe herë nuk rastisin që të zhvillohen me zgjedhjet lokale, bashkiake ose rajonale. Për pasojë ne kemi ato, që quhen “zgjedhje të dorës së dytë”, qëllimi në dukje i të cilave është që të zgjedhin përfaqësuesit për Parlamentin European ku do të merren me çështje europiane, porse procesi në të vërtetë reflekton çështjet, që ekzistojnë brenda çdo shtet-kombi. Nuk ka nevojë që të thuhet se qytetarët europianë e dinë mirë këtë gjë, prandaj i përdorin këto zgjedhje kryesisht për t’u dërguar një mesazh pushtetarëve kombëtarë, shpesh një mesazh pakënaqësie duke votuar për kandidatët më ekstremë pasi e dinë që nuk do të qeverisen prej tyre. Prej vitit 1979, çdo zgjedhje pasardhëse ka tërhequr në mënyrë proporcionale më pak votues. Kjo gjë ka ndodhur në pothuaj çdo shtet anëtar, pavarësisht nga fakti që fuqitë efektive të Parlamentit European janë shtuar haptazi gjatë së njëjtës periudhë.

Grupet politike brenda Parlamentit European nuk funksionojnë dhe nuk mund të funksionojnë si parti europiane. Jo vetëm sepse përbërja e tyre është shumë heterogjene - partitë e vendeve të ndryshme anëtare mund të kenë një përbërje sociale dhe program shumë të ndryshëm edhe kur grupohen nën të njëjtën sigël - por ato gjithashtu nuk kanë një infrastrukturë efektive të organizimit. Për shembull, ato kanë pak rol ose pothuaj fare në përzgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet e Parlamentit

European. Financimi i tyre ka kohë që është bërë një çështje misterioze si pasojë e mungesës së transparencës dhe monitorimit të pamjaftueshëm. Shpenzimet janë lënë në mënyrë ekskluzive në dorën e partive kombëtare, që marrin drejtpërsëdrejti nga Parlamenti European subvencione për të mbuluar kostot e fushatës. Në të vërtetë, sikurse vumë re më sipër, këto parti i mbështesin përpjekjet e fushatës kryesisht tek çështjet kombëtare dhe nuk kanë ndonjë motiv për t'u përqendruar vetëm tek çështjet europiane.

Shoqëria civile

Pothuaj çdo student i demokracisë bashkëkohore e di se prania e një shoqërie civile funksionuese dhe të gjallë, që ushtron “presion” ndaj autoriteteve për të kushtuar vëmendje ndaj lirive, të drejtave, interesave dhe çështjeve, kontribuon në mënyrë pozitive qoftë për qëndrueshmërinë e demokracisë, qoftë edhe për cilësinë e saj, dhe kjo vlen jo vetëm për Europën dhe Amerikën. Duhet pasur parasysh se shoqëria civile kontribuon, por nuk është në vetvete shkak i demokracisë. Shoqëria civile nuk mund të sjellë e vetme demokraci. Po ashtu edhe kur është formuar, ajo e ka të pamundur që e vetme të jetë e aftë të mbështesë dhe përmirësojë proceset demokratike. Siç do ta shohim, shoqëria civile vepron paralel me institucione dhe praktika të tjera siç janë pjesëmarrja e qytetarëve, konkurrenca ndërmjet partive politike, procesi legjislativ, zgjedhjet e lira dhe të ndershme për postet kryesore, kontrolli dhe balancimi ndërmjet institucioneve qeverisëse, shtypi i lirë dhe i larmishëm, qeverisje autonome në nivel vendor dhe rajonal, sundimi i ligjit dhe gjyqësori i pavarur.

Le të përpiqemi ta përkufizojmë shoqërinë civile përpara se të vijojmë me analizën e gjendjes së tanishme të shoqërisë civile në Europë. Shoqëria civile është një grupim ose një sistem i grupeve ndërmjetësuese të vetëorganizuara, që : (1) janë relativisht të pavarura qoftë nga autoritetet publike, qoftë nga njësitë private të prodhimit dhe riprodhimit, të cilat janë firmat dhe familjet; (2) janë të afta të shqyrtojnë dhe të ndërmarrin veprime kolektive për të mbrojtur ose çuar përpara interesat dhe pasionet e tyre; (3) por nuk kërkojnë që të zëvendësojnë as institucionet shtetërore dhe as (ri)prodhuesit privatë dhe as që të pranojnë përgjegjësinë e qeverisjes së gjithë sistemit politik; (4) por, gjithsesi, bien dakord që të veprojnë duke respektuar rregullat e paracaktuara të natyrës “civile”, që do të thotë të natyrës së respektueshme dhe publike.

Njësitë e shumëfishta dhe të larmishme të kësaj shoqërie civile mund të kufizojnë veten duke u përpjekur që të influencojnë, por jo të zëvendësojnë zyrtarët e zgjedhur dhe duke pranuar që ta trajtojnë njëri-tjetrin me respekt, por prania e tyre në jetën politike nuk është një fatmirësi qetësuese. Me fjalë të tjera, thjesht prania e kësaj përzierjeje shoqatash, të cilat veprojnë për të mbrojtur interesat e tyre, dhe lëvizjesh sociale, që mbrojnë interesa të tjerëve, mund të prodhojë si “të mira publike” ashtu edhe “të këqija publike”. Megjithatë, përvoja europiane (dhe ajo amerikane) në afat të gjatë tregon se efektet pozitive të shoqërisë civile mbizotërojnë dukshëm ndaj efekteve negative. Duke patur parasysh sfidat dhe mundësitë e përballura nga shoqëritë bashkëkohore të Europës Perëndimore dhe Lindore, ajo që na intereson neve është nëse kjo prirje do të mbizotërojë në të ardhmen.

Pengesa kryesore për të matur ndryshimet në rolin e shoqërisë civile është natyra gjithnjë e ndryshueshme e vetë subjektit. Ndryshe nga abstenimi në zgjedhje ose besimi publik në institucione, ose lëvizjet në preferencat elektorale ose rritjet e numrit të referendumeve, kur bëhet fjalë për shoqërinë civile, grupet e interesit, lëvizjet shoqërore dhe fondacionet bamirëse, që e përbëjnë atë, nuk mbeten të fiksuar në një formë apo funksion. Me përjashtim të atyre organizatave, që kanë anëtarësi të detyruar dhe që kanë fushë interesi të përcaktuar nga e drejta publike, për shembull “urdhrrat” profesionale, “dhomat” e tregtisë dhe disa sindikata, shumica e njësive të shoqërisë civile janë të lira për të zgjedhur se kë duan të përfaqësojnë dhe si e interpretojnë misionin e tyre. Kjo do të thotë që burimet e tyre materiale dhe statusi i tyre organizativ janë vazhdimisht në mëshirë të ndryshimeve, që ndodhin në strukturën shoqërore, të preferencave të konsumatorëve dhe të qëllimeve politike. Forma shoqatash, që më parë kanë luajtur një rol të rëndësishëm, madje edhe thelbësor për jetën politike, mundet që të zhduken gradualisht. Shpresojmë që të zëvendësohen nga të tjera lloje veprimtarish kolektive autonome. Për shembull, një studiues amerikan i shkencave shoqërore nxori përfundime shumë negative - “ka arsye për të dyshuar se disa parakushte sociale dhe kulturore, që janë thelbësore për të patur një demokraci efikase, mund të kenë pësuar erozion të ndjeshëm gjatë dekadave të fundit” (Democracies in flux, Putnam dhe Goss, 2002, fq. 3) - si pasojë e prirjes së bashkëkombësve të tij për të “luajtur vetëm” duke shpërfillur prirjen e natyrshme për të kërkuar dhe përdorur mjete të tjera për t’u socializuar me njëri-tjetrin dhe për të formuluar politikisht interesat dhe pasionet e tyre të përbashkëta.

Fillimisht le të marrim rastin e sindikatave. Nuk ka dyshim që kjo formë veprimi kolektiv ka një impakt të vazhdueshëm dhe të rëndësishëm në demokratizimin e sistemeve politike europiane dhe për rrjedhojë në jetën e tyre të përditshme politike. Sindikatat kanë luftuar që t'u siguronin anëtarëve dhe punëtorëve në përgjithësi më shumë të drejta dhe janë mobilizuar në mënyrë periodike për të bërë të mundur që përfitimet, që vijnë nga politikat publike të shpërndahen në mënyra të barabarta ndërmjet qytetarëve. Historia e shoqërisë civile e asnjë vendi nuk mund t'i shpërfillë ato ose efektin e gjerë demokratik, që ato kanë patur tek partitë politike, grupet e interesit dhe lëvizjet shoqërore.

Le të analizojmë të dhënat mbi evoluimin afatgjatë të anëtarësisë në sindikata si përqindje e popullsisë ekonomikisht aktive në Europë prej vitit 1972. Në parashikimet e dy progresioneve alternative (njëri linear, tjetri i matur në kohë), denduria e anëtarësisë në sindikata (e cila ishte 28% në periudhën 2001-04) do të jetë afërsisht 25% në periudhën 2010-12 dhe afërsisht 22% në periudhën 2018-20, me kusht që prirjet e tanishme socio-ekonomike të vazhdojnë dhe që të mos ketë ndryshime thelbësore në politikat publike. Nëse marrim në konsideratë vetëm ato vende, për të cilat zotërojmë të dhëna dhe që ishin anëtarë të Këshillit të Europës në fillim të viteve 1970-të, situata nuk ndryshon shumë. Prija është ende relativisht e qëndrueshme dhe denduria e anëtarësisë në vitet 2018-20 projektohet tek 23% dhe jo tek 22% i popullsisë ekonomikisht aktive. Në përgjithësi nuk ka të dhëna krahasuese për sindikatat e Europës Qendrore dhe Lindore dhe ato të republikave të ish-Bashkimit Sovjetik, por ato, që ekzistojnë, sugjerojnë se dendësia e anëtarësisë përputhet me prirjet e vendosura më parë, megjithëse me një nivel më të ulët variacioni.

Pavarësisht nga zërat alarmantë, që parashikojnë zhdukjen e klasës punëtore të organizuar (ose eklipsimin e saj nga punëtorët, që vijnë nga lindja dhe që nuk janë anëtarësuar në sindikata), konkluzioni ynë është më premtues, sidomos po të merren në konsideratë përbërjet sektoriale të punësimit (rënia relative e sektorit të manifakturës, ku dhe niveli i pjesëmarrjes në sindikata ka qenë më i madh), ndryshimi i raportit gjinor te krahu aktiv i punës në favor të rritjes së numrit të grave (më e lehtë ka qenë që të rekrutoheshin në sindikata burrat sesa gratë) si dhe rritja e proporcionit të punëtorëve me kohë të pjesshme (punëtorët me kohë të plotë mund të rekrutoheshin më lehtë). Për shembull, dendësia e anëtarësisë në sindikatat e Shteteve të Bashkuara ra në mënyrë më dramatike, nga 45% në vitin 1970 në 18% në vitin 1995. Megjithatë duket i pashmangshëm konkluzioni, që thotë se rëndësia relative e një prej

kategorive më domethënëse dhe të qëndrueshme të grupimit social nëpër shoqëritë civile të Europës ka për të rënë, por me siguri që nuk ka për t'u "zhdukur".

Vërejmë gjithashtu një prirje të dytë. Në fillim të periudhës së analizës sonë (afërsisht viti 1972), pabarazia në dendësinë kombëtare të anëtarësisë në sindikata numëronte 48 pikë, me një maksimum 68% dhe një minimum 20%. Kjo pabarazi është thelluar goxha si pasojë e hyrjes së vendeve të Europës Jugore në Këshillin e Europës. Është ende e paqartë, nëse kjo pabarazi është një "diversion", që vjen si pasojë e natyrës së demokratizimit të kohëve të fundit dhe e përhapjes së befasishme të lirisë për t'u organizuar, lirisë për t'u mbledhur, lirisë së fjalës dhe të peticionit, pas një periudhe të gjatë represioni, që vinte nga sundimi i një partie, apo nëse kjo pabarazi përfaqëson një tendencë të ngulitur thellë drejt "spekullimit", madje drejt armiqësisë ndaj formave të veprimit kolektiv të demokracive të reja, që bazohen tek përkatësia klasore dhe tek interesa specifike.

Mes sindikatave vihet re një prirje e tretë, që është më e vështirë për t'u dokumentuar. Bëhet fjalë për një prirje drejt uljes së numrit të tyre në çdo nivel bashkimi (kryesisht nëpërmjet shkririjeve) si dhe një rritje të proporcionit të shoqatave të specializuara, që janë anëtare të federatave të niveleve më të larta dhe të konfederatave. Me pak fjalë, lëvizja sindikaliste, me sa duket, po kalon një proces të konsolidimit organizativ, nëpërmjet të cilit njësitë bazë të lëvizjes janë duke e zgjeruar numrin e anëtarëve dhe rrezën e përfaqësimit.

Deri tani ne kemi gabuar duke hamendësuar se evoluimi i anëtarësisë dhe strukturës organizative në një lloj të caktuar shoqate ishte në një farë mënyre emblematike për të gjithë shoqërinë civile. Edhe sikur sindikatat të kishin luajtur historikisht një rol më të rëndësishëm për demokracinë se, ta zëmë, shoqatat e lojtarëve të bouling, prapëseprapë do të kishte mjaftueshëm arsye për të besuar se të tjera lloje shoqatash kanë ndjekur të tjera modele. Tani ne jemi gati duke kryer arsyetimin e gabuar të kundërt duke hamendësuar se të gjitha anëtarësimet në shoqatat vullnetare kanë të njëjtën rëndësi. Falë anketave të rregullta të kryera nga Eurobarometri prej vitit 1977 si dhe Anketës Botërorë të Vlerave 1995-97, kemi të dhëna mbi proporcionin e një kampioni rastësor të popullsisë në njëzetëtetë vende, që pranon se bën pjesë të paktën në një shoqatë. Dy pikat e devijimit (1975-77 dhe 1995-97) pasqyrojnë ndryshimet e mëdha, që ndodhën në anëtarësinë e Këshillit të Europës (së pari në drejtim të Jugut dhe më pas në drejtim të Lindjes), dhe në të dyja rastet ato

zvogëlojnë proporcionin e atyre, që tdeklarojnë se i përkasin një shoqate. Shuma përmbledhëse e gjithë Europës së marrë së bashku (përlllogaritur duke u bazuar në përmasat e vendit) është 47% dhe projeksionet lineare dhe kohore të përlllogaritura për vitin në 2010 do të jenë 48 % (linear) dhe 45% (të përlllogaritura)-- *ceteris paribus*. Nëse përfshihen vetëm vendet e përmendura tashmë në vitin 1972, vlerat përkatëse parashikohen të jenë 50% (2003), 55% (2010) dhe 57% (2020). Nëse përfshihen të gjitha vendet, “shpërndarja” midis rastit më të arritur dhe më pak të arritur ishte 47 pikë në 1975 dhe rezultati marramendës prej 72 pikësh në vitin 2003, ndërsa nëse përfshihen vetëm 18 shtetet anëtare themeluese, 46 pikë në 1975 dhe 61 pikë në 2003.

Kësaj here faktet janë më pak shqetësuese. Me sa duket demokratizimi në Jug dhe në Lindje kanë pasur një ndikim ulës ndaj “aftësive primare për t’u bashkuar në shoqata” në Europë, por përshtypja e përgjithshme lë të mendosh për një qëndrueshmëri të jashtëzakonshme. Nëse nuk ndryshon ndonjë gjë, ata persona në Europën Perëndimore, që janë pjesëtarë në të paktën një shoqatë, në vitin 2020 do të kenë një rritje më të lehtë sesa në vitin 2003. Vëllezërit dhe motrat e tyre mund të jenë më pak të përfshirë nëpër shoqata, por efekti përfundimtar do të jetë vetëm dy ose tre përqind më i vogël.

Le të hedhim një vështrim të dytë mbi të njëjtat të dhëna, por duke përzgjedhur dhe bërë dallimin *grosso modo* ndërmjet dy llojeve të organizatave: së pari, ato, që u japin anëtarëve të tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë shërbime dhe kënaqësi (sociale); së dyti, ato organizata, që në të shumtën e rasteve u bëjnë autoriteteve kërkesa, nga të cilat përfitojnë në mënyrë të tërthortë anëtarët e organizatave si dhe mbarë publiku (politike). Në rastin e parë ne gjejmë grupe, që ofrojnë shërbime sociale, shërbime shëndetësore, shkollim, art, muzikë dhe jetë kulturore, që merren me rininë, sportin, dëfrimin dhe zbavitjen. Në rastin e dytë ne kemi përfshirë sindikatat, shoqatat profesioniste, grupimet e komuniteteve lokale, partitë politike si dhe lëvizjet për të drejtat e njeriut, paqen, zhvillimin e botës së tretë, ruajtjen e burimeve natyrore, mbrojtjen e ambientit, barazinë gjinore dhe kështu me radhë. Në fillimin e periudhës sonë kohore (1974) organizatat politike ishin në mënyrë proporcionale pak më të rëndësishme (55.0% e popullsisë europiane deklaroi se bënte pjesë në të paktën njërën prej tyre) sesa organizatat sociale (51.2%). Sipas vëzhgimeve tona më të fundit (2003), niveli i organizatave politike ka rënë më shpejt (ka shkuar në 33.2%), kur krahasohet me ato sociale (39.5%). Sipas projeksioneve tona, në vitin 2010 vetëm 22.8% e europianëve do të

jenë anëtarë të ndonjë shoqate ose lëvizjeje politike, ndërsa në 2020 ata do të jenë vetëm 13.7% - sërish *ceteris paribus*. Tani kuptohet që shumë gjëra mund të ndryshojnë gjatë kësaj periudhe. Ne kemi arsye për të besuar se pjesëmarrja në organizata të tilla u rrit ndjeshëm gjatë viteve 1950 dhe 1960, gjë që lë të mendosh se shoqëria civile mund të ndikohet nga disa procese ciklike. Por cili do të jetë motivi stimulues për një ndryshim të tillë në të ardhmen? Analiza jonë e mëposhtme nuk ka mundur të dallojë ndonjë proces “natyror” jashtë demokracisë, që do të ketë mundësi ta nxisë këtë ringjallje. Vetëm reformat e ndërgjegjshme dhe konsekuente në rregullat dhe praktikatat e brendshme të demokracisë mund të krijojnë motivet e nevojshme.

Të marrësh përsipër që të punosh në mënyrë vullnetare për një shoqatë dhe të jesh anëtar i një shoqate nuk janë e njëjta gjë. Prandaj është e mundur që të kemi më pak anëtarë, por më shumë vullnetarë për partitë, shoqatat dhe lëvizjet. Të dhënat mbi këtë “vullnetarizëm” janë sporadike dhe kanë shumë variacione, gjë që me sa duket vjen si pasojë e dallimeve të vogla në gjuhën e përdorur në pyetjet e sondazheve, por ato tregojnë se midis vitit 1981 dhe atij 1999 në shumicën e vendeve të Europës Perëndimore ka një ulje graduale. Për Europën Lindore nuk ka të dhëna të ngjashme, qoftë edhe për një periudhë më të shkurtër. Gjithsesi, asnjë nuk do të çuditej po qe se ato do të flisnin për nivele më të ulta, duke patur parasysh trazirat, që kanë shoqëruar ndryshimin e regjimit në këtë rajon.

Dhe tani dalim para një paradoksi interesant. Edhe pse të dhënat janë të shpërndara dhe është e vështirë që të shqyrtohen duke i krahasuar, ato nuk tregojnë ndonjë tendencë drejt uljes së numrit të shoqatave, lëvizjeve, organizatave dhe fondacioneve. Ulja e proporcionit të popullsisë, që deklaroi anëtarësinë në të paktën një prej tyre, me sa duket nuk po dekurajon “sipërmarrësit e organizatave” për të mos krijuar njësi të reja në shoqërinë civile. Është e vërtetë që nuk kemi informacione të besueshme mbi ato organizata, që dështojnë dhe zhduken, megjithatë përshtypja e qartë është se në pothuaj gjithë shoqërinë europiane kemi të bëjmë me një rritje neto. Kjo tregon se universi është duke u bërë gjithnjë e më i specializuar. Gjithnjë e më shumë shoqata, lëvizje, fondacione janë duke kërkuar për anëtarë dhe fonde për të mbështetur përkufizime më specifike të interesave dhe pasioneve kolektive.

Dhe, sikurse kemi vënë re më sipër në lidhje me sindikatat, ka arsye për të besuar se organizatat “tradicionale”, që përfaqësojnë interesat e klasave sociale, sektorëve ekonomikë dhe specializimeve profesionale,

janë duke u bashkuar me njëra-tjetrën dhe, për rrjedhojë, janë duke u pakësuar në numër. Prandaj ky dinamizëm mund të jetë duke ardhur vetëm nga sipërmarrësit, që janë të tërhequr nga interesa dhe pasione të reja. Ne mendojmë se këto interesa dhe pasione janë kryesisht argëtuese, kulturore, arsimore dhe të orientuara nga shërbimet shoqërore, por këtu duhen përfshirë edhe interesa, që lidhen me një larmi “kauzash” si ambientalizmi, të drejtat e njeriut dhe të kafshëve, feminizmi, antiglobalizmi dhe vetë demokracia. Është e vështirë që të dokumentohet kjo zhvendosje drejt “lëvizjeve të reja sociale” përderisa vetë natyra e tyre shpesh e bën të pamundur një llogaritje të saktë të numrave të tyre dhe të anëtarëve të tyre. Megjithatë rritja e veprimeve kolektive “jokonvencionale” të ndërmarra nga këto lëvizje (protestat, peticionet, bojkotet dhe demonstratat) është bërë mëse e dukshme dhe ka kapërcyer kufijtë e sistemeve politike kombëtare. Ajo, që është më pak e dukshme, është lidhja, që ka kjo veprimtari me format më tradicionale të pjesëmarrjes demokratike: votimin, identifikimin partiak, anëtarësinë në sindikata dhe pjesëmarrjen civile. Po ashtu nuk është e qartë nëse të rinjtë, që përbëjnë pjesën më të madhe të pjesëmarrësve në këto forma organizatash, do të ndërpresin këtë veprimtari në një kohë të dytë dhe do të bashkohen me të njëjtat parti dhe shoqata si dhe prindërit e tyre.

Vështrim i përgjithshëm analitik

Sikurse mund të pritej nga ndryshueshmëria e saj brendshme dhe prireja e saj e vazhdueshme për t'u përshtatur, shoqëria civile mbase është ndikuar më shumë se çdo aspekt tjetër i demokracisë nga të gjitha sfidat dhe mundësitë e reja të diskutuara në Pjesën I. Çdonjëra prej tyre duket se ka njëfarë ndikimi tek anëtarësia e shoqatave, përbërja e tyre, numri i tyre, qëllimi i tyre ose baza burimore.

Globalizimi. Këtu ndryshimi kryesor ka qenë përhapja e organizatave joqeveritare trans-nacionale, sidomos e atyre, që mbrojnë një seri kauzash si demokracia, të drejtat e njeriut, çështjet ambientale dhe ato gjinore. Impakti ka qenë veçanërisht i madh në demokracitë e reja të lindjes, ku rëndësia relative e burimeve financiare dhe konceptimeve të pasionit dhe të interesit ka qenë më e shpërpjesëtuar. Në demokracitë më të konsoliduara perëndimore, epiqendra e veprimtarisë së këtyre OJQ-ve shpesh ka qenë vetë globalizimi dhe impakti ekonomik, social dhe ambiental, që ka globalizimi tek qytetarët e shkolluar, të cilët janë të ndjeshëm ndaj dilemave të “ndërvarësisë së ndërlikuar”. Vështirë se ka

ndonjë qeveri në Europë, që nuk është përballur me presionin e organizatave, të cilët kanë pasur burime njerëzore dhe materiale, që vijnë nga përtej kufijve dhe që kanë lidhje influence, që futen thellë tek ajo hapësirë, që ka qenë sferë ekskluzive e influencës së politikës kombëtare. Mbetet për të parë nëse kjo gjë ngushton serinë e zgjidhjeve politike apo zgjeron burimet, që mund të përdoren për të përballuar këto çështje kaq komplekse. Por rezultati i kësaj situatë ka për të patur një efekt domethënës tek efikasiteti dhe legjitimiteti i pushtetarëve si në nivel nacional edhe në atë supra-nacional.

Integrimi European. Direktivat dhe rregullat e BE-së kanë patur ndikim tek shoqëritë civile të vendeve anëtare, kandidatë dhe atyre fqinje, madje kanë çuar në lindjen e një shoqërie civile europiane në fazën embrionale. Përsëri ndikimi kryesor ka qenë tek demokracitë e reja të Lindjes, në mënyrë të veçantë tek ato vende, që janë duke u përpjekur të zbatojnë detyrimet e *acquis communautaire* dhe janë duke konkurruar për të thithur fonde nga programet e ndryshme të BE-së. Në disa fusha politikash si bujqësia dhe fondet rajonale, ushtrimi i një ndikimi në nivel europian është bërë një domosdoshmëri, ndërkohë që për shumicën e rasteve shoqatat dhe lëvizjet kanë prirjen që të punojnë nëpërmjet autoriteteve kombëtare përkatëse. Politikat e BE-së u kanë hapur, gjithashtu, ndërmarrjeve shumëkombëshe mundësi të shumta për të pasur një ndikim të drejtpërdrejtë. Për pasojë, pamja e përgjithshme është shumë e përzierë: pluralizëm për interesa funksionale të specializuara dhe kauza të përzgjedhura nëpërmjet përhapjes së pikave të hyrjes në këtë sistem politik dhe korporativizëm “shumënivelësh” dhe “policentrik” për ata, që janë në nivelin nacional dhe supra-nacional dhe që kanë burime të privileguara ose ndikim të veçantë tek agjenci të caktuara. Goxha mbresëlënëse ka qenë rilindja e përqendrimit të sistemeve kombëtare të politikave si përgjigje ndaj sfidës së dyfishtë, që ka ardhur nga tregu i përbashkët europian dhe bashkimi monetar.

Migracioni ndër-kulturor. Reagimi ndaj rritjes së numrit të migrantëve, azil-kërkuesve dhe refugjatëve, që vijnë nga jashtë Europës, është një ndër sfidat kryesore të shoqërive civile europiane. Historikisht këta “të huaj” kanë qenë asimiluar në kulturat kombëtare dhe më pas u futën në sindikatat, shoqatat profesionale dhe organizatat e tjera ndërmjetësuese, që ekzistonin paraprakisht. Atëherë, kur ata krijuan shoqatat dhe lëvizjet e tyre, u mendua se këto të fundit do të ishin një fazë tranzicionale drejt integritimit përfundimtar. E veçantë në situatën e sotme është prania e një numri të madh rezidentësh të huaj, që këmbëngulin për

të drejtën për të qëndruar të ndryshëm dhe, për rrjedhojë, për të krijuar shoqëritë e tyre civile. Ata jo vetëm që kërkojnë që organizatat e tyre të njihen, por edhe që ato të kenë mundësi veprimi dhe ndikim. Por këtë gjë e bën akoma më të diskutueshme fakti që të huajt vijnë shpesh nga vende, që kanë ndarje të thella brenda tyre, në mos kanë edhe konflikte të brendshme të dhunshme. Një ndër gjërat më të vështira për të parashikuar në Europën bashkëkohore është nëse këto pretendime për të ruajtur dallimet do të provokojnë një reagim “jo-civil” nga ana e vendasve dhe partive, shoqatave dhe lëvizjeve të tyre ekzistuese ose nëse ato do të kontribuojnë në diversifikimin pluralist të modeleve të konkurrencës politike dhe në tolerancën shoqërore.

Prirjet demografike. Impakti i kësaj prirjeje mund të matet relativisht lehtë. Njerëzit më të moshuar janë duke u bërë një pjesë gjithnjë e më e rëndësishme për shoqatat ekzistuese, sidomos për sindikatat, ose janë duke krijuar organizata të specializuara, që përfaqësojnë interesat e pensionistëve. Të rinjtë janë gjithnjë e më pak të prirur për t’u anëtarësuar në shoqatat ekzistuese (ose për të marrë pjesë në politikë në përgjithësi) dhe janë duke shpalosur gjithnjë e më shumë dinamizëm për një sjellje “jokonvencionale” të lëvizjeve të reja shoqërore. Kjo situatë ka shkaktuar një çekuilibër në shpërndarjen e kapaciteteve organizative dhe një përzjerje më pak homogjene të strategjive politike ndërmjet brezave dhe, për rrjedhojë, ka shkaktuar një prirje drejt politikave publike të deformatuara, që shkojnë në dobi të të moshuarve si dhe një rezistencë në rritje të reformave fiskale dhe reformave të tjera, që ndërmerren për të përmirësuar këtë çekuilibër. Po qe se të rinjtë, që janë politikisht të lënë mënjana, nuk gjejnë në të ardhmen, kur të rriten, hapësira në shoqëritë civile nacionale dhe supra-nacionale të reformuara, efikasiteti i regjimit dhe, së fundmi, legjitimiteti ka për t’u dëmtuar.

Ecuria e ekonomisë. Të gjitha shoqëritë europiane, përfshi këtu edhe ato shoqëritë më të varfra të Lindjes, kanë mjaftueshëm burime njerëzore dhe materiale për të mbajtur në këmbë një numër të madh dhe të larmishëm të organizatave të shoqërisë civile. Padyshim që nivelet e larta të papunësisë dekurajojnë pjesëmarrjen individuale dhe rrisin kërkesën për organizatat, që ofrojnë shërbime, por kjo gjithë kompensohet nga rritja e punës vullnetare dhe rritja e kontributeve, që jepen nga ata, që janë më të favorizuar nga *konjuktura*. Edhe qeveritë janë më të varura nga institucionet ndërmjetësuese për të zbatuar programet shoqërore dhe kjo gjithë mund të rrisë të ardhurat e shoqatave. Fakti që ecuria ekonomike europiane ka qenë përgjithësisht më e dobët se ajo e Shteteve të

Bashkuara gjatë dekadës së fundit, me sa duket, nuk ka ndikuar shumë tek shoqëritë civile respektive. Kjo gjë thjesht ka nxjerrë në pah kontrastin, që ekziston midis cilësisë së jetës në Amerikë dhe asaj në Europë, ku nivelet e solidaritetit shoqëror dhe organizimit të bashkësive janë më të larta.

Ndryshimi teknologjik. Asnjë sfidë dhe mundësi tjetër nuk ka pasur ndikim më të madh tek shoqëria civile se ndryshimi teknologjik. Shumë nga organizatat e shoqërisë civile kanë përfituar nga novacionet e teknologjisë së informacionit dhe komunikacionit, madje kanë shërbyer për ta përhapur këtë teknologji në të gjithë shoqërinë. Kostoja, me të cilën mund të kontaktohen anëtarët dhe të kërkohet ndihma e tyre, është zvogëluar në mënyrë tronditëse. Janë formuar rrjete, që lidhin me njëra-tjetrën në distanca të larta, madje përtej kufijve kombëtarë, nisma, që më parë ishin lokale dhe të ndara, dhe kanë treguar se janë efikase në koordinimin e sjelljes së aktivistëve të tyre në një nivel mbarëeuropian. Kjo nuk do të thotë se teknologjia e informacionit ka qenë një fatmirësi e pakundërshtueshme. Është ende e paqartë se sa shumë ndikon koha e harxhuar duke punuar në internet në zvogëlimin e kohës, që individët, sidomos të rinjtë, kalojnë duke ndërvepruar me njëri-tjetrin. Ftesat e dërguara me postë ose me internet kanë mundur të krijojnë dhe sponsorizojnë një numër të madh “shoqatash dhe lëvizjesh virtuale” me anëtarë, që nuk takohen asnjëherë me njëri-tjetrin dhe që kanë pak ose aspak njohuri dhe kontroll mbi gjërat, që bëjnë liderët e këtyre organizatave në emrin e tyre. Shumë nga këto organizata janë të mbushura me staf profesionist dhe organizohen në mënyrë shumë të ngjashme me firmat fitimprurëse, duke pasur “konsumatorë”, që marrin shërbime dhe të mira materiale në këmbim të kontributeve, që japin.

Kapaciteti shtetëror. Në disa prej demokracive të reja çështja kryesore ka qenë nëse tranzicioni prej regjimit autoritar shoqërohej, gjithashtu, me një ndryshim në kufijtë gjeografikë dhe në identitetet kolektive. Ndarja e shteteve shumëkombëshe të dikurshme ka sjellë problemin e pluralitetit të shoqërive civile brendapërbrenda së njëjtës njësi politike dhe prospektivën e marrëdhënieve jo dhe aq “civile” mes tyre. Në disa raste kjo gjë është zgjidhur në mënyrë paqësore nëpërmjet një procesi shkëputjeje të pranuar nga të dyja palët. Por edhe në këto raste ka pasur ndasi serioze midis shumicës kombëtare “titullare” dhe minoriteteve kombëtare të ndryshme. Po për shumicën e Europës çështja ka qenë krejt ndryshe: si do të mund të përballojnë shoqëritë civile kombëtare të konsoliduara rënien e kapacitetit të shteteve të tyre për të përmbushur në

mënyrë efektive dhe autonome detyrat, që priten nga qytetarët? Këtu problemi nuk është shpërbërja kombëtare, por integrimi ndërkombëtar. Çfarë mund të bëjnë organizatat e shoqërisë civile, kur shtetet, që ato janë përpjekur të ndikojnë, janë bërë pjesë e një procesi më të gjerë të “bashkimit të sovranitetit”? Përgjigja e thjeshtë është që të riorganizohen duke kapërcyer kufijtë kombëtare dhe të zgjerojnë shkallën e veprimeve kolektive. Fatkeqësisht, kjo do të thotë që të kapërcehen dallimet e thella të kulturës kombëtare, të gjuhës kombëtare dhe të formatit organizativ kombëtar. “Shoqëria civile europiane” pasuese mund të jetë shumë më pak efektive dhe të anojë drejt favorizimit të interesave dhe pasioneve, që më parë ishin kombëtare.

Karakterizimi individual. Sikur kjo sfidë të ishte shumë serioze, atëherë nuk do të kishte mundësi për zhvillimin e një shoqërie civile. Po qe se çdo qytetar i veçantë do të kishte kushte pune, kontekste jete, modele lëvizshmërie dhe gjendje familjare të ndryshme, probabiliteti për të vepruar në mënyrë kolektive dhe vullnetare me të tjerët do të zvogëlohej jashtëzakonisht. Fatmirësisht kjo gjë nuk ka ndodhur dhe qeniet njerëzore kanë një talent të brendshëm për të zbuluar qëllime të reja të përbashkëta. Megjithatë kjo do të thotë se disa kategori të gjera (“gjithëpërfshirëse”) social-politike të bazuara tek klasa, raca, feja, ideologjia dhe kombësia kanë kultivuar koncepte më të fragmentuara dhe personalizuara të interesit personal dhe pasionit kolektiv. Ka mundësi që kjo gjë të ndihmojë në shpjegimin e ritmit të lartë dhe të vazhdueshëm të krijimit të shoqatave dhe lëvizjeve të reja, që kanë objektiva më të specializuara, dhe të rënies së formave më tradicionale të organizimit siç është sindikata. Një tjetër pasojë e qartë e këtij transformimi është zvogëlimi i probabiliteti për të arritur një “kontratë sociale” të pranuar gjerësisht dhe, për pasojë, një model më pak të rregullt dhe të parashikueshëm për negocimin e interesave dhe pasioneve. Kjo gjë ndihmon gjithashtu për të shpjeguar përse partitë politike kanë gjithnjë e më pak lidhje me shoqatat dhe lëvizjet dhe kanë humbur funksionin historik të grumbullimit të qytetarëve nën klasifikime të përgjithshme “ideologjike”.

Mediatizimi. Më parë organizimet në shoqërinë civile luanin një rol të rëndësishëm në furnizimin e anëtarëve dhe simpatizantëve me informacion politik duke ndihmuar në këtë mënyrë në formimin e koncepteve të interesave dhe identitetit. Ditëve të sotme masmedia, sidomos televizioni, kanë përvetësuar këtë funksion dhe çdo informacion i specializuar, që vjen nga shoqatat dhe lëvizjet zakonisht duhet të

konkurrojë me burimet rivale komerciale. “Shtypi partiak” pothuaj është zhdukur dhe qarkullimi i buletineve dhe gazetave të sindikatave dhe grupimeve profesionale sa vjen e ulet. Interneti, sikurse e përmendëm më sipër, është duke ofruar mjete më të reja dhe më të lira për të përcjellë mesazhin, por konkurrenca për të shtënë në dorë vëmendjen është bërë më e ashpër dhe publiku është më pak i vëmendshëm se më parë. Komercializimi mund të banalizojë (dhe skandalizojë) informacionin për politikën, por gjithashtu ka ndihmuar në çlirimin e qytetarëve nga manipulimi partiak dhe propaganda qeveritare. Për ata persona, që duan të marrin pjesë në proceset e llogaridhënies demokratike mënyrë të informuar (numri i të cilëve fatkeqësisht po bie), ka shumë më shumë burime të tjera se në të kaluarën dhe shfrytëzimi i tyre është më i lehtë dhe më pak i kushtueshëm. Por ata persona nuk përdorin mundësinë për të shkëmbyer dhe vepruar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ndër-personale në atë, çka karakterizonte më parë “sferën publike”.

Ndjesia e pasigurisë. Këtu ne zbulojmë një paradoks tjetër. Në të kaluarën asgjë nuk prodhonte më shumë shoqërueshmëri sesa forma më kërcënuese e pasigurisë, lufta ndërkombëtare. Gjatë luftës së parë dhe të dytë botërore, anëtarësia në një sërë organizatash politike dhe sociale u ngrit në mënyrë të jashtëzakonshme dhe shumë organizata të reja u themeluan gjatë dhe menjëherë pas këtyre episodeve të dhunës masive. Tani Lufta e Ftohtë ka mbaruar dhe Europa ka ndërtuar në mënyrë efektive një “bashkësi ndërkombëtare të sigurisë” në rajon, çka do të thotë se vendeve përbrenda rajonit nuk u shkon ndërmend që, për të zgjidhur problemet mes tyre, të përdorin forcën e armës ose të shkojnë në luftë me njëri-tjetrin. Kjo shtysë e fuqishme për zhvillimin e shoqërisë civile është zhdukur. Është vetëm perceptimi i rreziqeve të shmangshme, që vijnë nga fqinjët, dhe i pasojave të mundshme të këtyre rreziqeve, që ndihmon në ngritjen e formave të reja të veprimit kolektiv vullnetar. Mirëpo ky stimul jo vetëm që është i dobët, por edhe përçarës. Manifestimi më i dukshëm i tij në Europën bashkëkohore është mobilizimi i vendasve kundër të huajve dhe i të huajve të ligjshëm dhe të paligjshëm për të mbrojtur veten dhe të drejtat e tyre.

Vendimmarrja

“Ruajtja e rojeve”

Në demokracitë bashkëkohore europiane janë duke luajtur një rol gjithnjë e më të madh një grup institucionesh jo-demokratike dhe jo-maxhoritare.

Në këtë seksion ne do të përqendrohemi tek të ashtuquajturat institucione “roje” (institucione, që përbëhen nga ekspertët) dhe tek zhvillimi i “qeverisjes” së ndërthurur, rregullatore dhe shumënivelëshe. Me “qeverisje” ne nënkuptojmë modelet e vendimmarrjes, që përfshijnë aktorë të ndryshëm publikë dhe privatë, veprimet e të cilëve nuk janë të koordinuara vetëm nga mekanizmat hierarkike ose/dhe mekanizmat e tregut. Jashtë dhe ndërmjet këtyre dy mekanizmave tradicionalë të përcaktimit ka një larmi mënyrash të reja qeverisjeje, që përdorin rregullime të tjera manovrimi për të prodhuar politika të caktuara.

Legjitimiteti demokratik, rojet dhe qeverisja

Në shoqëritë moderne legjitimiteti politik kërkon që për çështjet me interes publik dhe të përbashkët të merren vendime në mënyrë demokratike. Që një sistem qeverisjeje të konsiderohet demokratik duhet që opinionet e qytetarëve të përfaqësohen lirshëm në mënyrë që të dëgjohen dhe të merren parasysh nga pushtetarët, të cilët nga ana tjetër duhet të japin llogari para qytetarëve për veprimet dhe vendimet e tyre.

Një aspekt i rëndësishëm i legjitimitetit demokratik është që qytetarët të besojnë se kanë mjaftueshëm mundësi për të ndikuar rezultatet e procesit të vendimmarrjes për çështje, që do të ndikojnë në jetën e tyre.

Kjo nuk do të thotë që të gjitha vendimet kolektive, që janë të detyrueshme për të gjithë, duhet të ndërmerren në mënyrë demokratike. Edhe pse mund të kenë rëndësi ekonomike dhe shoqërore, shumë vendime konsiderohen vendime private dhe lihen në dorën e individëve, familjeve dhe shoqatave. Disa nga këto vendime lihen në dorë të marrëveshjeve kontraktuale vullnetare, që bëhen midis palëve të interesuara ndërkohë që të tjera ndërmerren nëpërmjet mekanizmave më automatikë të koordinimit siç është tregu. Për më tepër, një pjesë e mirë e jetës së zakonshme të qytetarëve zhvillohet në strukturat organizative të punës, profesionit, shkollimit, besimit dhe zbavitjes, të cilat veprojnë duke u bazuar në parime përcaktimi hierarkike. Arsyet pse këto fusha të vendimmarrjes shoqërore janë të izoluara nga kriteret dhe procedurat demokratike, kanë të bëjnë me intimitetin, efikasitetin organizativ dhe/ose koordinimin e ndërlikuar. Vënia në përdorim e këtyre arsyeve shpesh ngjall diskutim, megjithatë pranohet gjerësisht si pjesë e jetës demokratike.

Megjithatë, vendimmarrja jo-demokratike shtrihet në shumë institucione publike si sistemi ligjor, policia, ushtria dhe administrata publike, të cilat zakonisht janë të organizuara sipas kriterit hierarkik. Kjo vjen si pasojë e funksionalitetit dhe e natyrës organizative të ndërlikuar të këtyre institucioneve. Gjithsesi, institucionet publike nuk janë tërësisht autonome dhe nuk veprojnë vetëm në bazë të rregullave të brendshme. Kjo gjë garantohet nga nënshtrimi ndaj pushtetit të qeverive dhe parlamenteve.

Gjatë njëzet ose tridhjetë viteve të fundit ka pasur një gërryerje të vazhdueshme të fushëveprimit të vendimmarrjes demokratike. Kjo ka ndodhur nga *brenda* dhe *jashtë* politikës. Brenda, kufizimet vijnë si pasojë e faktit që institucionet roje merren me problemet e politikave dhe rregullave duke u mbështetur tek njohja e specializuar dhe tek ekspertët, që janë të izoluar nga konkurrenca partiake, opinioni publik dhe vendimmarrja e shumicës. Kufizimet e jashtme shfaqen ndërkohë që politikat publike janë duke u vendosur gjithnjë e më shumë nëpërmjet marrëveshjeve, që bëhen brenda rrjeteve të ndërlikuara të qeverisjes duke përfshirë “aktorë” publikë dhe privatë, por jo elektoratin. Për rrjedhojë ne kemi një rënie të përgjegjësisë politike dhe të llogaridhënies publike.

Rezultati i përgjithshëm i këtyre zhvillimeve ka qenë zhvendosja e balancës së vendimmarrjes kolektive dhe publike nga politika tek administrata, nga demokracia tek teknokracia, kjo gjë *de facto* në mos *de jure*, zvogëlon hapësirën për zërin, ndikimin dhe kontrollin e qytetarëve pavarësisht nëse veprojnë ose jo në mënyrë të drejtpërdrejtë me anën e përfaqësuesve të tyre. Zhvendosjet janë nxitur ose mbështetur gjithashtu nga një seri prirjesh të brendshme të demokracisë sikurse janë oligarkia, autonomia funksionale, profesionalizimi dhe korrupsioni.

Prirja drejt oligarkisë. “Ligji i hekurt” i oligarkisë favorizon në mënyrë të qartë dominimin e institucioneve roje. Ndryshe nga partitë dhe përfaqësuesit politikë, ato janë të përjashtuara nga kontrolli i drejtpërdrejtë i publikut dhe si të tilla nuk japin llogari para publikut.

Prirja drejt autonomisë funksionale. Kjo prirje ka të bëjë me jetën politike po aq sa ka të bëjë me fusha të tjera të jetës shoqërore, duke qenë se vendimmarrja kërkon gjithnjë e më shumë njohuri dhe ekspertizë të specializuar. Në vend që të gjitha rregullat të jenë njësoj të detyrueshme për të gjithë, procesi politik bëhet gjithnjë e më i copëzuar në detyra funksionale specifike, secila prej të cilave ka logjikën dhe nevojat e veta.

Si pasojë, grumbuj të caktuar interesash bëhen pika e vetme e referencës për rojet, që janë caktuar për të rregulluar sjelljen e tyre dhe këto grupe private kanë prirjen që ta “kapin” rojën e tyre duke manipuluar asimetritë e informacionit dhe pushtetit.

Prirja drejt profesionalizimit. Ky është një zhvillim, që ndodh si nga pushtetarët roje ashtu edhe nga klasa politike. Në fakt, siç kuptohet nga vetë përkufizimi, rojet kanë këtë rol si pasojë e nevojës për forma njohurie të prodhuara vetëm brendapërbrenda profesioneve të certifikuara, avokatëve, ekonomistëve, teoricienëve të sistemeve, menaxherëve, kontabilistëve, ushtarakëve, studiuesve të shkencave sociale dhe kështu me radhë. Siç kemi parë në analizën tonë për prirjet brenda partive, politikanët janë gjithashtu duke u bërë më të specializuar ose, në mos janë vetë, ata janë duke u bërë gjithnjë e më të varur ndaj atyre, që janë specialistë: konsulentëve, sonduesve të opinionit publike, këshilltarëve të medias, etj. Ndërsa institucionet roje supozohet të kenë shkallë të ndryshme të pavarësisë, ato gjithashtu supozohet se u nënshtrohen kontrollit dhe presionit nga qeveria. Kur të dyja anët e ekuacionit janë më profesionale, rezultati më i vetëkuptueshëm është prirja për të përjashtuar amatorët, d.m.th. popullsinë e ndikuar duke qenë se kjo popullsi nuk është mjaftueshmërisht e informuar dhe e ndërgjegjshme lidhur me atë, çka nevojitet për të realizuar një veprimtari funksionale “të mirë”.

Prirja drejt korrupsionit. Më saktë, fakti që institucionet roje shmangen nga presioni publik dhe janë të izoluara nga ekspertiza profesionale i bën ato shumë të pafuqishme ndaj ndikimit të korrupsionit. Një pjesë e kësaj është kaq pjesë përbërëse e mënyrës, në të cilën është ndërtuar vendimmarrja e specializuar dhe sektoriale që të shpërfillë eksternalitetet dhe pasojat e pasyruara. Ajo që duket racionale dhe funksionale për ata, që janë përfshirë drejtpërsëdrejti, duket arbitrare dhe abuzive për ata, që ndikohen në mënyrë të tërthortë. Gjithsesi, më i rëndësishëm është fakti që rojet merren me bërjen e rregullave dhe dhënien e licencave. Kjo krijon mundësi shumë tunduese për të kërkuar përfitime, çka do të thotë krijimin e avantazhit në krahasim me konkurruesit ose edhe statusin e monopolit, gjë që mund të përkthehet në përfitime jashtëzakonisht të larta, një pjesë e të cilave mund t’u jepen si shpërblim autoriteteve të specializuara, që merren me bërjen e rregullave dhe dhënien e licencave.

Tabela 1 më poshtë përmbledh mënyrën si dhjetë sfidat dhe mundësitë e identifikuara në Pjesën I, krijojnë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e formave jo-demokratike të qeverisjes. Tabela i grupon “sfidat dhe mundësitë” në katër kategori kryesore. E para merret me efektet e globalizimit në qeverisje dhe të pakësimit të sovranitetit shtetëror. E dyta thekson rritjen e porozitetit midis hapësirës private dhe asaj publike. E treta paraqet vështirësitë, që ka politika demokratike, kur përballet me nivele më të larta të diferencimit shoqëror. E katërta, dhe e fundit, përshkruan efektet, që kanë teknologjitë e reja (por edhe rritja e rrezikut dhe pasigurisë) në marrëdhënien midis shtetit dhe fuqive private në një anë dhe qytetarëve në anën tjetër.

Tabela 1 – Ndryshime në kontekstin e jashtëm: ndikimi mbi sistemin e qeverisjes arrangements dhe institucionet roje

Sfida dhe shanse	Globalizimi Integrimi european Kapaciteti shtetëror	Globalizimi Integrimi european Kapaciteti shtetëror Ecuria ekonomike	Migrimi ndër-kulturor Rryma demografike Karakterit individual	Ndryshimi teknologjik Mediatizimi Ndjenja e pasigurisë
Roje dhe qeverisje	Proceset e globalizimit dhe ndërkombëtarizimit kanë kontribuar për t'u dhënë një rol më të madh institucioneve roje dhe të qeverisjes Fuqia shtetërore pakësohet deri aty sa ka nevojë të bashkërendojë politikat me shtete të tjera dhe me korporata të fuqishme private si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.	Efekti i kombinuar i këtyre sfidave është të ndryshojë marrëdhënien mes publikes dhe privates, duke pakësuar rolin drejtues dhe sanksionues të institucioneve publike. Për të qenë të efektshme, institucionet politike lipset të jenë instrumente më fleksibël politikash, të	Është më e vështirë për institucionet demokratike që të trajtojnë nevoja dhe qëndrime, që bëhen gjithnjë e më të diferencuara. Institucionet problem-zgjidhëse konsiderohen më të efektshme për t'u marrë me shumëllajshëmë-rinë.	Ndryshimet në kontekstin e informimit dhe komunikimit publik ofrojnë shanse të reja për mbizotërim shtetëror dhe privat. Por edhe teknologjitë e reja e bëjnë më të vështirë që një fuqi e vetme të kontrollojë rrjedhën e informacionit. Teknologjitë e reja pakësojnë kostot e

		cilat synojnë të ndryshojnë modelet e sjelljes aty ku nuk mund të përdorin strategjitë e komandimit dhe kontrollit.		transaksioneve për të marrë informacion dhe për një qeveri të hapur.
--	--	---	--	--

Vështrim i përgjithshëm analitik

Si priirjet e brendshme ashtu edhe zhvillimet e jashtme kanë tendencën të favorizojnë përhapjen e institucioneve roje dhe të qeverisjes. Efekti, që këto institucione kanë mbi ndikimin dhe përgjegjshmërinë demokratike është i ngjashëm me atë, që prodhohet nga institucionet tradicionale administrative e burokratike. Ato zgjerojnë zinxhirin e delegimit dhe, në këtë mënyrë, sa më i gjatë të jetë zinxhiri, aq më i dobët bëhet zëri i qytetarëve. Ato kanë tendencën të kontrollojnë informacionin dhe të veprojnë sikur të kishin monopol mbi dijen dhe ekspertizën në një fushë të caktuar. Duke qenë se nuk ndikohen nga disiplina zgjedhore, ato nuk janë përgjegjëse në mënyrë të drejtpërdrejtë. Megjithëkëtë, këto institucione të reja janë edhe më të pavarura nga pushteti politik sesa agjencitë tradicionale burokratike; ato ndërtohen në mënyrë të tillë që të shmangin politizimin dhe, në rastin e qeverisjes në rrjet, fragmentarizimi i përgjegjësisë politike i bën ato më pak të përgjegjshme.

Përballë fuqisë në rritje të institucioneve të tilla në vendimmarrjen publike, e ardhmja e demokracisë do të varet nga mënyra si merremi me çështje, që ngrihen nga pyetjet e mëposhtme:

1. A mund të kompensohet humbja e dukshme e legjitimitetit demokratik nga forma të tjera të legjitimitetit themelor – që qëndrojnë në themel të – institucioneve “roje” dhe “të qeverisjes”?

2. A mundin institucionet jo-mazhoritare të mbikqyrjes/qeverisjes që të pajtohen me reformat në praktikat demokratike dhe të justifikohen prej tyre?

a. Roli i vendimmarrjes jo-demokratike në shoqërinë demokratike

Për t'u marrë me pyetjen e parë ka nevojë të identifikojmë justifikimet, që jepen normalisht për delegimin e politikëbërjes tek institucionet jo-demokratike. Ashtu si në rastin e administratës publike,

sistemit ligjor dhe ushtrisë, justifikimi kryesor ka qenë nevoja për eficiencë organizative. Por kjo është një kategori mjaft e gjerë, e cila mund të mos ketë vlerë për të gjitha institucionet roje apo qeverisjen e ndërthurur në përgjithësi.

Nga një perspektivë analitike, arsyet, që jepen në mbështetje të institucioneve jo-mazhoritare, pasqyrojnë *kërkesat* me të cilat përballet vendimmarrja publike në shoqëritë e zhvilluara dhe *standardet* e kërkuara për politikëbërjen publike. Kërkesat kryesore janë ato për kompleksitet dhe njohuri të specializuara. Standardet janë ato të praktikitetit, efektshmërisë dhe eficiencës, respektit për shumëllojshmërinë (e nevojave apo identitetit), respekti për shumëllojshmërinë (në zbatim), autonominë dhe sipërmarrjen private. Këto kërkesa dhe standarde anojnë balancën e legjitimitetit politik nga ai i bazuar në pjesëmarrje, akses dhe përgjegjshmëri demokratike, tek ai i bazuar në ecurinë më të mirë të funksioneve dhe të qenurit të kënaqur me rezultatet e përmirësuar.

Tabela 2 – Arsyet në mbështetje të legjitimitetit jo-demokratik

	Kërkesat	Standardet
	<i>Kompleksiteti</i> <i>Njohuritë e specializuara</i>	<i>Prakticiteti</i> <i>Efektshmëria / eficientia</i> <i>Shumëllojshmëria (e nevojave dhe identitetit)</i> <i>Shumëllojshmëria (në zbatim)</i> <i>Autonomia dhe sipërmarrja private.</i>
Kufizime nga brenda sistemit politik	Institucione, që mbrojnë demokracinë Vendimmarrje, që ndikon në fusha shumë të specializuara	Institucione, që mbrojnë pakicat Institucione, që mbrojnë qytetarë individë
Kufizime nga jashtë sistemit politik	Vendimmarrje e paanshme Bashkërendim kompleks Promovimi i konkurrueshmërisë dhe kushteve në sfond Bashkëpunimi suprakombëtar	Vendimmarrje e paanshme Kontroll i tregut Promovimi i konkurrueshmërisë dhe kushteve në sfond Bashkëpunimi suprakombëtar

Tabela 2 identifikon bazat më specifike, mbi të cilat mbështetet legjitimiteti funksional dhe përmbajtësor i institucioneve roje dhe të qeverisjes. Ajo i organizon ato sipas llojit të arsyeve (kërkesave dhe

standardeve), që qëndrojnë në themel të funksioneve të tyre, dhe sipas llojit të kufizimit (nga brenda apo nga jashtë), që ato imponojnë mbi politikën demokratike.

Kjo tabelë tregon që rezultatet dhe legjitimiteti funksional kërkojnë institucione, që funksionojnë në vend të qytetarëve dhe jo si përfaqësuese të qytetarëve. Por kjo duket se sugjeron që demokracitë moderne mund të përballen me një ujdi mes institucioneve, që promovojnë legjitimitetin demokratik, dhe institucioneve, që promovojnë rezultatet dhe legjitimitetin funksional. Si rezultat i kësaj, balanca e pushtetit tani anon në mënyrë vendimtare kah ana e institucioneve jo-demokratike (dhe potencialisht) oligarkike, duke gërryer kështu ndjesinë e qytetarëve se mund të ndikojnë vendimmarrjen kolektive.

b. Risjellja e demokracisë

Ekziston edhe një mënyrë tjetër për t'i parë institucionet roje dhe të qeverisjes jo thjesht nga këndvështrimi i arsyeve të tyre themelore, por nga perspektiva më specifike e llojit të funksioneve, që ato kryejnë në lidhje me sistemin politik dhe interesat dhe mirëqenien e qytetarëve. Kjo është një perspektivë më premtuese, nga e cila do të trajtojmë pyetjen tonë të dytë, pra, nëse është e mundur të pajtojmë mekanizmat e rojes dhe qeverisjes me legjitimitetin demokratik duke reformuar praktikat e demokracive liberale “të vërteta ekzistuese”. Tabela 3 më poshtë merret me atë, çka këto institucione *bëjnë* në lidhje me vendimmarrjen publike.

Tabela 3 argumenton që prirja drejt burokratizimit dhe racionalizimit të politikës, e identifikuar tashmë nga Maks Ueber (Max Weber) në fillim të shekullit të XX-të, nuk mishërohet më vetëm në ministrinë dhe agjencitë tradicionale të administratës publike, por mund të gjenden gjithnjë e më shumë në numrin në rritje të institucioneve roje dhe përhapjen e rrjeteve të qeverisjes. Ky kalim nga politika në administrim (nga përqasja e konfliktit dhe kompromisit tek përqasja problemzgjdhëse dhe e zbatimit të politikave) theksohet nga nevoja për të shmangur mbingarkimin e sistemit politik me detyra legjislative dhe rregulluese, që janë bërë tepër të gjera në shoqëritë moderne komplekse. Kalimi pasqyron gjithashtu edhe qëndrimin “për t'i bërë bisht fajit” të politikanëve, të cilët kanë prirjen t'ua delegojnë funksionet politikëbërëse institucioneve jo-demokratike në ato fusha, ku suksesi i politikave është i vështirë për t'u përcaktuar dhe rezultatet e politikave nuk mund të përkthehen lehtësisht në asete zgjedhore.

Tabela 3 – Tipet e institucioneve jo-demokratike vendimmarrëse

Institucionet brenda sistemit politik	Institucione jashtë sistemit politik
Institucione për zbatimin e politikave publike	Institucione rregulluese
Institucione, që funksionojnë si kontrole mbi sistemin politik dhe administrativ	Institucione vetë-rregulluese
Institucione gjysmë-autonome, të cilat funksionojnë në sektorë me interes të madh publik	Rrjete të vendimmarrjes

Por nëse as qytetarët e as përfaqësuesit e tyre nuk kanë kontroll mbi këto institucione të reja, pyetja është se si të sigurohemi që “rojet” nuk i kapërcejnë detyrat e tyre duke shfrytëzuar pozitat e tyre të privilegjuara në avantazh të tyre. Kush, në fund të fundit, i ruan rojet? *Quis custodiet ipsos custodes?* Tabela 3 nënkupton që nuk ka asnjë zgjidhje “të vetme më të mirë” apo “gjithëpërfshirëse”, përderisa insitucione të ndryshme roje dhe rrjete qeverisjeje kryejnë funksione të ndryshme dhe, për rrjedhojë, kërkojnë strategji të ndryshme, që synojnë të pajtojnë legjitimitetin demokratik dhe funksional.

Tabela 4 më poshtë sugjeron dy strategji të përgjithshme, që mund të përdorëshin për ta trajtuar këtë problem. Njëra është më e drejtpërdrejtë dhe synon të riprezantojë forma të kontrollit dhe përgjegjshmërisë demokratike; tjetra është më e tërthortë dhe funksionon nëpërmjet kontrolleve dhe balancave.

Tabela 4 – Strategji për të risjellë demokracinë

	Strategji të drejtpërdrejta	Strategji të tërthorta
Bazuar tek sistemi politik	Nënshtrimi i institucioneve roje përpara kontrollit të drejtpërdrejtë të organeve të zgjedhura në mënyrë demokratike	Promovimi i një sistemi kontrollesh <i>horizontale</i> bazuar mbi vigjilencën e ndërsjellë mes institucioneve roje dhe demokratike
Bazuar tek qytetarët	Ngritja e mekanizmave, përveç kontrollit zgjedhor, të cilat garantojnë pjesëmarrjen dhe kontrollin popullor	Promovimi i institucioneve, që kryejnë një kontroll <i>vertikal</i> mbi institucionet politike duke krijuar mundësi për zërin e qytetarëve

Llogaridhënia ndër-nivelëshe

Eksperimentimi me format shumënivelëshe të qeverisjes po vjen në rritje në Europë – pjesërisht për shkak të transferimit të pushteteve tek qeveritë rajonale apo provinciale; pjesërisht për shkak të demonstrimit nga Bashkimi European që sovraniteti kombëtar mund të parcelizohet dhe të rigumbullohet për të mirën e të gjitha niveleve. Megjithëkëtë, idealet demokratike sfidohen nga këto eksperimente në nivelet e qeverisjes. Si mund të mbahen përgjegjës politikanët? Si është e mundur të pajtosh normën e një personi, një vote, me nën-njësi të përmasave të ndryshme, që kërkojnë zë të barabartë? Si mund të zgjidhet çështja se cilat vendime duhet të merren nga cilat *demos*, në cilin nivel gjeografik – dhe kush duhet të vendosë për konfliktet e pashmangshme, që lindin nga një sistem i tillë i ndërlikuar?

Qeverisja shumënivelëshe dhe decentralizimi sfidojnë normat demokratike të llogaridhënies së politikanëve dhe autoriteteve të tjera në nivele të ndryshme, sepse sisteme të tilla kanë prirjen të mjegullojnë hapësirat e shanseve për të bërë zgjedhje politike, shanse që i gëzon çdo nivel. Masat për të rifituar përgjegjshmërinë përfshijnë më shumë transparencë dhe kontestim politik në lidhje me vendimmarrësit, si në lidhje me pushtetet e tyre *de jure*, ashtu edhe me gamën e tyre *de facto* për të zgjedhur.

Vështrim i përgjithshëm analitik

a. Mbi federalizmin dhe sisteme të tjera shumënivelëshe të qeverisjes

“Qeverisja shumënivelëshe” është një term, që shpesh përdoret për të përshkruar shumësinë e formave vendimmarrëse brenda Bashkimit European. Termi shumënivelësh mund t’i referohet shpërndarjes “vertikale” të autoritetit politik nga shteti për lart tek një nivel supra-kombëtar – Bashkimi European – dhe kah poshtë tek nivelet nënkombëtare/rajonale; dhe/ose shpërndarjes “horizontale”, që ndodh kur në proces sillen aktorët joshitetërorë. Këto ngrejnë sfida të ndryshme normative në lidhje me çështje të tilla si përfaqësimi dhe përgjegjshmëria demokratike, shpesh sepse virtytet e aluduara të qeverisjes së shpërndarë përftohen në kurriz të transparencës, kompetencave të kufizuara dhe autoritetit të përgjithshëm.

Për qëllimet tona urdhrat politikë federale mund të karakterizohen nga një ndarje (pothuaj) kushtetuese e pushteteve mes organeve qendrore dhe nën-njësive, ku secili nivel gëzon autoritet përfundimtar në lidhje me disa funksione dhe ku kërkohet që ndryshimi në këtë shpërndarje të autoritetit të bëhet me konsensus. Në kundërshtim me këtë, në sisteme të decentralizuara autoritetet qendrore mund të ruajnë, modifikojnë, apo braktisin autoritetet e niveleve më të ulëta sipas dëshirës së tyre. Në sistemet konfederale nën-njësitë në mënyrë tipike mund të vënë veton ndaj vendimeve dhe të largohen nga konfederata. Duke filluar me Bashkësinë Europiane të Qymyrit dhe Çelikut, institucionet e Bashkimit Europian kanë pasur si elemente federale ashtu edhe elemente konfederale.

Të jemi të sigurtë se BE-ja nuk mund të bëhet kurrë një federatë e plotë me një ndarje të gjithanshme të pushteteve, por një efekt i projekt-Traktatit të Kushtetutës së BE-së është se, nëse ratifikohet, do t'i shtonte më shumë elemente federale “përzierjes,” meqenëse shtetet anëtare do të kenë firmosur heqjen e së drejtës së tyre për të vënë veton mbi vendime në më shumë fusha të politikave.

b. Hierarkia e pushteteve

Një prej çështjeve më bezdisshme brenda çfarëdo federate apo gjysmë-federate ka të bëjë me dhënien formale (shpesh kushtetuese) dhe përdorimin e kompetencave nëpër të gjitha nivelet e shumëfishta të sistemit politik. Parimi i hierarkisë së pushteteve (*subsidiarity*) rreket ta zgjidhë këtë çështje duke e vendosur barrën e argumentimit mbi ata, që kërkojnë ta centralizojnë autoritetin. Sovraniteti mund të centralizohet në përgjigje ndaj humbjes së kapacitetit qeverisës së njësive më të vogla, por autoritetet e nivelit më të lartë në nivel kombëtar dhe suprakombëtare mund të veprojnë në mënyrë legjitime vetëm kur kontribuojnë për të kënaqur objektivat e qytetarëve më mirë se nën-njësitë. Aplikimi i këtij parimi ka patur një numër interpretimesh të ndryshme dhe konkurruese, të cilat variojnë nga mendimi modern katolik, një traditë e lashtë e asociuar me Althusiusin, doktrinat e “shumicave paralele” të lidhura me mosmarrëveshjen mes Veriut dhe Jugut në Shtetet e Bashkuara, tek burime të tilla bashkëkohore si federalizmi fiskal dhe kontraktualizmi liberal. Këto interpretime ndryshojnë në lidhje me çështje të tilla themelore si objektivat e rendit politik, vënia e kompetencave tek nën-njësitë me përmasa dhe kapacitete të ndryshme, mbi atë nëse këto njësi

duhen përkufizuar nga pikëpamja territoriale apo funksionale dhe çfarë lloj mbrojtjeje dhe ndër-lidhje midis niveleve të ndryshme të qeverisjes është më i efektshëm karshi rreziqeve të ndryshme. Për shembull, a është tirania e autoriteteve qendrore mbi një nën-njësi më e keqe se sa a jo e autoriteteve vendore mbi një pakicë vendore? Në ç'pikë e kapërcen kryerja më e mirë e një detyre funksionale kërcënimin ndaj identitetit territorial dhe autonomisë? Kush duhet të jetë gjyqtari përfundimtar, kur lindin konflikte mbi zbatimin e standardeve – sunduesit e nën-njësave apo ata në nivel qendror? Më e rëndësishme për qëllimet tona është pyetja se kush duhet të mbajë përgjegjësi (dhe si), sidomos kur shumë vendime mund të kenë të bëjnë më shumë me kompetenca të përbashkëta sesa me një ndarje të tyre.

Në fund të fundit, një pjesë e mirë e efektit të parimit të hierarkisë së pushteteve qëndron mbi interesin tonë të përbashkët tek liria, pra, mbi idealin, që askush nuk duhet t'i nënshtrohet vullnetit arbitrar të të tjerëve. Dhënia dhe mbrojtja e të drejtës së vetos të gjitha nën-njësave do të ruante lirinë duke u siguruar që përfitimet e përbashkëta nuk vijnë duke paguar çmimin e despotizmit, por njëkohësisht ato do ta linin të gjithë sistemin politik në mëshirën e një nën-njësie të vetme kokëforte. Të tjerë argumentojnë që decentralizimi tek grupet më të vogla, që ndajnë me njëri-tjetrin parapëlqime politikash, vlera personale dhe/ose rrethana materiale e bën vendimmarrjen më eficiente, por pikërisht për shkak të një ndarjeje të tillë, këto njësi mund të mos kenë vëllimin apo shumëllojshmërinë e duhur të burimeve për t'u marrë me problemin në fjalë. Transferimi i pushteteve mund të parandalojë gjithashtu edhe që proceset vendimmarrëse të mos jenë të mbingarkuara; por mund edhe ta bëjë atë proces më të ngushtë dhe oligarkik. Dhe për të mira publike të caktuara me shumë "internalitete pozitive" (njohur edhe si "sinergji") mund të ketë nëngrupe qytetarësh, që duhen lejuar të formojnë "klube" për ofrimin e tyre, me kusht që të mos përjashtojnë pakicat nga të mirat dhe të mos ua përcjellin kostot jo-anëtarëve.

c. Mbi përgjegjshmërinë në sistemet shumënivelëshe të qeverisjes

Shpesh është e vështirë të përcaktohet se kush e mban në fund të fundit përgjegjësinë për një vendim të caktuar politik, kur në marrjen dhe zbatimin e atij vendimi përfshihet më shumë se një nivel dhe kur çdo nivel autoriteti mund ta përcjellë fajin mbi tjetrin. Duke pasur parasysh një strukturë të tillë komplekse, asnjë sistem formal "diplomacie

shumënivelëshe” nuk mund të jetë i aftë të kënaqë kërkesat demokratike të “përgjegjshmërisë për akte në sferën publike” dhe të vërë në veprim sanksionet e nevojshme ndaj atyre, që operojnë në hapësirat midis niveleve të ndryshme. Pavarësisht nga kjo, nga perspektiva normative është e mundur të specifikohen standardet e përgjithshme për vlerësimin e një kompleksiteti të tillë.

Transparenca kundrejt mjegullnajës. Me ndihmën e medias publike qytetarët dhe autoritetet duhet të jenë në gjendje të vendosin nëse institucionet dhe vendimet e tyre përputhen pak a shumë përgjithësisht me çfarëdo kërkesash normative, që janë të përshtatshme për atë rend politik kompleks. Një shkak më shumë për mjegullnajën në BE është që shumë prej proceseve deri tani kanë ecur përpara pa siguruar akses publikut në negociatat e qeverive në Këshillin e Ministrave. Gjithashtu, kalimi nga unanimiteti në votimin me shumicë (të kualifikuar)⁵ e kufizon përgjegjshmërinë edhe më shumë, përderisa kjo u jep mundësi politikanëve të thonë që nuk ia dolën të votonin kundër vendimeve jopopullore. Pretendimet e tyre se “më detyroi Brukseli ta bëja” nuk mund të kontrollohen dhe aq lehtë.

Siguria kundrejt pasigurisë. Unanimiteti u ofron mbrojtje qytetarëve të çdo shteti anëtar duke siguruar që nuk do të detyroheshin me forcë që të merrnin pjesë në rregullime, që bien në kundërshtim me interesat e tyre, dhe u lejon atyre një nivel mbrojtjeje kundër marrëveshjeve të njëanshme. Megjithatë, ky rregull për vendimmarrjen rrit gjithashtu pasigurinë dhe çënueshmërinë e qytetarëve, meqenëse çdo nën-njësi mund të bllokojë vendime të përbashkëta. Votimi me shumicë (të kualifikuar), nga ana tjetër, rrit nevojën për besim dhe besueshmëri mes individëve dhe midis përfaqësuesve të tyre, duke kërkuar nga këta të fundit që herapashere të përshtaten apo të sakrifikojnë interesat e tyre dhe ato të votuesve të tyre për hir të europianëve të tjerë. Në këtë rast, shumicës i duhet besuar që të marrë parasysh vështirësitë e pakicave dhe të respektojë vendimet e përbashkëta kur e gjejnë veten në pakicë.

Autonomia kundrejt barazisë. Ekzistojnë tensione midis respektimit të autonomisë së nën-njësive dhe sigurimit të barazisë së përafërt të kushteve

⁵ Termi në anglisht për “votim me shumicë të kualifikuar” është “qualified majority voting”.

të jetesës në nën-njësitë – çka konsiderohet shpesh si një kusht dhe/ose objektiv i politikës demokratike. Për rrjedhojë, një çështje qendrore është se për çfarë game produktesh dhe politikash duhet të jetë përgjegjëse popullsia e nën-njesisë, d.m.th. që ata të bartin barrën e plotë ekonomike të zgjedhjeve të tyre kolektive. BE-ja supozohet të “promovojë...kohezionin ekonomik dhe shoqëror si dhe solidaritetin midis shteteve anëtare” – ndërkohë që respekton autonominë e shteteve anëtare. Por barazitizmi dhe solidariteti mund të kërkojnë centralizimin e politikave monetare, shoqërore dhe fiskale – sipas parimit të hierarkisë së pushteteve – duke i lënë pak autoritet nën-njesisë.

“Një person, një votë” kundër “një nën-njësi, një votë”? Përpyekjet për të “demokratizuar” federatat me nën-njësi me përmasa të pabarabarta mund të përplasen me idealet demokratike: Duhet të mbizotërojë “një person, një votë” apo “një nën-njësi, një votë”? Domethënë, a kërkojnë mazhoritarianizëm normat demokratike apo mund të justifikohet që disa nën-njësi të vogla të jenë të mbi-përfaqësuar, për shembull, për të pakësuar rrezikun që interesat e qytetarëve të tyre të hidhen poshtë në mënyrë të rregullt? Një mbi-përfaqësim i tillë shpesh ndodh në federata dhe mund të mbrohet edhe në institucionet e BE-së, ku shtetet me popullsi më të vogla janë të mbi-përfaqësuar apo pesha e votimit të tyre është në shpërpjestim më e lartë në krahasim me shtetet me popullsi më të mëdha. Nuk është e qartë nëse vendimmarrja mazhoritariane është e përshtatshme, kur segmente të popullsisë rrezikojnë të mbeten në pakicë të përhershme, sidomos nëse shumicës nuk mund t’i zihet besë se do të ndryshojë pikëpamjet e veta duke mbajtur parasysh ndikimin mbi pakicat. “Një person, një votë” mund të mos jetë e përshtatshme në rrethana të tilla.

Mekanizma për konsultim të drejtpërdrejtë me qytetarët

Ndërkohë që forma të ndryshme të demokracisë përfaqësuese përbëjnë themelin bazë për vendimmarrjen në të gjitha demokracitë europiane – të reja apo të vjetra qofshin – disa shtete kanë futur mekanizma për përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në repertorin e tyre të institucioneve demokratike. Në pothuajse çdo vend evropian dhe pothuajse në çdo nivel të qeverisë qytetarët mund të paraqesin peticione, që as nuk detyrojnë parlamentet dhe as rezultojnë në vota popullore. Peticione të tilla janë manifestime nga poshtë lart, sipërfaqësore dhe jo-

kërcënuese, të pakënaqësisë dhe konfliktit shoqëror me rrënjë më të thella. Ato zakonisht kanalizohen nëpërmjet organizatave të ngritura politike (parti, shoqata, apo lëvizje), por me raste lindin nga njësi *ad hoc* dhe joformale të aksionit kolektiv. Synimet e tyre parësore janë të tërheqin vëmendjen e sunduesve dhe të provokojnë debat publik mes qytetarëve. Meqenëse suksesi i peticioneve të tilla mbetet tërësisht nën gjykimin e atyre, që janë në pushtet, ato përfaqësojnë thjesht një kanal komunikimi për lart, së bashku me të tjera kanale, që ofrohen nga demokracitë liberale moderne siç janë sondazhet e opinionit publik dhe interpelancat publike. Supozohet që disa peticione janë më të efektshme se të tjerat, por asnjë prej tyre nuk mund të përshkruhet si një mjet i rregullt dhe i efektshëm për t'u kërkuar llogari sunduesve.

Në versionin standard të teorisë demokratike liberale mjeti *par excellence* për të siguruar llogaridhënien supozohet të jenë zgjedhjet “e lira dhe të ndershme,” “të rregullta dhe konkurruese.” Nëse zgjedhjet periodike janë të mjaftueshme apo jo, kjo ka qenë prej kohësh një çështje mosmarrëveshjeje – të paktën, qysh nga koha kur Zhan Zhak Ruso vërejti me cinizëm se anglezët ishin të lirë vetëm një herë në disa vjet, ditën kur shkonin për të votuar. Pavarësisht nga argumenti në teori, në praktikë, shumica e demokracive “të vërteta ekzistuese” në Europë kanë ndërtuar dhe vënë në zbatim mjete të tjera për të shtrënguar sjelljen (dhe, me raste, mandatin) e sunduesve të tyre. Sot, ajo, që ka arritur të quhet “demokraci e drejtpërdrejtë”, është plotësuese e “demokracisë jo të drejtpërdrejtë apo përfaqësuese” praktikisht në çdo shtet anëtar të Këshillit të Europës.

Institucionet demokracisë direkte marrin dy forma themelore si referendum dhe nisëm popullor. Të dyja janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Referendumi ngërthen një proces, nëpërmjet të cilit propozimet nga autoritetet politike mund t'i nënshtrohen një votimi popullor. Nisma popullore është një proces, nëpërmjet të cilit një numër qytetarësh mund të formulojnë një propozim dhe të detyrojnë autoritetet politike që t'ia paraqesin atë një votimi popullor. Në rastin e dytë ka një formë të posaçme nisme, thirrje për largim nga posti, që e lejon të aplikohet jo mbi një propozim specifik politikash, por mbi mandatin e një zyrtari specifik të zgjedhur. Në këtë mënyrë, dallimin midis dy formave bazë e bëjmë nisur nga origjinuesi i tyre dhe jo nga përmbajtja apo qëllimi.

Të mirat dhe të këqijat si të referendumit ashtu edhe të nismës popullore janë debatuar për një kohë shumë të gjatë prej filozofëve politikë dhe teoricienëve normativë demokratikë. Argumentet në favor

dhe kundër janë shtuar dhe zbehur gjatë shekujve të kaluar. Nocioni i thirrjes për largimit nga posti ka qenë veçanërisht i nxehtë – ndoshta meqë është pa diskutim më i forti nga pikëpamja e lidhjes së tij me përgjegjshmërinë. Siç mund të shihet në rastin e largimit nga posti në vitin 2003 të guvernatorit të Kalifornisë, ai mund të vihet në përdorim për të larguar një zyrtar të zgjedhur në mënyrë plotësisht të ligjshme, i cili ka gëzuar mbështetjen e shumicës në parlamentin e zgjedhur në mënyrë po aq të ligjshme. Pavarësisht se kush po e fiton debatin abstrakt mbi demokracinë e drejtpërdrejtë, nga pikëpamja konkrete është bërë gjithmonë e më shumë një realitet në Europë gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit.

Sfida kryesore, që demokracia e drejtpërdrejtë paraqet kundrejt demokracisë përfaqësuese, është që ajo sjell një veto potenciale më shumë ndaj të gjitha kontrolleve dhe balancave, që mund të jenë ndërtuar tashmë brenda sistemeve të tërthorta të përfaqësimit. Vendimet e marra nga përfaqësues të zgjedhur në mënyrë legjitime mund të ndryshohen apo thjesht të braktisen. Për më tepër, parlamenti humb (apo e sheh të pakësuar) sovranitetin e tij tradicional brenda shtetit demokratik, meqenëse një vendim i favorshëm mbi një nismë popullore mund të prodhojë një vendim përgjithësisht detyrues apo të detyrojë parlamentin ta prodhojë një vendim të tillë. Në qoftë se – për të përdorur terminologjinë e Gordon Smithit – “rezultatet anti-hegjemonte” të votave popullore do të bëheshin rregull, atëhere demokracia do të rrezikonte të arrinte pikën e vdekjes. Nga një perspektivë normative kjo do të ishte sigurisht nën pikën optimale të Paretos. Cilido mund të përballej me rrezikun për të humbur ose, të paktën, do të kishte më shumë gjasa që të miratoheshin shumë pak vendime në të mirë të cilitdo.

Vështirë se situata e kundërt është më tërheqëse apo më e mundshme. Nëse do të ekzistonte rregulli që zgjedhjet e bëra nga përfaqësuesit dhe ato të bëra nga qytetarët të ishin identike ose, të paktën, sistematikisht harmonike, si referendumi ashtu edhe nisma do të ishin të tepërta. Në një botë të tillë ideale, në të cilën të gjitha parimet e demokracisë do të respektoheshin në mënyrë të përkryer prej të gjithë aktorëve dhe ku mendimi politik do të rezultonte në informacion të përkryer dhe kompetenca të përbashkëta politike mes të gjithë qytetarëve, harmonia në politika (dhe konsensusi në opinion) do të ishte një rezultat i natyrshëm dhe, për rrjedhojë, nuk do të kishte shumë logjikë të kryheshin referendume popullore mbi çështje të ndryshme, kur sunduesit dhe

qytetarët arrijnë në mënyrë sistematike dhe të parashikueshme në të njëjtat përfundime.

Në çdo rast, një demokraci e tillë e përsosur mbetet një fantazi. Edhe gjetja e një rastësie të qëndrueshme midis një shumice të përfaqësuesve dhe një shumice të qytetarëve mund të jetë e vështirë. Në të vërtetë, harmonia sistematike, kur manifestohet në mënyrë formale, ka më pak gjasa për të qenë e shëndetshme për demokracinë dhe ka më shumë gjasa të nënkuptojë kontroll autokratik prej elitës sunduese mbi subjektet “e veta” të bindura dhe të trembura. Për shembull, referendumi i Çausheksut i vitit 1986 në Rumani prodhoi një total të përkryer prej 100% të votave pro me një pjesëmarrje në zgjedhje prej 99.99% - dhe ky sundues triumfues plebishitar u përmbys për kënaqësinë e përgjithshme të publikut rumun vetëm tri vjet më vonë.

Pavarësisht nga një ideologji, që thekson harmoninë midis zgjedhjeve të sunduesit dhe parapëlqimeve të qytetarëve dhe që supozon se agjentët e zgjedhur janë pasqyrime të qarta të parimeve të votimit, praktika e të gjitha demokracive “të vërteta ekistuese” sugjeron se është diçka normale (ose, sigurisht mjaft e shpeshtë) që dy blloqet e aktorëve të mos jenë të sinkronizuar. Pjesërisht ky është produkt i dallimeve në horizontin kohor ose në përkufizimin e zonave zgjedhore; megjithatë, në pjesën më të madhe, është rezultat i lëshimeve reciproke, kompromiseve, “shkëmbimeve të favoreve” dhe “paketave të ujdivë” të pashmangshme, të cilat janë pjesë integrale e mënyrës se si funksionon demokracia përfaqësuese. Për më tepër, ndërkohë që politikanët bëhen më profesionistë dhe mbeten në postet e tyre më gjatë, ata janë të prirur të mësojnë më mirë se si t'i bëjnë këto ujdi (dhe të mbajnë mend më qartë ato të së kaluarës). Ka gjithashtu gjasa që të bëhen më të aftë për t'u shpjeguar zgjedhësve të zonave të tyre dhe votuesve arsyet, që qëndrojnë mbas mospërputhjeve të tilla.

Duket e besueshme të supozohet që mes profesionalizimit të politikanëve dhe kompleksitetit të zgjedhjeve kolektive në demokracitë shumë-nivelëshe bashkëkohore mospërputhjet janë rritur dhe që ndjenja, që kjo gjeneron mes qytetarëve, është një prej shumë elementeve, që kontribuojnë për pakënaqësitë e shumëpërhapura kundrejt sunduesve dhe mosbesimit tek përfaqësuesit. Futja e formave të demokracisë së drejtpërdrejtë si plotësim i demokracisë përfaqësuese konsiderohet një mënyrë – ndoshta, mënyra më e mirë – për ta mbushur atë hendek. Një prej virtyteve të saj më të padukshme është që si referendumi, ashtu edhe nisma mund të kenë ndikim të konsiderueshëm edhe kur nuk vihen

formalisht në përdorim. Thjesht pritshmëria që cilado prej tyre mund të iniciohet – nga qeveria, opozita, apo një numër i mjaftueshëm qytetarësh – mund të jetë e mjaftueshme për të shkurajuar sunduesit që të mos miratojnë masa, që ata e dinë që janë në mospërputhje me parapëlqimet e një shumice deri tani pasive.

Në shumë sisteme politike anembanë botës, *iniciimi* i procesit të referendumit kontrollohet rreptë nga kreu i shtetit apo i qeverisë dhe përdoret (dhe keqpërdoret) për t'i thirrur votuesit në votime, kur as mund të ketë diskutim se mund të votojnë “Jo” – për shkak të frikës ose të manipulimit. Në shumë shtete pas-koloniale njëpartiake afrikane referendumi është shfrytëzuar si mjet nga sunduesit për të siguruar legjitimim demokratik për vendimet e tyre – nëse dhe kur duan ata. Ky instrument “plebishitar” është vënë në përdorim edhe nga qeveri në Europën Perëndimore në një të kaluar jo dhe aq të largët. Një version i tillë *ad hoc* (dhe, me raste, *ad hominem*) i demokracisë së drejtpërdrejtë është në kontrast të mprehtë me homologun e tij më të formalizuar dhe më të parashikueshëm tjetërkund. Në vende të tilla europiane si Zvicra, Lihtenshteini, Italia, Irlanda, Danimarka, në demokracitë pas-komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore dhe në shumicën e ish-republikave të Bashkimit Sovjetik, qeveria në pushtet nuk mund ta kontrollojë iniciimin e një referendumi. Për shembull, nëse kushtetutat e tyre amendohen apo nëse vendosin të bashkohen me Bashkimin Europian apo me organizata të tjera madhore rajonale apo globale, duhet të kryhet një referendum dhe rregullat për mbajtjen e tij përcaktohen shumë kohë përpara. Nismat kërkojnë një numër dhe shpërndarje të paracaktuar të qytetarëve, por kjo nuk mund të manipulohet *ex ante* apo të zhvlerësohet *ex post* prej atyre, që janë në pushtet.

Edhe një vëzhgues i shkujdesur i politikës europiane të kohëve të fundit ka gjasë të jetë i njohur me një numër referendumesh kombëtare, që kanë pasur një ndikim madhor mbi çështje të tilla si aborti, energjia atomike, bashkimi me BE-në e kështu me radhë. Ajo, që shpesh neglizhohet, është roli politik kyç, që kanë luajtur referendumet (dhe më rrallë nismat) në nivelet vendore dhe rajonale në demokraci të stabilizuara mirë. Modeli normal në Europën Perëndimore ka qenë që mjetet demokratike të drejtpërdrejta të lindin dhe të eksperimentohen në këto nivele dhe vetëm më pas të kapërcejnë në nivele kombëtare. Megjithatë, në Europën Qendrore dhe Lindore dhe në republikat e ish-Bashkimit Sovjetik, ndryshimi i menjëhershëm i regjimit nga autokracia komuniste në demokracinë liberale ka sjellë një ekspansion të

menjëhershëm të të drejtave popullore në nivelin kombëtar përpara kryerjes së ndonjë eksperimentimi paraprak në qeveritë e nivelit vendor apo rajonal.

Referendumet popullore në Europë: vlerësimi i të dhënave


Midis viteve 1960 dhe 2003, në të gjitha shtetet anëtare të tanishme të Këshillit të Europës, qytetarëve në nivel kombëtar iu kërkuar të merrnin 628 vendime të drejtpërdrejta demokratike. Këto të dhëna tregojnë që gjatë katër dhjetëvjeçarëve të fundit, referendumet dhe nismat kombëtare u zhvilluan në tridhjetenëntë nga dyzetepesë shtetet anëtare. Nëse do të përfshinin të dhënat nga nivelet vendore dhe rajonale, atëherë Luksemburgu do të ishte i vetmi vend evropian, që nuk është konsultuar kurrë me popullin në mënyrë të drejtpërdrejtë me anë të këtyre mjeteve. Megjithatë, edhe Luksemburgu ka mbajtur tri referendume kombëtare përpara vitit 1960 dhe qeveria e tij ka shpallur paradokohësh që do të mbahet një referendum mbi projekt-Traktatin e Kushtetutës së BE-së. Të gjitha demokracitë europiane janë ekspozuar, të paktën në mënyrë sporadike, përballë votave popullore – edhe nëse shpeshësia, forma dhe ndikimi i këtyre konsultimeve ka pasur variacion të madh.

Më shumë se gjysma e të gjitha referendumeve dhe nismave në Europë qysh nga viti 1960 janë mbajtur në Zvicër. Ky vend është kampion i botës *par excellence* për demokracinë e drejtpërdrejtë dhe, për ta siguruar këtë reputacion shumë të merituar, ai ka ndjekur një trajektore shumë të dallueshme politike. Për këto arsye kemi vendosur ta lëmë jashtë pjesës më të madhe të analizave të mëposhtme këtë vend, që bën përjashtim.

Përpos Zvicrës, Lihtenshteinit dhe Italisë, vetëm pesë vende europiane kanë zhvilluar dhjetë apo më shumë referendume gjatë periudhës së shqyrtuar. Duke lënë jashtë Zvicrën, mesatarja për vend ka qenë shtatë. Vetëm një e katërta e të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Europës e kanë kapërcyer këtë mesatare. Me fjalë të tjera, shumica e shteteve anëtare kanë zhvilluar pak referendume në nivel kombëtar.

Figura 3 më poshtë paraqet zhvillimin e shpeshësisë së konsultimeve popullore qysh nga viti 1960, duke na lejuar të vëzhgojmë dinamikën e tyre ndërkohore brenda Europës. Pika e të dhënave 2000-09 është një projekcion linear bazuar mbi të dhënat për periudhën 2000-03.

Figura 3 – Prirja e gjithanshme e votimeve të drejtpërdrejta demokratike në të gjitha vendet e Këshillit të Europës dhe duke përjashtuar Zvicrën




Burimet: Qendra e Kërkimit dhe Dokumentimit mbi Demokracinë e Drejtpërdrejtë (c2d) në Universitetin e Gjenevës (<http://c2d.unige.ch>) dhe “Suchmaschine für direkte Demokratie” zhvilluar nga Beat Müller në Institutin Federal Zviceran të Teknologjisë në Zyrih.

Dy linjat në Figurën 3 tregojnë modele të ngjashme. Po të përfshihet Zvicra, thjesht dyfishohen numrat pa ndikuar në mënyrë domethënëse formën S të vijës bazë. Të dyja tregojnë një rritje dramatike në konsultimet e drejtpërdrejta me qytetarët gjatë viteve 1990. Shpeshësia e përgjithshme u trefishua gjatë kësaj periudhe. Presupozohet që kjo ngërthen një kryqëzim kritik në politikën europiane, gjatë së cilës referendumet dhe nismat u bënë veçanërisht tërheqëse si një mekanizëm për zgjidhje konfliktesh dhe legjitimimi. Megjithatë, qysh nga ajo kohë, shpeshësia është stabilizuar – dhe projektimet tona sugjerojnë që për dhjetëvjeçarin e parë të mijëvjeçarit të tretë numri i tyre ka gjasa të mos rritet. Një hipotezë është që Europa mund të ketë arritur “pikën e ngopjes” në lidhje me vendimmarrjen e drejtpërdrejtë demokratike, në të cilën është vendosur një nivel drejtpeshimi midis saj dhe demokracisë përfaqësuese.

Një provë potenciale e kësaj ka të bëjë me modelin e zhvillimit midis demokracive të vjetra dhe të reja europiane. Në Figurën 7 më sipër mund të vëzhgojmë një konvergencë të qartë në shpeshësinë e zhvillimit të referendumëve në Europën Perëndimore dhe Lindore qysh nga fundi i

Luftës së Ftohtë. Për Perëndimin, rritja masive gjatë viteve 1990 mund të shpjegohet në radhë të parë nga një numër referendumesh mbi integrimin në BE. Në Lindje rritjen e shpjegojnë konsultimet popullore në lidhje me sovranitetin kombëtar dhe kushtetutat. Sipas projekteve tona dhjetëvjeçare presim të kemi po aq shumë referendume gjatë dhjetëvjeçarit të parë të mijëvjeçarit të tretë në të dyja rajonet e Europës. Një arsye për këtë vazhdon të mbetet integrimi europian. Për sa kohë që shtetet anëtare të BE-së vazhdojnë të bien në një mendje mbi traktate të reja, ratifikimi i tyre do të promovojë pashmangshmërisht përvojën e referendumeve. Për shembull, prezantimi i monedhës Euro çoi në votime popullore në

Figura 4 – Rritja e gjithanshme e votimeve të drejtpërdrejta demokratike në Europën Perëndimore dhe Lindore e Qendrore (të gjitha vendet e Këshillit të Europës duke lënë jashtë Zvicrën)



Burimet: Qendra e Kërkimit dhe Dokumentimit mbi Demokracinë e Drejtpërdrejtë (c2d) në Universitetin e Gjenevës (<http://c2d.unige.ch>) dhe “Suchmaschine für direkte Demokratie” (<http://www.ife.ee.ethz.ch/~zosh/dd/>) zhvilluar nga Beat Müller në Institutin Federal Zvicëran të Teknologjisë në Zyrh.

Danimarkë dhe Suedi (dhe kjo gjë mund të ndodhë edhe në Mbretërinë e Bashkuar). Vetëm në vitin 2003 zgjerimi nga pesëmbëdhjetë në njëzetepesë anëtarë detyroi nëntë nga dhjetë të ardhurit rishtas që të

mbanin referendume. I vetmi përjashtim ishte Qiproja. Tani, që Këshilli i Ministrave ka rënë në një mendje mbi tekstin e një “traktati të kushtetutës” së re, pritet që një numër i panjohur, por gjithsesi i lartë, shtetesh anëtare do të duhet të lejojnë qytetarët e tyre të votojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për ratifikimin e tij.

Megjithatë integrimi europian me anë të traktateve nuk përbën të vetmin faktor, që promovon referendumet në Europë. Lihtenshteini, Italia dhe Irlanda (si dhe, qartësisht, Zvicra) vazhdojnë të kryejnë një numër të madh konsultimesh popullore mbi çështje, që nuk kanë lidhje me BE-në. Ato ndiqen ngushtë nga të ardhur të rinj si Sllovenia, Azerbajxhani dhe Ukraina. Arsyeja për këtë është më e gjerë. Për zgjedhjen e institucioneve të tyre pas ndryshimeve të regjimit në vitet 1989-90 një pjesë thelbësore e demokracive të reja përfshinë dispozita për konsultime popullore në kushtetutat e tyre. Për shembull, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovenia, Republika Sllovaqe dhe Ukraina, që të gjitha kanë shkuar përtej thirrjes së referendumeve nga qeveritë dhe kanë prezantuar mundësinë e konsultimeve të provokuara nga qytetarët, pra, nismat. Në Europën Perëndimore kjo formë ekziston vetëm në Zvicër, Lihtenshtein dhe San Marino. Qysh nga viti 1990 nismat popullore – duke përjashtuar rastin e Zvicrës – kanë përbërë vetëm 13% të të gjitha konsultimeve popullore të mbajtura në demokracitë “e vjetra”, ndërsa në të ato “të reja” të Europës Lindore dhe ish-Bashkimit Sovjetik përpjestimi rritet në mënyrë domethënëse deri në 24%. Kjo zbulon që këto vende jo vetëm kanë dispozitat e nevojshme formale për të zhvilluar nismat e tyre, por edhe që qytetarët e tyre kanë zbuluar shpejt si t’i përdorin ato. Përpjekje të tilla nga poshtë lart janë pothuajse dy herë më të shpeshta në këto vende në krahasim me demokracitë e vjetra. Kjo shënon në mënyrë të qartë një dallim me Europën Perëndimore, ku shumica e eksperimentimit me votimet e iniciuara nga qytetarët kanë ardhur thuhetse ekskluzivisht nga niveli vendor apo rajonal – nëse kanë ndodhur.

Së fundi, me qëllim që të matet ndikimi i demokracisë së drejtpërdrejtë, duhet të përpiqemi të vlerësojmë se sa të suksesshme kanë qenë konsultimet popullore. “Suksesi” mund të marrë forma të ndryshme. Pyetja e parë, që lind, ka të bëjë me *kush* është i suksesshëm. Sipas përkufizimit autorët e teksteve të referendumeve janë autoritetet politike (qoftë parlamente dhe/ose qeveri). Nëse votuesit e miratojnë referendumin, atëherë supozohet që këto autoritete kanë qenë të suksesshme dhe që propozimi i tyre për një politikë është legjitimuar në

mënyrë demokratike. E kundërta ndodh me rastin e nismave popullore, meqenëse sunduesit zakonisht janë kundër tyre dhe rekomandojnë që ato të hidhen poshtë. Pyetja e dytë përqendrohet mbi pasojat e një konsultimi popullor. Edhe referendimet e pranuar nga një shumicë e votuesve nuk është e thënë të merren parasysh nga qeveria, nëse janë mos-detyruese në natyrën e tyre (siç janë zakonisht). Referendimet e favorshme gjithashtu mund të zhvleftësohen, kur nuk arrijnë të sigurojnë një kuotë të mjaftueshme pjesëmarrjeje të qytetarëve me të drejtë votimi. Në të dyja këto raste efekti do të jetë thjesht vazhdimi i *status quo*-së dhe jo ndonjë ndryshim në një politikë.

Nga një paketë të dhënash mbi përvojat demokratike të drejtpërdrejta grumbulluar në Universitetin e Gjenezës është e mundshme të matet “efekti neto” i referendumeve dhe nismave, pra, nëse ato kanë çuar në ndryshime përkatëse politikash. Në lidhje me Europën Perëndimore ka patur një prirje drejt përqindjeve më të mëdha të pranimit. Për shembull, qysh nga viti 1990, pak a shumë tri në katër referendume të iniciuara nga qeveritë janë miratuar në mënyrë të suksesshme. Mund të vëzhgohet gjithashtu një përqindje relativisht e qëndrueshme (në mos paksa më e ulët) pranimit përsa u përket nismave të promovuara nga qytetarët. Pak a shumë, një në dy prej tyre ka qenë pranuar nga votuesit. Shumica e konsultimeve popullore – referendume dhe nisma – kanë qenë detyruese dhe, megjithëkëtë, përqindja e ndryshimeve në politika të shtyra nga referendimet ka pësuar rënie. Gjatë kohëve më të fundit, vetëm një në tri referendume ka çuar në një ndryshim të lidhur drejtpërdrejt në një politikë, pavarësisht nga një përqindje pranimit prej 74%. Kjo do të thotë që vetëm një në dy propozime të pranuar nga një shumicë votuesisht provokon një ndryshim politike. Një gjetje e tillë mjaft e papritur mund t’u atribuohet dy faktorëve: së pari, përqindja e referendumeve jo-detyruese ka pësuar një rritje të lehtë dhe, së dyti, rregullat e kuorumit (pjesëmarrjes) kanë qenë plotësuar gjithnjë e më pak, çka do të thotë që pjesëmarrja e qytetarëve në votim ka qenë e pamjaftueshme për ta bërë rezultatin të vlefshëm ligjrisht. Kjo është një prirje shumë shqetësuese, që mund të çojë në një cikël vicioz politik. Nëse konsultimet popullore zhvillohen dhe pranohen, por më pas refuzohen sepse nuk kanë qenë detyruese ose sepse nuk kanë arritur të siguronin kuorumin e nevojshëm, apatia e votuesve ka gjasa të rritet, kur mundësi të tilla të paraqiten në të ardhmen. Votimi në zgjedhje është tashmë një akt irracional për qytetarin individ deri në atë masë sa gjasat që vota e tij apo e saj të ndryshojë rezultatin të jenë

minimale. Pavarësisht nga kjo, shumë njerëzish dalin për të votuar dhe hedhin votën e tyre. Por nëse kësaj i shtojmë edhe gjasat që *rezultatet do të injorohen apo zhvlerësohen* nga sunduesit, atëhere përfundimi është praktikisht i paevitueshëm që qytetarët do të bëhen gjithnjë e më apatikë dhe nuk do ta vrasin mendjen për të votuar – së pari, në konsultimet popullore dhe, ndoshta, më pas edhe në zgjedhjet e rregullta.

Karakteri jo-detyrues i referendumeve të caktuara nuk duket se është çështja më problematike. Për shembull, kur në vitin 1994 një shumicë e votuesve norvegjezë refuzuan anëtarësimin në BE në një referendum konsultues (jo-detyrues), ishte e pakonceptueshme politikisht që qeveria norvegjeze thjesht ta injoronte këtë përfundim dhe të ecte përpara me bashkimin me BE-në. E njëjta logjikë politike kishte vlerë për referendumin konsultues të vitit 2003 në Suedi në lidhje me pranimin e Euros. Nga ky këndvështrim do të dukej se ka shumë pak për të fituar nga ndryshimi prej konsultimeve jo-detyruese në ato detyruese – përveç ndikimit të tyre potencial mbi numrin e atyre, që do të dilnin për të votuar. Gjasat janë që më shumë qytetarë do të votojnë nëse do të sigurohen që vendimi kolektiv, çfarëdo qoftë ai, do të zbatohet. Dhe kjo na sjell tek çështja kryesore, e cila ka të bëjë me imponimin e kuorumeve minimale për referendumet dhe nismat. Hera-herës përfundimi mund të vendoset nga një diferencë shumë e ngushtë. Për shembull, në një referendum më 18 prill 1999, 91.52% e votuesve italianë pranuan një propozim për të ndryshuar mënyrën e llogaritjes për caktimin e vendeve në parlament për t'i bërë ato që të respektonin më mirë parimin e përfaqësimit proporcional. Megjithatë, numri i atyre, që dolën për të votuar ishte vetëm 49.58%, duke mos arritur kuorumin prej 50% vetëm me 0.42% të qytetarëve me të drejtë votimi. Një gjë e tillë hodhi poshtë një përfundim, që miratohej në mënyrë masive nga qytetarët italianë, bazuar në një prag pak a shumë arbitrar.

Situata në Europën Lindore qysh nga viti 1990 ka qenë shumë e ndryshme. Këtu, një shumicë shumë e madhe e referendumeve dhe nismave popullore janë pranuar. Shifrat përpara rënies së Murit të Berlinit tregonin një pranim prej 100%. Megjithatë, nën regjimet komuniste, referendumet zor se zhvilloheshin në mënyrë demokratike dhe pajtimi mes sunduesve dhe qytetarëve ishte i gënjeshtërt – siç edhe e zbuloi bota pas viteve 1989-90. Sigurisht, nismat popullore nuk ekzistonin. Qysh nga koha e demokratizimit jo vetëm që përqindja e pranimi ka qenë më e lartë sesa në demokracitë “e vjetra” në Europën Perëndimore, por ato kanë rezultuar edhe në ndryshime më të besueshme dhe më të

menjëhershme në politikat publike. Gjatë viteve të kaluara në Europën Lindore dhe ish-Bashkimin Sovjetik raporti midis referendumeve të iniciuara nga sunduesit dhe miratimit të tyre nga qytetarët është afruar me shpejtësi drejt raportit të ruajtur nën komunizëm, pra, 100%. Dikush mund të shtrojë pyetjen, në qoftë se qeveritë fitojnë gjithmonë, nëse kjo mund të ndodhë sepse vetë procesi i demokracisë së drejtpërdrejtë është i anshëm në favor të atyre, që janë në pushtet? Të dhënat mbi fatin e nismave të qytetarëve sugjerojnë që në këto demokraci të reja nuk ndodh kështu. Këtu, kur përballen me variante, që në mënyrë tipike janë në kundërshtim me politikat ekzistuese, dhe kur nxiten nga sunduesit e tyre për të votuar “Jo,” qytetarët e çliruar së fundmi të Europës Lindore dhe Qendrore kanë votuar “Po” – pothuajse dy herë më shpesh se në Europën Perëndimore.

PJESA III

REKOMANDIME PËR REFORMA

Hyrje

Në kërkimin tonë mbi “aktorë dhe procese” në lidhje me “sfidat dhe shanset”, me të cilat përballen demokracitë europiane bashkëkohore, zbuluam që politikanët dhe qytetarët jo vetëm që ishin në dijeni të nevojave urgjente për reformim, por edhe po u përgjigjeshin në mënyrë krijuese këtyre nevojave. Në kundërshtim me përshtypjen mbizotëruese se demokracitë e mirëkonsoliduara të Perëndimit janë tepër sklerotike për të kryer ndonjë ndryshim thelbësor në rregullat e praktikat e tyre dhe se neo-demokracitë në Lindje janë të shqetësuara vetëm për të imituar pikërisht këto rregulla dhe praktika, gjetëm shumë e shumë shembuj novacioni dhe eksperimentimi. As nuk ka nevojë të thuhet që këto përpjekje kanë qenë shpesh të shpërndara dhe janë kryer vetëm para pak kohe, gjë që nuk jep mundësi për të vlerësuar kontributin e tyre të mundshëm. Shumë prej tyre lindnin nga nivelet vendore të qeverisë dhe nga fusha të specializuara të qeverisjes. Në shumicën e rasteve këto reforma synonin transparencë dhe pjesëmarrje më të madhe në vendimmarrje nga ana e qytetarëve dhe “të interesuarve.” Nuk është për t’u çuditur që problemet në rritje, që lidhen me financimin e partive dhe korrupsionin, çuan në përgjigje në nivelin kombëtar, megjithëse edhe organizatat joqeveritare, të tilla si Transparency International dhe organizatat ndërkombëtare, të tilla si Këshilli i Europës, gjithashtu kanë luajtur një rol të rëndësishëm për identifikimin e funksionimit të dobët dhe përcaktimin e standardeve. Në lidhje me çështjet më përfshirëse të globalizimit dhe migracionit ndërkombëtar përpjekjet për reformim përfshinin në radhë të parë organizata ndërkombëtare dhe marrëveshje ndërkombëtare, përfshi konventat kuadër të Këshillit të Europës mbi çështje të tilla si mbrojtja e pakicave kombëtare, pjesëmarrja e të huajve në jetën publike dhe rregullat, që kishin të bënin me marrjen e nënshtetësisë. Edhe pse nuk u themelua për këtë qëllim, i tërë “eksperimenti” në integrimin evropian mund të interpretohet sot si një përpjekje për t’iu përgjigjur në nivel rajonal sfidës së globalizimit. Duke pasur parasysh shumësinë e niveleve të grumbullimit dhe shumëllojshmërisë në rregullat dhe praktikat ekzistuese mes demokracive europiane, nuk duhet të jetë aspak çudi që

këto përgjigje nuk kanë qenë uniforme dhe shpesh kanë kaluar të pavëzhguara dhe të nënvlerësuara.

Tani, që kalojmë tek rekomandimet tona për reformim, duhet të pranojmë që shumë prej tyre u frymëzuan nga përpjekjet e shpërndara, që demokracitë europiane janë duke bërë tashmë për të përballuar sfidat dhe shanset e “kohërave interesante”, në të cilat jemi dënuar të jetojmë. Megjithatë, për fat të keq, shumë prej këtyre kanë ndodhur para aq pak kohësh, sa që nuk mund të jemi të sigurtë se do të jenë të suksesshme për të përmirësuar cilësinë e demokracisë. Për më tepër, duhet gjithashtu të pranojmë që ekzistojnë një numër fushash problematike, në të cilat janë bërë shumë pak prova. Për shembull, pothuajse kushdo deri tani pranon që qytetarët kanë gjithnjë e më pak gjasa për të votuar apo për të hyrë në parti politike, por askush nuk duket se po përpiqet seriozisht për të bërë diçka për këtë.

Kur Xhejms Medisoni (James Madison) po përpiqej të bindte bashkëqytetarët e tij amerikanë të ndërmerrnin rrezikun e reformimit të institucioneve të tyre politike në *Letrat Federaliste: Nr. 10*, ai shprehu një dilemë të famshme. Demokracia jo vetëm zgjidhte probleme; ajo edhe i krijonte problemet – ndër të cilat jo më pak e rëndësishme ishte prirja e saj për të krijuar “fraksione.” Jepu qytetarëve lirinë për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe për të vepruar në mënyrë kolektive dhe ata do të “bien në armiqësi të ndërsjella për dallimet më pa vlerë dhe më ekstravagante.” Përgjigja e tij ishte brilante: Nëse “shkaqet e fraksionit nuk mund të largohen [pa shkatërruar vetë demokracinë] ... atëherë shpëtimi duhet kërkuar vetëm në mjetin për të kontrolluar efektet e tij.”

Jemi rrekur ta marrim parasysht këshillën e Medisonit. Dhe kjo nuk është askund më e dukshme në botën bashkëkohore sesa në lidhje me efektin e masmedias. Gazetat, radioja dhe sidomos televizioni, në fakt e kanë transformuar demokracinë në një “spektakël publik.” Ajo, çka supozohet të jetë një proces solemn i reflektimit kolektiv të qytetarëve të virtytshëm, që peshojnë dhe zgjedhin mes konceptimeve konkurruese të së mirës publike, është bërë një cirk i shumëkëluar fjalimesh stok, batutave të transmetuara në televizion, lutjeve simbolike, pretendimesh e kundërp pretendimesh të zbrazëta, si dhe aktiviteteve të koreografuara. Dhe nuk ekziston asnjë mënyrë për ta eliminuar këtë pa dëmtuar liritë themelore, mbi të cilat bazohet vetë demokracia liberale. Përgjigja, besojmë, gjendet tek përpjekja për të kontrolluar efektet e saj. Me fjalë të tjera, mënyra më e mirë për ta bërë këtë është duke e bërë politikën më shumë, dhe jo më pak, argëtuese. Një numër reformash të rekomanduara

më poshtë synojnë (në radhë të parë, por kurrë ekskluzivisht) që ta bëjnë pjesëmarrjen në zgjedhje, në parti politike apo në shoqërinë civile më të lehtë, më interesante, dhe, fare sinqerisht, më dëfryese. Siç vuri në dukje një vëzhgues i mençur, në përgjigje të një drafti të mëparshëm të këtij libri, “keni marrë parasysh faktorin *dëftrim*”.

Ndërkohë që rekomandonim reforma specifike institucionale, na u duk e domosdoshme t’i ktheheshim pikës sonë të nisjes, e cila është: “demokracia është fjala për diçka, që nuk ekziston”. Së pari, pranojmë që promovimi i demokracisë ka për të qenë gjithmonë “punë e papërfunduar.” Sukseset në përballimin e sfidave të veçanta apo rrokja e shanseve të veçanta vetëm sa do të zhvendosë pritshmëritë drejt sfidave të reja në të ardhmen. Qytetarët do të përqëndrojnë kërkesat e tyre për barazi mbi burimet e reja të diskriminimit, kërkesat për llogari-dhënie (përgjegjshmëri) tek marrëdhëniet e reja të dominimit, kërkesat për vetërespektim tek fushat e reja të identitetit kolektiv. Gjithçka, që mund të shpresojmë në mënyrë realiste, është që masat për reformim, që mbështesim do ta lëvizin sistemin politik kah një drejtim pozitiv – ato asnjëherë nuk do ta mbushin përfundimisht “deficitin e demokracisë.” Së dyti, refuzojmë nocionin se ekziston një tip ideal i demokracisë, të cilin të gjitha vendet europiane duhet ta bëjnë të vetin menjëherë apo të bashkohen drejt tij në mënyrë graduale. Për rrjedhojë, nuk duhet të jetë detyrë e Këshillit të Europës që të identifikojë dhe të bëjë avokatin e një pakete reformash identike, që do ta arrijnë këtë. Secili shtet anëtar do të duhet të gjejë mënyrën e vet “të duhur” për t’u ballafaquar me gamën e paparë të sfidave dhe shanseve, që gjenden para rajonit si i tërë. Shtetet anëtare kanë shumë për të mësuar nga njëri-tjetri dhe Këshilli i Europës duhet të luajë një rol aktiv për kultivimin e atij procesi, por pikat e nisjes janë të ndryshme, ashtu siç janë të ndryshme përmasat dhe përzierja e sfidave dhe shanseve. Prandaj, reformat në institucione dhe rregullat nuk do të prodhojnë të njëjtat efekte pozitive dhe të synuara në të gjitha vendet, që i përvetësojnë ato. Reformat, që mund të mirëprehen nga qytetarët e disa shteteve anëtare, mund të refuzohen me bujë nga të tjerë qytetarë. Dikush mund edhe të argumentojë se një shumëllojshmëri e tillë në kuptime dhe pritshmëri është diçka e shëndetshme për të ardhmen e demokracisë në Europë. Ajo siguron varietete të vazhdueshme eksperimentesh politike brenda një rajoni të botës, njësitë e të cilit janë shumë të ndërvarura dhe të afta për të mësuar – pozitivisht dhe negativisht – nga përvojat e njëra-tjetrës.

Në një përmbledhje *grosso modo*, mund të dallojmë tri “modele” të demokracisë, që vazhdojnë të jetojnë në të gjitha shtetet anëtare në shkallë të ndryshme – atë numerik, negociues dhe diskutues. Këto modele nuk janë të papërputhshme me njëri-tjetrin, por secili e vendos theksin mbi institucione të ndryshme dhe, për rrjedhojë, mbi reformën e institucioneve të ndryshme. Diçka me rëndësi të veçantë tani që jemi gati për të bërë avokatin e ndryshimeve specifike në institucionet formale dhe praktikat informale është që të mos kufizohemi tek njëri nga këto modele apo tjetri, por të pranojmë që të trija modelet potencialisht kanë diçka për të kontribuar për përmirësimin e cilësisë së demokracisë në Europë.

Modeli numerik. Demokracia përbëhet nga një proces, në të cilin qytetarët me të drejta dhe detyrime të barabarta marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë (në zgjedhje, zgjedhje kandidatësh brenda partive, referendume, nisma, sondazhe e kështu me radhë) apo në mënyrë të tërthortë (nëpërmjet përfaqësuesve në parlament, komiteteve legjislativë, komisioneve hetimore, komiteteve këshillimore, qeverive vendore e kështu me radhë) në marrjen e vendimeve kolektive detyruese me anë të konkurrimit, në mënyrë që të zgjidhet alternativa, që siguron më shumë vota (sasinë më të madhe krahasuar me alternativat e tjera) apo më shumë se gjysmën e votave (shumicën).

Modeli negociues. Demokracia përbëhet nga një proces, në të cilin qytetarët me parapëlqime, të cilat kanë intensitet të ndryshëm dhe, me raste, ofrojnë zgjedhje të papërputhshme hyjnë – përsëri, drejtpërdrejt ose tërthorazi – në negociata me njëri-tjetrin për të arritur në një vendim kolektiv detyrues me anë të konsensusit, çka do të thotë një vendim, që ka avantazhe të ndërsjella dhe, për pasojë, është i pranueshëm për të gjithë.

Model diskutues. Demokracia përbëhet nga një proces, nëpërmjet të cilit qytetarët bien në një mendje për të shkëmbyer informacion mbi interesat dhe pasionet e njëri-tjetrit në kushte të hapjes së ndershme, respektit të ndërsjellë dhe pushtetit të barabartë me qëllim që t’i ndryshojnë këto parapëlqime paraekzistuese, të zbulojnë zgjedhje të përbashkëta dhe të arrijnë në një vendim detyrues me anë të konsensusit.

Objekti i reformës ka të ngjarë të ndryshojë në varësi modelit, që mbështetet apo konsiderohet si më i përshtatshmi për një sistem të caktuar politik. “Numerikët” do të kenë prirjen të përqendrohen tek masa, që nxisin qytetarët të votojnë, të zgjerojnë pikat, ku mund të ndodhë kjo, të përmirësojnë procesin e verifikimit të mundësive zgjedhore dhe të përforcojnë rëndësinë e partive politike dhe organeve përfaqësuese, që përfshihen në mekanizma të tillë. “Negociuesit” do të jenë të

shqetësuar më shumë për përmirësimin e mjeteve për të shprehur interesa dhe pasione kolektive nëpërmjet shoqatave dhe lëvizjeve dhe për të përftuar akses te kanalet e politikëbërjes jashtë kanalit klasik partiak-parlamentar. “Diskutuesit” kanë më shumë gjasa të anojnë nga zhvillimi i forumeve, sidomos në nivelin vendor ose në nivelin e çështjeve specifike, në të cilat qytetarët mund të takohen me njëri-tjetrin drejtpërdrejt, pa ndërhyrjen e ndërmjetësve të organizuar, dhe të përpiqen ta bindin njëri-tjetrin mbi atë, që do të ishte rruga më e mirë e veprimit.

Rekomandimet për reformë të radhitura më poshtë nuk është se udhëhiqen në mënyrë ekskluzive nga ndonjë prej tri modeleve, por nga bindja që të gjitha demokracitë “e vërteta ekzistuese” në Europë mbështeten mbi një përzierje të të trijave – dhe që kjo është diçka e mirë. Këto rekomandime nuk përkrahen aspak me entuziazëm të njëjtë nga të gjithë autorët, por jemi përpjekur të ndjekim të njëjtat udhëzime të shqyrtuara më poshtë, kur i kemi propozuar ato.

Udhëzime

Paanshmëria. Kemi synim të propozojmë reforma, me shpresën për përkrahje kolektive nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, të cilat do të përmirësonin cilësinë e demokracisë. Sa të jetë e mundur, këto rekomandime duhet të jenë “neutrale” në kuptimin që nuk jënë dizenuar qartësisht për të mirën e një partie apo prirjeje politike (si e majta, qendra, apo e djathta) në krahasim me një tjetër. Po të ishte e mundur, reformat gjithashtu duhet të jenë optimale sipas Pareto në kuptimin që asnjë parti apo prirje politike ekzistuese të mos vuante nga zbatimi i tyre dhe se do të përfitonin të gjitha. Ky kusht i fundit është qartësisht i pamundur të përmbushet – qoftë edhe vetëm për shkak të gjasave të larta për një kundërshtim “të parashikuar” nga ndonjë parti – por nuk është e pamundur që zbatimi eventual i reformës të jetë me përfitim për një spektër aq të gjerë interesash/pasionesh, sa edhe pakica fillestare të arrijë ta pranojë, madje edhe ta përkrahë atë.

Bëshmëria (feasibility). Këtu çështja parësore është një çështje agjencie, domethënë, çfarë kombinimi fillestar forcash politike, që veprojnë sipas rregullave ekzistuese të lojës “demokratike liberale”, do të mbështeste dhe do të zbatonte një rekomandim të tillë. Një çështje dytësore është ajo e difuzionit, pra, se si vlerësimi i masave të reformave iniciuar në një shtet anëtar apo grup shtetesh anëtare do të ndikonte mundësinë për adoptim të mëpasshëm në shtete të tjera, që fillimisht

kishin treguar hezitim për t'i provuar ato. Propozimet u paraqitën vetëm nëse ne mendonim që ekzistonin perspektiva realiste si për agjencinë ashtu edhe për difuzionin.

Niveli i zbatimit. Reformat e rekomanduara mund të mos prodhojnë efekte të ngjashme (të synuara/të pasynuara, të dëshiruara/të padëshiruara) në nivele të ndryshme të përbërjes politike, qoftë edhe brenda të njëjtit sistem politik. Diçka, që ndikon për përforcimin e demokracisë në nivel vendor, shumë mirë mund të ketë një ndikim autokratik nëse adoptohet në nivel kombëtar. Për rrjedhojë, çdo propozim për reformë duhet të specifikojë dhe të justifikojë nivelin e përshtatshëm të aplikimit të tij. Aty ku është e mundur, eksperimentimi fillestar me reformën duhet të ndodhë në nivelin më të ulët të përbërjes politike dhe vetëm pasi të jetë provuar se ndikon në përforcim të demokracisë në atë nivel, atëherë duhet përcjellë në një nivel më të lartë – madje, edhe atëherë, në mënyrë shumë të matur dhe graduale.

Strategji për zbatim. Si rregull, zbatimi i reformave demokratike duhet të trajtohet si eksperiment politik, pra, në fillim duhen paraqitur në një numër të vogël njësisish të përzgjedhura me kujdes, duhen monitoruar nga afër për efektet e tyre anësore dhe të shtrihen në njësi të tjera në të njëjtin nivel apo në një nivel më të lartë të përbërjes politike vetëm pasi të jenë të njohura efektet e tyre pozitive dhe negative. Ideale do të ishte që njësitë fillestare për eksperimentim të zgjidheshin mbi bazat e sistemeve “më pak të ngjashme”, që do të thotë që dikush duhet të kontrollojë për dallime të tjera dhe të përzgjedhë sisteme, që janë sa më të ndryshme që të jetë e mundur në variablin apo variablet që priten të kenë ndikimin më të madh mbi suksesin apo dështimin. Shpesh nuk është e mundur të dihet që më parë se çfarë variabli apo variablesh do të ndikojnë zbatimin. Për rrjedhojë, mund të jetë e dëshirueshme që efekti të stimulohet duke provuar reformën në një përzierje njësisish më të mëdha/më të vogla, më të zhvilluara/më pak të zhvilluara, apo më qendrore/më periferike.

Horizonti i kohës. Ishim të interesuar të eksploronim dhe të bënim avokatin e reformave, që mund të adoptoheshin më shpejt, pra, pa ratifikim kushtetues apo të tipit traktat, në krahasim me ato, që nuk mund të adoptoheshin vetëm nëpërmjet procesesh shumë më të gjata. *Nota ben,* që mund të jetë e mundur “me kosto minimale” që të eksperimentohet me reforma në një nivel vendor, më pak të dukshëm, dhe që do të duhej të kapërcenin një prag shumë më të lartë, në qoftë se do të “kombëtarizoheshin” menjëherë.

Kriteret për përzgjedhje. Janë mbajtur vetëm ato propozime për reforma, që gjeneronin konsensus mes të gjithë apo shumicës së autorëve. Nëse personi më përgjegjës për aspektin thelbësor të demokracisë, që prekej më drejtpërdrejt nga reforma e propozuar, ishte kundër, atëhere reforma nuk përkrahej.

“Lista jonë e dëshirave” për reforma të rekomanduara

1. Nënshtetësia universale

Ky propozim do t’u akordonte të drejta të plota anëtarësimi në bashkësinë politike nga çasti i lindjes të gjithë personave të lindur brenda territorit të kësaj bashkësie ose të gjithë nënshtetasve të tij, që jetojnë jashtë, si edhe atyre fëmijëve, që më pas natyralizohen. Ndërsa pranon pamundësinë e dukshme të fëmijëve për të ushtruar të drejtat e tyre formale në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavarur, kjo reformë rekomandon më tej që prindërit e çdo fëmije të fuqizohen për ta ushtruar të drejtën për të votuar deri në atë kohë sa fëmija të arrijë moshën e pjekurisë të përcaktuar sipas ligjit kombëtar. Secilit fëmijë do t’i lëshohej një kartë regjistrimi votimi apo çfarëdo mjeti është tashmë në përdorim për të identifikuar votuesit dhe do të informohej për të drejtën e tij apo të saj (të shtyrë në kohë) për të votuar. Vendimi se saktësisht cili prind do ta ushtronte realisht këtë të drejtë për fëmijët e tyre, përpara se të arrinin moshën 16 apo 18 vjeç, do të vendosej nga një marrëveshje mes prindërve, që janë të pranueshëm. Në rast se do të kishte vetëm një prind apo një kujdestar, atëherë do të votonte ky person.

Kjo reformë duhet ta bëjë demokracinë vendore, rajonale, apo kombëtare më “të orientuar drejt së ardhmes.” Lejimi i votës së fëmijëve jo vetëm do të përbënte një pranim simbolik që sistemi ka një përgjegjësi për brezat e tij të ardhshëm, por edhe do të siguronte një shtysë reale për të rinjtë që të zhvillojnë një interes të hershëm në politikë dhe ta bënin këtë nëpërmjet ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e cilitdo niveli të përbërjes politike, që u akordoi këtë të drejtë. Pikërisht për shkak të kësaj shtyse, duhet pritur që fëmijët – sapo të jenë të ndërgjegjshëm për të drejtën, që prindërit e tyre po ushtrojnë në emër të tyre në zgjedhje parlamentare apo presidenciale – do t’u kërkojnë gjithmonë e më shumë llogari prindërve për mënyrën si i shpërndajnë parapëlqimet e tyre zgjedhore. Kjo sugjeron, gjithashtu, që reforma do të rriste forma të ndryshme të diskutimit ndërbrezor mbi çështje politike dhe orientimet partiake në përgjithësi – duke forcuar kanalet e socializimit politik dhe duke përmirësuar

elementet e trajnimit të qytetarëve brenda familjes, të cilat duken se janë zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit. Kjo madje mund edhe të kompensojë rënien shumë të madhe në ndjenjën e identifikimit partiak dhe ka të ngjarë të ushtrojë trysni mbi politikanët që të ulin moshën e pjekurisë politike nga 18 në 16, në mos edhe përtej këtij kufiri.

Shtetësia universale gjithashtu duhet të shërbejë si një stimul i dyfishtë për të nxitur votimin mes prindërve të rinj, meqenëse fëmijët e tyre me gjasë do t'u bënin presion për të votuar dhe pesha e votës së tyre, me t'u hedhur, do të rritej sipas numrit të fëmijëve, që kishin. Për më tepër, politikanët do ta pranonin këtë fakt dhe do t'i orientonin thirrjet dhe politikat e tyre më shumë drejt këtij segmenti (shpesh të lënë pas dore) të popullsisë.

Së fundi, dhënia e së drejtës së votimit fëmijëve të vegjël dhe adoleshentëve duhet të kontribuojë për një ekuilibër më të madh të procesit politik gjatë ciklit të jetës. Me rritjen e jetëgjatësisë dhe një moshë të përcaktuar për daljen në pension, personat më të moshuar janë bërë një pjesë gjithnjë e më e madhe e qytetarëve. Ata kanë si kohën ashtu edhe burimet financiare për të marrë pjesë në mënyrë të shpërpjestuar në proceset zgjedhore dhe të politikave – ku rezultati është që një përqindje në rritje e fondeve publike po harxhohen për shëndetin dhe mirëqenien e të moshuarve dhe një sasi fondesh në rënie po harxhohen për shkollimin dhe trajnimin e të rinjve. Nga pikëpamja afatgjatë ky proces është i destinuar të jetë vetë-dërrmues, meqenëse një pjesë më e vogël dhe më pak produktive e punëtorëve aktivë duhet të paguajë për një pjesë gjithnjë e më të madhe punëtorësh në pension.

2. Votimi me mundësi zgjedhjeje

Teoria tradicionale demokratike liberale thekson jo vetëm “një person, një votë”, por edhe që kjo votë të jetë e pandashme – e hedhur për një listë të vetme partish apo për një kandidat të vetëm. Disa sisteme lejojnë një nivel të kufizuar “transferueshmërie” duke i dhënë votuesit të drejtën për të shënuar një preferencë të dytë ose mundësinë për të ndryshuar radhën e preferencave në një listë partiake. Kohët më të fundit, disa sisteme politike e kanë zgjeruar mundësinë e zgjedhësve për të zgjedhur duke u lejuar të votojnë për “asnjë nga këta” (ANK). Në përgjithësi, jemi të bindur që zgjerime të tilla “me mundësi zgjedhjeje” të procesit të votimit janë të dëshirueshme. Ato i bëjnë zgjedhjet më interesante, e trajtojnë qytetarin me më shumë respekt dhe promovojnë

më shumë konkurrim politik, jo thjesht midis partive dhe kandidatëve, por edhe me kombinime të pazakonta dhe alternativa të mundshme.

Historikisht, përdorimi i mundësisë për të zgjedhur ishte i kufizuar nga arsye praktike, të tilla si sasia e kohës dhe vëmendja, që mund të pritet nga një votues mesatar, gjatë kohës, që ai apo ajo harxhonte në dhomën e votimit. Nëse, sipas alternativës të mbështetur nga ne, demokracitë europiane kalojnë në mënyrë graduale drejt votimit me postë apo atij elektronik, mundësia për të dhënë më shumë informacion dhe për të ushtruar më shumë mundësi zgjedhjeje do të zgjerohet shumë. Nënshetasi do të kishte një periudhë të gjatë kohe, gjatë së cilës do të shprehte zgjedhjet e tij apo të saj – të themi, një javë a më shumë – dhe, për rrjedhojë, mund të imagjinosh ofrimin e një game më të gjerë zgjedhjesh. Për shembull, një qytetari mund t'i jepet jo vetëm një votë por një numër “pikësh votimi” – le të themi, njëqind – për t'i shpërndarë mes kandidatëve apo listave të votimit, si edhe të ofrohet “asnjë nga këto,” nëse zgjedhjet e mësipërme nuk do të ishin tërheqëse. Votuesit do të kishin mundësi të regjistronin intensitetin e parapëlqimit të tyre për një parti apo kandidat specifik dhe vetë kjo do të bëhej pjesë e regjistrimit publik. Për shembull, fituesit me një raport më të lartë të preferencave 100% me të drejtë mund të pretendojnë se gëzojnë mbështetje më të madhe publike se ata, që fituan me të njëjtin marzh total, por me ritme më të ulëta mbështetjeje nga votuesit. Një numër në rritje i votave “asnjë nga këto” do të ofronte një sinjal shumë më të qartë pakënaqësie sesa e kundërta, që zakonisht është një abstenim më i madh zgjedhor. Madje mund edhe të parashikohet që në zonat zgjedhore, në të cilat varianti “asnjë nga këto” mori një shumicë relative, të mbahej një raund tjetër votimi dhe, nëse situata vazhdonte njësoj, asnjë përfaqësues nuk do të zgjidhej nga ajo zonë.

3. Llotari për zgjedhësit

Kemi theksuar në mënyrë të përsëritur nevojën për të përmirësuar daljen e njerëzve në votime në të gjitha nivelet e konkurrimin politik. Disa prej propozimeve të mësipërme për reformë mund ta kenë edhe këtë si një efekt të tërthortë. Për shembull, nënshetësia universale, duke iu dhënë vota shtesë familjeve me fëmijë, mund të rrisë pjesëmarrjen zgjedhore midis qytetarëve të rinj. Votimi me mundësi zgjedhjeje duhet ta bëjë aktin e të votuarit më interesant dhe më shprehës të parapëlqimeve individuale dhe kjo mund të jetë tërheqëse edhe për qytetarë, që kanë qenë të ftohur më parë. Megjithatë, duhet të merremi prapë me ofrimin e shtysave të

drejtpërdrejta dhe pozitive për pjesëmarrjen zgjedhore. Të votuarit e detyruar e ka pasur një ndikim të tillë në të kaluarën, por kjo duket se është duke u zbehur ndërkohë që individët mësojnë që autoritetet publike hezitojnë ose janë të paafta të sanksionojnë masat, kur detyrimi nuk zbatohet. Grekët e lashtë merrnin parasysh thjesht të paguarit e qytetarëve përkatës që të harxhonin një ditë duke dëgjuar fjalime në Agora, por në botën bashkëkohore kjo duket papranueshmërisht komerciale në një proces zgjedhor, që është tashmë tej mase i mbarsur me shqetësime financiare.

Prandaj propozojmë një llotari – ose, më mirë, tri llotari – për votuesit. Secili person, që voton, do të merrte një nga tri biletat e llotarisë së posaçme: një biletë për ata, që votonin për herë të parë; një për votuesit e rregullt (për shembull, ata, që kanë votuar në të gjitha zgjedhjet e mëparshme, për të cilat kanë pasur të drejtën e votës ose në tri herët e fundit); dhe një për të gjithë votuesit e tjerë. Numrat fitues do të tërhiqeshin në të njëjtën kohë, që shpallehin rezultatet e zgjedhjeve, dhe emrat e fituesve të rastit do të publikoheshin dhe shpërbleheshin. Çmimet nuk duhet të jenë shuma parash për blerje private, por porcione të buxhetit publik për t'u shpërndarë për programe shtetërore apo shoqata dhe lëvizje jofitimprurëse në shoqërinë civile. Fituesve do t'u jepej një periudhë, le të themi, një muaj, për të vendosur se cilave organizata apo programe do t'ua jepnin shumat e tyre përkatëse dhe gjatë kësaj kohe do të merrnin propozime të ndryshme nga agjentë publikë dhe gjysmëpublikë. Në të vërtetë, pas publikimit, vendimet, që këta qytetarë të për zgjedhur rastësisht kishin marrë, mund të kishin një ndikim domethënës mbi përcaktimin e përparësive të politikave publike dhe/ose mbi nxitjen e mbështetjes vullnetare për organizatat në shoqërinë civile.

4. Mandatet e përbashkëta

Praktika normale në të gjitha demokracitë ekzistuese është që qytetarët zgjedhin një deputet për t'i përfaqësuar ata – ose nga një listë partiake ose në një zonë zgjedhore me një anëtar të vetëm. Po sikur partive t'u kërkohej të emëronin “çifte” kandidatësh për çdo post? Një prej të dyve do të ishte *primus inter pares*; tjetri do të ishte zëvendësi i tij apo i saj. I pari do të merrte një pagë të plotë; i dyti një gjysmë page. Partitë do të ishin të lira të vendosnin për të balancuar këto çifte – sipas seksit, moshës, fesë, apo origjinës shoqërore – por votuesit do t'i duhej t'i zgjidhte që të dy sëbashku. Do të kuptohej që i pari nga të dy do të ishte “më i lartë”, në kuptimin që ai apo ajo mund të ushtronte mandatin për

periudhën e plotë dhe të ishte posaçërisht përgjegjës për të gjitha detyrimet, ose mund t'i ndanin detyrat sipas periudhës së kohës apo funksionit legjislativ. Partitë mund të dëshironin të tregonin që më parë se cila do të ishte ndarja e punës në legjislaturën e ardhshme – ose mund ta linin këtë në dëshirën e çiftit, pasi këta të ishin zgjedhur. Avantazhet e një sistemi të tillë janë të shumëfishta: (1) i lejon personat të marrin pjesë në mënyrë aktive në politikën legjislative, ndërkohë që ndjekin karrierat e veta; (2) do të nxiste barazi në përfaqësim përsa i përket seksit, moshës, apo burimeve të tjera të diskriminimit shoqëror; (3) mund të ofronte një suplement të dobishëm ekspertize për procesin legjislativ si i tërë; (4) mund të shërbente si një mjet për futjen graduale të të rinjve në procesin konkurrues politik; dhe (5) do të siguronte që një pjesë më e madhe e popullsisë do të merrte pjesë në përvojën e drejtpërdrejtë të qeverisjes.

5. Organe Këshilluese te Specializuara të Zgjedhura

Demokracitë europiane moderne tashmë janë të rrethuara nga një shumësi komitetesh këshilluese, “kuvendesh funksionale” dhe këshillat konsultuese – shumë prej të cilave synojnë të ofrojnë akses të garantuar për organizatat e shoqërisë civile në agjencitë shtetërore dhe organet vendimmarrëse. Ekspertiza dhe informacioni, që ato ofrojnë, janë plotësuese të rëndësishme të shqyrtimeve të kuvendeve legjislative dhe të domosdoshme për të përballuar kompleksitetet në rritje të politikës publike. Megjithatë, statusi i tyre demokratik është vënë shpesh në diskutim, meqenëse ato ofrojnë akses të privilegjuar ndaj atyre interesave dhe pasioneve, që janë më të mirëorganizuara dhe atyre që jo domosdoshmërisht janë më të shqetësuara për interesin publik. Zakonisht, pjesëmarrësit në këto këshilla përzgjidhen ose nga politikanët ose nga punonjësit civilë sipas një parimi të tillë si “shoqata më përfaqësuese” ose “lëvizja më këmbëngulëse.”

Ne propozojmë që qeveritë në nivele të ndryshme – vendore, rajonale dhe kombëtare – të marrin në konsideratë mbajtjen e zgjedhjeve periodike, të specializuara për anëtarësi në organe këshillimore, që u ofrojnë atyre këshilla mbi çështje, që kanë të bëjnë me grupe të tilla shoqërore si të rinjtë, të moshuarit, të papunët, pakicat etnike ose fetare, njerëz me paaftësi apo banorë të huaj. Fituesit e këtyre zgjedhjeve do të paguheshin me një shumë modeste për pjesëmarrjen e tyre. Është e dukshme që natyra e këtyre këshillave do të varioje sipas kontekstit kombëtar apo nënkombëtar. Sipas të gjitha gjasave, shoqata dhe lëvizje paraekzistuese (dhe, në disa raste, parti politike) do të bëhen më të

suksesshme në gara të tilla sesa ato të krijuara rishtas, por legjitimiteti i tyre si përfaqësues do të përforcohet përmes fitores dhe do të kenë prirje më të madhe për të zhvilluar programe më të gjera me qëllim që të tërheqin vota nga një publik më i gjerë. Për më tepër, mund të parashikosh delegimin e kontrollit mbi asete specifike buxhetore tek organe të tilla. Besojmë që mund të paraqiten argumente veçanërisht bindëse për krijimin e një Këshilli të Jo-Shtetasve dhe do të bëjmë një propozim specifik për këtë qëllim, por praktika mund të zgjerohet për të mbuluar edhe grupe të tjera shoqërore – të tilla si të rinjtë dhe të moshuarit – aty ku ekzistojnë kushtet e përshtatshme për ta bërë këtë. Nuk ka nevojë të thuhet që kjo është një reformë, që do të ishte më e lehtë si për ta zbatuar ashtu edhe për ta monitoruar, nëse fillimisht do të aplikohesh në nivelin vendor apo bashkiak dhe, vetëm po të rezultonte me sukses aty, atëherë mund të ishte e këshillueshme që të kalohej më lart, në nivelin rajonal apo kombëtar.

6. Kioskat e demokracisë

Një prej ankesave universale, që dëgjohet mbi demokracinë bashkëkohore, është që ato janë “të largëta.” Funksionimet e tyre janë aq komplekse dhe zhvillohen nëpërmjet ndërhyrjes së aq shumë shtresave të vendimmarrjes dhe zbatimit të politikave sa që qytetari i zakonshëm ndihet i paaftë për të arritur tek ata, që kanë përgjegjësi – edhe kur ai apo ajo ka motivim të mjaftueshëm për ta bërë këtë. Për më tepër, thjesht vëllimi i informacionit, që qeveritë përcjellin, është rritur deri në atë shkallë sa nuk mund të presësh nga askush që ta ndjekë përveç se kur ndërmarrin një përpjekje të jashtëzakonshme për këtë.

Po sikur qeveritë demokratike – nëpërmjet bashkëpunimit midis të gjitha niveleve, deri në nivelin Europian dhe duke e përfshirë edhe atë – do të krijonin sisteme gjithëpërfshirëse kioscash publike në vende të dukshme, ku mund të shkohet lehtësisht, në çdo lagje urbane, qytet dhe fshat? Pavarësisht nëse do të vendoseshin më vete apo brenda mjedisesh të tilla si zyra të qeverisë vendore, biblioteka publike apo edhe komisarate policie, ato mund të shërbenin si pika shpërndarjeje për botime zyrtare, do të lejonin qytetarët të kryenin transaksione rutinore të tilla si pagesë detyrimesh/taksash dhe noterizim dokumentesh, do të ofronin përdorim falas të internetit shkëmbyer (për të marrë dhe dërguar mesazhe me agjenci publike dhe do të ofronin këshilla të personalizuar, ballë për ballë nga funksionarë vendorë mbi ligje dhe rregullore. Eventualisht, nëse dhe kur sistemi politik të lëvizë drejt votimit elektronik

(shih Nr. 8 më poshtë), këto kioska mund të ndihmonin mbushjen e “hendekut dixhital” duke ofruar mundësi të posaçme elektronike për ata, që nuk kanë kompjutera në shtëpi apo zyra, si edhe udhëzime për përdorimin e tyre. Me qëllim që qeveritë vendore të mos ngarkohen në mënyrë të padrejtë me një barrë të tillë financiare dhe për të siguruar një shpërndarje të njëjtë anembanë territorit kombëtar, ky sistem mund të financohej nga të ardhurat e qeverisë qendrore. Shpenzimi mund madje edhe të amortizohet me kalimin e kohës përmes një uljeje korresponduese në koston e zhvillimit të zgjedhjeve, dërgimit të njoftimeve zyrtare dhe përgjigjeve për pyetje me postë apo telefon.

7. Këshilluesit e qytetarëve

Një program i “këshilluesve të qytetarëve” mund të ishte një mënyrë e efektshme për t’i prezantuar migrantët me kulturën e shoqërisë pritëse si edhe për të familiarizuar qytetarët “vendas” me kultura të huaja. Këshilluesit do të ishin vullnetarë, për shembull studentë, të cilët do të merrnin përsipër detyra të tilla si ofrim ndihme për migrantët që të regjistroheshin në sistemin e kujdesit shëndetësor, të merrnin pjesë në veprimtari të shoqatave të ndryshme qytetare dhe që do t’u shpjegonin atyre bazat e sistemit ekzistues politik, të tilla si të drejtat politike, procedurat e votimit, regjistrimin për të votuar. Ata mund të ishin edhe “të rekrutuar” nga shërbimi civil, propozuar në Nr. 10. Këshilluesit dhe migrantët duhet të takohen në mënyrë periodike, nëse është e mundur, gjatë gjashtë muajve të parë pas hyrjes në vendin pritës. Këshilltarët do të kishin marrë më parë trajnim formal mbi ndërgjegjësimin shumëkulturore dhe pjesëmarrjen qytetare nëpërmjet programesh të standardizuara. Një libër elektronik (e-book) i përbashkët duhet të vihet në dispozicion në të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Europës me një listë të plotë të burimeve online për përdorim nga ana e stafit trajnues dhe këshillues. Secila qendër e këshilluesve publikë do ta plotësonte këtë me informacion specifik sipas nevojave vendore, rajonale apo kombëtare. Këshilli i Europës mund të shërbente si një bashkërendues rajonal i këtyre përvojave dhe mund të përhapte informacion mbi ato, që janë provuar si përvojat më premtueset. Me qëllim që të inkurajohen si qytetarët ashtu edhe migrantët për të marrë pjesë në mënyrë vullnetare në këtë program, atyre mund t’u ofrohej kompensim jo-monetar në formën e biletave falas për në aktivitete sportive apo kulturore apo kuponave për t’u harxhuar për kurse shkollimi apo gjuhe shpesh. Në mënyrë alternative, aty ku përdorimi i vullnetarëve apo rekrutëve do të çlironte stafet administrative vendore

nga detyrat e lidhura me migrantët, atyre mund t'u paguhej një pagë modeste (minimale) me orë. OJQ-të në disa vende tashmë ofrojnë forma analoge të këshillimit si edhe ndërmjetës kulturorë dhe mund të subvencionoheshin për t'i zgjeruar dhe sistematizuar këto praktika, të cilat mund të institucionalizoheshin dhe përmirësoheshin nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar.

8. Këshilli i Jo-Shtetasve

Çdo njësi politike në Bashkimin Europian, që ka më shumë se një proporcion të paracaktuar (le të themi, 10%) të popullsisë totale, që përbëhet nga “jo-shtetas” – banorë me të drejtë të ligjshme banimi nga shtete jo-anëtare të BE-së – duhet të krijojë një këshill për përfaqësimin e tyre politik. Ky duhet të jetë një forum për bashkëbisedim të rregullt mes të ardhurve dhe për shkëmbime periodike mendimesh me këshillat ekzistuese, që përbëhen nga qytetarë në nivelet bashkiake, rajonale dhe kombëtare. Të ardhurit gjithashtu duhet të jenë të lirë të ftojnë politikanë, akademikë dhe praktikantë politikash në takimet e tyre si edhe të angazhohen në një dialog më të gjerë me publikun mbi çfarëdo çështjesh, që ata zgjedhin të vendosin në axhendën e tyre. Përmasat, kompetencat dhe burimet e këtij këshilli mund të variojnë sipas kontekstit shoqëror dhe ligjor të njësisë politike.

Përfaqësuesit në këtë këshill duhen zgjedhur nëpërmjet zgjedhjeve të posaçme (por, në mënyrë ideale, të tilla që të përkohet me zgjedhjet normale të qytetarëve në këtë nivel) me anë të konkurrimit mes partive politike (presupozohet në sistemin e përfaqësimit proporcional, me lista të mbyllura të emëruarish). Këto parti mund të përbëheshin ose nga seksione “j-shtetasish” të partive tashmë ekzistuese, ose nga parti të krijuara posaçërisht për të tilla zgjedhje. Secili kandidat duhet të identifikohet me emër, profesion dhe kombësi dhe, aty ku është e mundur, duhet ofruar informacion mbi programin e partisë, që e ka emëruar atë. Partitë e krijuara posaçërisht për këto zgjedhje mund të formohen nga lista “kombëtare” (për shembull, shqiptarë, kinezë, senegalezë, ukrainas), nga lista “kontinentale” (për shembull, afrikanë, amerikano-latinë, aziatiko-jugorë), nga lista “fetare” (të tillë si myslimanë, konfucianë, protestantë) apo nga lista “kozmpolitane”, që kanë një përbërje nga të gjitha këto kategori.

Një proces i tillë konkurrues politik brenda bashkësisë së jo-shtetasve do të shmangte nevojën për përcaktimin e kuotave specifike dhe nuk do të certifikonte publikisht (dhe, për rrjedhojë, nuk do të

konkretizonte) ndonjë institucion specifik (shoqatë, lëvizje, apo parti) apo ndonjë identitet (komb, rajon apo fe). Do të varej nga vetë jo-shtetasit që të krijonin parti sipas perceptimit të tyre për interesin e përbashkët apo identitetin – dhe procesi konkurrues do të përcaktonte se cilat prej këtyre kanë të drejtë përfaqësimi në Këshillin e Jo-shtetasve. Në një situatë ideale “dinamikat bashkuese” të procesit zgjedhor do të kishin prirjen të shpërblenin ato parti, që përfaqësojnë kategori më të gjera interesi apo identiteti dhe, duke bërë këtë, do të kontribuonin për formimin e lidhjeve dhe aleancave ndërshtetërore.

Kompetencat e Këshillit të Jo-shtetasve duhet të variojnë sipas legjislacionit dhe dispozitave kushtetuese të vendit, por minimalisht, ai do të kishte të drejtën për t’u konsultuar mbi të gjitha çështjet, që kanë lidhje me interesat e jo-shtetasve në atë sistem politik. Maksimalisht mund t’i akordohej fuqia e vetos në lidhje me të gjitha vendimet, që ndikojnë në interesat jetësore të jo-shtetasve si të tillë. Në mes të këtyre situatave, këshilli mund të luante një rol të rëndësishëm “ndërmjetësues” mbi çështje të tilla si kushtet për dëbimin e të huajve banorë pa dokumente dhe të jashtëligjshëm dhe legalizimin e statusit të personave të tillë. Me fjalë të tjera, mund të funksiononte si një lloj “gjykate popullore” e përbërë nga “homologë të jo-shtetasve” për trajtimin e çështjeve të tilla të debatueshme në bazë të çdo rasti. Gjithashtu, këshillit mund t’i jepej një rol formal për të vlerësuar dhe/ose miratuar financime publike për shoqata, që u ofrojnë shërbime drejtpërdrejt dhe në mënyrë specifike të ardhurve dhe të huajve banorë të jashtëligjshëm.

Gjithashtu, burimet e tij duhet të variojnë nga një sistem politik në tjetrin, besojmë se kjo duhet të jetë sipas përmasave dhe kompetencave të tij. Një ide e mundshme, që mund të ndikonte në përgjegjësi më të madhe fiskale, do të ishte të financoheshin veprimtaritë e këshillit dhe çfarëdo subvencionesh apo grantesh, që ai mund të miratonte nga një kuotë e përcaktuar taksash paguar nga të ardhurit në një njësi të caktuar. Për shembull, një e treta e taksave mbi të ardhurat apo e TVSH-së së paguar nga të ardhurit mund të caktohej për qëllime të tilla. Këshillat duhet të kenë një burim të pavarur të ardhurash, që nuk është në varësi të buxhetit publik si të tërë apo në varësi të tekave të çfarëdo koalicioni qytetarësh, që formojnë qeverinë e vet në atë kohë.

Duke pasur parasysh shpërndarjen e tanishme të të ardhurve në shtetet anëtare, duhet imagjinuar se një reformë e tillë do të fillonte në nivelin bashkiak në ato qytete me përqendrimin më të madh proporcional të të huajve banues të ligjshëm. Nëse, siç pritet, këto organizata

vërtetohen se janë të dobishme për zgjidhjen (apo edhe për parandalimin) e konflikteve midis qytetarëve dhe të ardhurve dhe se janë të afta të stimulojnë pjesëmarrjen aktive të të ardhurve, atëherë, këto eksperimente të shpërndara mund të çonin në përhapjen e tyre në nivelet provinciale, kombëtare dhe suprakombëtare. Pse jo, mund të krijohej edhe një Këshill i Jo-shtetasve në Bashkimin Europian?

9. Të drejtat e votës për jo-shtetasit

Disa shtete kombëtare, kantone dhe bashki kanë zbatuar për herë të parë me sukses të drejtat e votimit për jo-shtetasit. Kjo praktikë duhet inkurajuar dhe përmirësuar. Në veçanti duhen paraqitur masa për ta bërë më të lehtë regjistrimin dhe më pas mundësinë për të votuar - e për rrjedhojë, për të marrë pjesë – e banorëve të huaj afatgjatë. Normalisht, shtetet dhe bashkitë japin të drejtat e votës pas një numri të caktuar vitesh banim në një vend (kjo normalisht varion nga dy deri në tetë vjet). Një propozim mund të ishte që të ardhurit, që marrin pjesë në programet e këshillimit të qytetarëve (shih Nr. 7) apo që demonstrojnë aftësi të zhvilluara në edukimin qytetar, çështjet kushtetuese dhe historinë politike të vendit pritës, mund të shpërblehen duke fituar të drejtën për votim për një periudhë më të shkurtër kohe.

10. Shërbimi qytetar

Vendet europiane gradualisht i kanë hequr sistemet e tyre të rekrutimit ushtarak. Shumë prej tyre kanë dispozita për shërbim qytetar alternativ, i cili është përdorur gjithnjë e më shumë nga kundërshtues të vetëdijshëm dhe është bërë një burim i rëndësishëm mbështetjeje shtesë për organizata në shoqërinë civile. Jo vetëm heqja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak do t'ua mohonte atyre këtë mbështetje, por ekzistojnë edhe arsye të tjera “demokratike” se pse një shërbim qytetar alternativ do të ishte një zëvendësues i dëshirueshëm. Ky shërbim do të ofronte një përvojë të përbashkët për të gjithë të rinjtë pavarësisht nga dallimet shoqërore (klasa, seksi, feja, rajoni, e kështu me radhë) në një komunitet më të gjerë kombëtar. Do t'i njihte ata me vlerën e punës në organizata politike dhe komunitare dhe do të ofronte një periudhë unike ekspozimi ndaj praktikës qytetare dhe barazisë demokratike. Nuk ka nevojë të thuhet që do të bëhej me shpejtësi një burim madhor mbështetjeje për organizatat e shoqërisë civile të përfshira në prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave publike.

Një shërbim i tillë do të ishte i detyrueshëm për të gjithë qytetarët dhe të gjithë të ardhurit (të cilët kanë jetuar në vend për më shumë se tri vjet) mes moshave 17 dhe 23 vjeç. Do të zgjaste për një periudhë shumë të shkurtër kohe për t'u pasuar nga mundësia për një zgjatje vullnetare. Përjashtimet mund të lejoheshin për arsye të lidhura me shëndetin apo familjen, por detyrimi duhet të jetë sa më i përgjithshëm dhe sa më jo-diskriminues që të ishte e mundur. Megjithatë, përvoja duhet të jetë sa më fleksibël dhe më e përshtatshme për nevojat individuale që të jetë e mundur. Për ta arritur këtë shërbimi duhet të ndahet në tri faza, një e detyrueshme dhe dy të tjerat vullnetare.

Faza 1 (e detyrueshme). Një një kohë të zgjedhur prej tyre, mes moshës 17 dhe 23 vjeç, të gjithë qytetarëve u kërkohet të kalojnë katër muaj për të përmbushur shërbimin e tyre qytetar. Muaji i parë do t'i përkushtohet edukimit të përgjithshëm qytetar dhe do të ofrohet nga një numër i shpërndarë institucionesh të njohura: shkolla të mesme, institute profesionale, universitete, OJQ dhe organizata të tjera jofitimprurëse apo firma, që do të paraqisnin kontrata konkurruese dhe do të paguheshin sipas tyre nga fonde publike. Gjatë tre muajve pasues, “rekrutët qytetarë” do të caktoheshin të punonin në organizata të shoqërisë civile apo agjenci të shërbimit publik të tilla si brigada zjarrfikëse, spitale, shtëpi për të moshuarit, qeveri vendore e kështu me radhë. Gjatë gjithë kësaj periudhe katërmujore, rekrutët do të paguheshin me të njëjtën pagë modeste (le të themi, pagën minimale, nëse ajo ekziston) për të mbuluar shpenzimet e tyre të jetesës (ushqim dhe strehim).

Faza 2 (me zgjedhje). Pas kësaj periudhe të shkurtër të detyrueshme ata, që kanë zgjedhur ta bëjnë këtë, do të mund të zgjasin përkushtimin e tyre edhe për një vit në të njëjtën organizatë ose në një tjetër. Përveç pagës modeste, atyre do t'u jepej e drejta për kupona (bonuse), që mund të përdoreshin vetëm për qëllime shkollimi (pagesa shkolle, tarifa, strehim apo shpenzime të tjera) gjatë një periudhe pasardhëse tri-vjeçare. Këto kupona mund të shpenzoheshin në kohën, që do ta zgjidhnin ata gjatë dhjetë viteve pasardhëse.

Faza 3 (me zgjedhje dhe në varësi të fondeve plotësuese nga organizata, që e kanë këtë të drejtë). Ata, që dëshirojnë dhe tashmë i kanë përmbushur fazat 1 dhe 2, mund të zgjidhnin të harxhonin edhe dymbëdhjetë muaj të tjerë në shërbimin qytetar, me kusht që një organizatë në shoqërinë civile apo

një agjenci shërbimi publik do të ishte e gatshme për t'i paguar një pagë ekuivalente me pagën modeste, që do të vazhdonin të merrnin nga burimet publike. Ky vit shtesë, më pas, mund t'u jepte të drejtën për dy vjet të tjerë kuponash për shkollim.

11. Edukimi për pjesëmarrje politike

Tradicionalisht, mbështetësit e demokracisë janë ankuar që qytetarët nuk edukoheshin mjaftueshëm për të bartur përgjegjësitë komplekse, që kërkohen prej tyre kur votojnë për përfaqësuesit apo kur marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimmarrje. Mbi këtë bazë, e drejta e pjesëmarrjes në votime shpesh ishte mbi bazë kompetence, që nënkupton që u mohohet atyre, që nuk kishin edukimin formal apo që ishin analfabetë. Në mënyrë ironike, në demokracitë bashkëkohore niveli i edukimit të përgjithshëm është rritur aq shumë saqë disa vëzhgues ankohen se qytetarët janë bërë tepër kritikë dhe kërkues ndaj politikanëve të tyre. Askush nuk duket se beson që popullsia ka marrë ndonjëherë edukimin politik “korrekt.” Njerëzit kanë prirjen të kenë një pamje të kufizuar të objekteve “politike,” për t'i katandisur çështjet politike në “propagandë politike”, për të mos qenë të ndërgjegjshëm për politika, programe, ide, parime, çështje, debate mbi çështje dhe mënyra për t'u përballur me probleme aktuale dhe, për pasojë, janë të prirur për të patur një vizion përkeqësues për politikën.

Kushdo është dakord se demokracitë e sotme kanë nevojë për qytetarë të informuar më mirë politikisht dhe, për rrjedhojë, të edukuar më mirë politikisht. Por si mund të arrihet kjo dhe, në mënyrë më specifike, cili duhet të jetë roli i politikave publike në këtë përpjekje? Shumica e programeve “të vërteta ekzistuese” për edukimin qytetar përqendrohen mbi një përshkrim të institucioneve formale dhe një recitim të parimeve normative. Ato janë shumë larg të ofruarit të njohurive dhe shprehive, që kërkohen nga një qytetari më e ndërgjegjshme politikisht. Në të vërtetë, një pjesë e mirë e kësaj përpjekjeje mund të jetë kundërproduktive – duke ndihmuar për të ushqyer cinizmin, kur praktikata e vëzhguara nuk arrijnë të përputhen me idealet e ngritura në qiell.

Ne besojmë që një përjasje më e mirë do të ishte që qytetarët të edukoheshin për pjesëmarrje reale në politikë – sikurse ajo ekziston në të vërtetë dhe jo siç duhet të jetë. Kjo do të kërkonte që studentët, në çaste të ndryshme gjatë edukimit të tyre, të vendoseshin në kontakt të drejtpërdrejtë me përfaqësues dhe sundues, që veprojnë në rolet e tyre të zakonshme qeverisëse. Theksi duhet të vendoset mbi “të mësuarit përmes

përvojës” në vend të “të mësuarit nga manualet”. Propozimi për një shërbim qytetar (Nr. 10), bazuar mbi vendosje në institucione të qeverisë dhe shoqërisë civile, është një përpjekje e tillë, që synon ata, që janë duke përfunduar shkollën e mesme. Nxënësit më të rinj mund të caktohen për të shërbyer për një apo dy ditë si “ndihmës” për politikanë vendorë apo aktivistë në parti, shoqata apo lëvizje. Dikush mund madje të imagjinojë një konkurs për politikën dhe historinë mes nxënësve në shkolla të ndryshme, ku fituesit do të kalonin një periudhë të kufizuar kohe si “ministra” apo “sekretarë shteti” zëvendësues pranë qeverive vendore apo kombëtare. Nëse miliona europianë ndjekin Festivalin European të Këngës dhe marrin pjesë në sistemin e tij të çiltër të votimit, pse të mos provohet e njëjta gjë për Festivalin e Politikës Europiane? Dy apo tri tema të debatueshme me rëndësi madhore për Europën si të tërë mund të përzgjidheshin paraprakisht për debat dhe nxënësit mund të përgatishin “përmbledhje” duke argumentuar këndvështrime të ndryshme dhe duke propozuar zgjidhje të ndryshme. “Kampionët kombëtarë” pastaj do të mateshin me njëri-tjetrin drejtpërdrejt në televizion.

12. Roje për të kontrolluar rojet

Qëllimi i ngritjes së agjencive dhe bordeve “roje” është pikërisht për t’i larguar ato nga “politika” dhe për t’u siguruar që ekspertiza e tyre e specializuar mund të vihet në shfrytëzim për të zgjidhur probleme pa ndërhyrjen “e kushtueshme” të mosmarrëveshjeve partiake. Për fat të keq, kjo shërben gjithashtu edhe për t’i shkëputur ata nga rrethet e përgjegjshmërisë demokratike. Fjala e përfaqësuesve të zgjedhur mund të ketë njëfarë peshe në emërimin e tyre fillestar, por pak kontroll përveç interpelancave legislative të çoroditura mbasi ata të kenë marrë postet. Propozojmë që të gjitha institucionet roje – bankat qendrore, shtabet e përgjithshme të ushtrive, agjencitë rregullatore për një gamë të gjerë qëllimesh, të gjitha llojet e bordeve autonome dhe komisioneve publike menaxheriale – të njihen si të tilla dhe t’u caktohet secilit një “roje” i zgjedhur nga komiteti parlamentar më i përshtatshëm në fushën e veprimtarisë së tyre. Ky person do të ishte një anëtar i stafit të përhershëm, i cili paguhet nga parlamenti dhe i përgjigjet këtij, dhe do të kishte të njëjtën të drejtë për informacion dhe prani si anëtar i drejtorisë së institucionit roje. Përgjegjësia e tij apo e saj parësore do të ishte të raportonte në mënyrë të rregullt mbi ecurinë e agjencisë apo bordit përkatës dhe të vlerësonte përputhshmërinë e tij me parimet demokratike – që do të thotë, një lloj personi, që i bie bilbililit dhe ka mundësi të

privilegjuar të shfrytëzimit të dokumenteve dhe diskutimeve të brendshme. Kjo do të shërbente për të forcuar rolin e përgjithshëm të parlamentit brenda sistemit të zakonshëm të kontroleve dhe balancave ndërmjet agjencive.

Një përgjegjësi dytësore potencialisht e rëndësishme do të ishte që të shërbente si një ombudsman i specializuar përballë publikut të gjerë dhe shkëmbimeve të tij me institucionin roje, të cilit ai apo ajo i është bashkëngjitur. Praktikisht të gjitha demokracitë europiane kanë ombudsmenë të përgjithshëm përgjegjës për të dëgjuar ankesat e qytetarëve dhe për të vepruar mbi to. Ata janë bërë një burim i rëndësishëm në ndryshimin dhe përshtatjen e politikëbërjes me nevojat e qytetarëve. Aq e vërtetë është kjo, sa ata shpesh janë të mbingarkuar me një shumëllojshmëri ankesash dhe, për rrjedhojë, vuajnë nga një procedurë e gjatë hetimi. Të pasurit e një numri ombudsmenësh të specializuar, që mbulojnë institucionet roje, jo vetëm që do të ulte barrën mbi ombudsmenët e përgjithshëm, por edhe do të vinte në shfrytëzim dije të specializuara, që duhet ta bëjnë më të lehtë dallimin midis rasteve serioze dhe të zakonshme.

13. Roje të posaçme për rojet e medias

Askush nuk e vë në dyshim që media – shtypi, radio, televizioni dhe, gjithnjë e më shumë, interneti – luajnë një rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin e cilësisë së demokracisë në Europë. Ato ofrojnë shumicën e informacionit, që publiku përdor për të bërë gjykime mbi kandidatë dhe politika; ato kanë prirjen të përcaktojnë axhendën për debatet politike; ato mund të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë të rëndësishëm mbi sjelljen e votuesve. Megjithatë, as teoria dhe as praktika demokratike nuk dinë si ta trajtojnë median në një mënyrë të tillë sa ato të mos shtrembërojnë sistematikisht rezultatin e konkurrencës politike. Në mënyrë të përsëritur thuhet që efekti neto i shtypit, radios, televizionit dhe internetit duhet të jetë “neutral,” “i balancuar” dhe “i drejtë” – por si mund të sigurohesh që të jetë kështu?

Në përgjithësi situata në Europë është relativisht pluraliste “në themel” – krahasuar, për shembull, me atë të Shteteve të Bashkuara. Forma të ndryshme pronësie – publike dhe private – mbizotërojnë dhe zakonisht nuk lejohet një përqëndrim tepër i madh i përqindjes të tregut në duart e një firme apo konsorciumi të vetëm. Stacioneve televizive u kërkohet si kusht për licensimin e tyre, që të ofrojnë kohë falas për kandidatët e partive konkurruese gjatë fushatave zgjedhore. Për më tepër,

shumë vende kanë ngritur agjenci të pavarura rregullatore (“roje”) për të verifikuar që stacionet e radios dhe televizionit i mbulojnë ngjarjet dhe personalitetet politike në mënyrë të barabartë. Ato monitorojnë për t’u siguruar që koha dhe vëmendja kushtuar qeverisë dhe opozitës të mos jetë në shpërpjestim. Disa prej tyre kanë edhe fuqinë për të nxjerrë urdhra të detyrueshme dhe të imponojnë sanksione mbi ata, që shkelin rregullat. Këto janë praktika, që duhen inkurajuar në të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Europës.

Po rregullatorët kush i rregullon? Kush siguron që ata në fakt e bëjnë punën e tyre dhe nuk janë “të kapur” prej atyre, mbi të cilët ata duhet të ushtrojnë kontroll? Është një gjë të përcaktosh në legjislacion që trajtimi i medias duhet të jetë “i drejtë dhe i barabartë,” por diçka krejt tjetër të parandalosh prirjen e natyrshme për të kërkuar zgjerimin e pjesës së tregut duke thjeshtuar, personalizuar, dhe dramatizuar aspektet “spektakolare” të aktiviteteve politike. Agjenci të tilla rregullatore mund të kenë autoritetin të vendosin gjopa apo edhe të imponojnë ndalime gjatë fushatave, por a e kanë ato guximin ta bëjnë këtë kur partia fituese më pas mund, më pas, të shkarkojë zyrtarët e tyre apo t’u japë amnisti?

Jemi të bindur jo vetëm që kompetencat e këtyre agjencive duhen forcuar në mënyrë të tillë që ato të ndërhyjnë me shpejtësi dhe efektshmëri – deri në atë pikë dhe duke përfshirë fuqinë për të revokuar licenca transmetimi të kundravajtësve skandalozë – por edhe që zyrtarët e tyre duhet të nxiten për të vepruar ashtu dhe të jenë të mbrojtur nga kundërndëshkimet. Kjo do të thotë t’i veçosh ata nga raprezaljet qeveritare dhe partiake. Jo vetëm që ata duhen emëruar për mandate të gjata me miratimimn e një supershumice parlamentare, por edhe rinovimi pasues i kontratës së tyre apo largimi nga posti duhet të jetë përgjegjësi e një komisioni të pavarur të mbledhur posaçërisht. Mënyra se si duhen zgjedhur anëtarët e tij është një çështje, që më së miri duhet lënë në duart e çdo sistemi politik kombëtar, por ne do të ishim në favor të përzgjedhjes rastësore nga anëtarë të shoqatave profesionale të përfshira në mediat e ndryshme – aty ku këto ekzistojnë dhe kanë një nivel të konsiderueshëm anëtarësie.

14. Liria e informacionit

Kemi qëndruar larg mbështetjes së të drejtave të reja dhe jemi përqendruar mbi reformat novatore në rregulla dhe institucione. Megjithatë, ekziston një e drejtë themelore, që duket të jetë veçanërisht kyçe me qëllim që të përballen sfidat dhe të rroken shanset e botës së

sotme, që ndryshon me shpejtësi. Rritja në kompleksitet për shkak të ndërvarësive globale dhe rajonale dhe ritmi i mrekullueshëm i ndryshimit teknologjik e kanë bërë informacionin një mall gjithmonë e më të vlefshëm dhe një instrument themelor pushteti. Megjithatë, shpërndarja e tanishme e tij është asimetrike dhe po bëhet më shumë e tillë. Agjencitë e qeverisë dhe korporatat në ekonominë private kanë shumë më shumë mundësi për informacion sesa qytetarët individualë apo organizatat në shoqërinë civile. Për më tepër, ato kanë gjithashtu aftësinë të mbledhin edhe më shumë informacion në mënyrë tinzare mbi po këta individë dhe organizata.

Kjo, nga ana e saj, ndikon në praktikën e demokracisë, meqenëse aftësia për të marrë dhe përpunuar informacion është një përcaktues madhor i mundësisë për të zgjedhur – individuale dhe kolektive. Pa mundësi të barabarta për informacion, qytetari as nuk mund të formojë parapëlqimet e tij apo të saj në mënyrë të saktë, as të vendosë besueshëm se cilën rrugë veprimi të ndjekë. Qytetarët nuk e dinë cilat politika të pranojnë apo të refuzojnë; ata nuk mund të zgjedhin arsyeshëm cilin sundues të mbështesin apo të kundërshtojnë. Negociatat apo, për më tepër, shqyrtimet për përdorimin publik të autoritetit legjitim janë të prekshme nga manipulimi prej atyre, që kanë mundësi të privileguara për informim. Duket e mundshme që prija në rritje e mosbesimit në institucionet demokratike shkaktohet, pjesërisht, nga kultura e fshehtësisë, që priret të rrethojë agjentët e pushtetit publik dhe privat dhe dyshimi, që këta agjentë po shtrembërojnë informacionin për qëllimet e veta.

Një deklaratë formale e lirisë së barabartë për informim duhet të jetë një përbërës i të gjitha demokracive në Europë – qoftë në formën e një specifikimi kushtetues të të drejtave bazë apo si një akt i pavarur legjislativ.

Në parim, kjo liri duhet të jetë e dyanshme: së pari, duhet të garantojë të drejtë të barabartë të të gjithë qytetarëve ndaj burimeve të informacionit, që nevojitet për të formuar parapëlqimet e tyre dhe për të bërë zgjedhjet e tyre; dhe së dyti, duhet t'i detyrojë të gjithë sunduesit të paraqesin publikisht informacionin, që kanë përdorur për të marrë vendimet e tyre dhe që kanë mbledhur mbi qytetarët. Ekzistojnë sigurisht raste, në të cilat një transparencë dhe paraqitje e plotë publike do të rrezikonte sigurinë e sistemit politik, por përgjegjësia e provës për mbajtjen e informacionit ka për të qenë gjithmonë me “pronarin” e saj. Për shembull, të dhënat mbi opinionin publik, sado në mënyrë anonime

që të jenë grumbulluar apo sado privatisht të jenë financiar, duhet t'u vihen në dispozicion të gjithë qytetarëve gjatë fushatave zgjedhore – me përjashtim të ditëve përmbyllëse të fushatës, kur çdo lloj sondazhi duhet të jetë i ndaluar.

Megjithatë, në praktikë zbatimi i efektshëm i kësaj lirie do të kërkonte që të ekzistonte gjerësisht trajnim (i cili do të subvencionohej për ata, që nuk mund ta përballojnë dot) mbi aftësitë teknike të nevojshme për të përpunuar informacion; që pajisjet e nevojshme për të kapur dhe përdorur informacionin të shpërmdaheshin gjerësisht për të gjitha grupet shoqërore ose të ishin të arritshme nëpërmjet kioskave publike; dhe që kostot e shfrytëzimit të mbaheshin sa më të ulëta që të ishte e mundur apo të subvencionohehin me fonde publike.

15. Një dispozitë e “kartonit të verdhë” për legjislaturat

Organeve përfaqësuese në nivelet bashkiake, vendore dhe rajonale duhet t'u jepet pushteti për të lëshuar “kartona të verdhë” – njoftime të drejtpërdrejta paralajmërimi – kur gjykojnë që të drejtat e tyre formale apo privilegjet e tyre informale janë duke u cënuar nga drafte legjislacioni të ardhshme, që vijnë nga një organ i një niveli më të lartë. Kjo do t'u lejonte atyre që të vendosnin në pikëpyetje çënime të tilla pa ndërmarrë hapin më ligjor (dhe më të gjatë dhe të pasigurtë) të apelimit në një gjykatë më të lartë për një gjykim mbi çështjen pasi të jetë marrë një vendim. Për më tepër, përderisa në shumë çështje statusi ligjor i një veprimi të tillë është i paqartë, kjo e drejtë do të theksonte natyrën saktësisht “politike” të këtyre çënimeve ndërnivëlëshe. Kur i nxirret një karton i verdhë organit, që pretendohet se ka kryer kundravajtje, atij do t'i duhej të pezullonte veprime të mëtejshme mbi nismën e tij derisa të kishte paraqitur justifikime shtesë për veprimin e tij, përfshi një deklaratë formale të hierarkisë së pushteteve, që do të shpjegonte pse objektivat e tij nuk mund të përmbusheshin më mirë në një nivel më të ulët të përbërjes politike.

Një nen në projekt-Kushtetutën e BE-së e ilustron këtë mekanizëm. Do t'u jepte parlamenteve kombëtare një rol të drejtpërdrejtë në monitorimin e aplikimit të parimit të hierarkisë së pushteteve. Nëse dhe kur Komisioni nuk arrin të konsultohet gjerësisht, nuk ofron arsye të mjaftueshme për veprimin apo nuk ka demonstruar që një propozim i caktuar e respekton hierarkinë e pushteteve, atëherë do t'i duhej t'u paraqiste kuvendeve, që “nxjerrin kartona të verdhë”, një justifikim të kënaqshëm përpara se të procedonte më tej.

Ndërkohë që perspektiva e mekanizmit të BE-së është e kufizuar në gamën e saj, nuk shohim asnjë arsye se pse nuk mund të zgjerohet për të përfshirë të gjitha projekt-ligjet e ardhshme, që ndikojnë marrëdhëniet ndër-nivelëshe, apo se pse nuk mund të vihet në praktikë në të gjitha nivelet nën-kombëtare dhe supra-kombëtare. Vërtet, ky mekanizëm për paralajmërim të hershëm mund të ishte me vlerë të konsiderueshme për shmangien e padive të panevojshme brenda qeverive kombëtare dhe për ruajtjen e komponentit politik të politikës demokratike nga juridifikimi i skajshëm.

Mund të imagjinohet edhe zgjerimi i këtij mekanizmi të “kartonit të verdhë” në drejtimin e kundërt. Organeve legjislativ të niveleve më të larta mund t’u jepej e drejta të nxirrin paralajmërime të drejtpërdrejta, kur ato besojnë që ato të niveleve më të ulëta janë duke shkelur angazhime të mëparshme, qoftë formale apo informale, kushtetuese apo praktike.

16. Papërputhshmëria e mandateve

Qartësia e marrëdhënies mes niveleve të qeverisë – vendore, rajonale, kombëtare dhe suprakombëtare – përforcohet duke mos u lejuar politikanëve që të mbajnë apo edhe të konkurrojnë (dhe më pas të heqin dorë) për poste të zgjedhura në më shumë se një nivel. Cilatdo që të jenë përfitimet për parti të caktuara politike që të kenë “njerëz të shquar” të vendosur në lista të shumëfishta apo, sipas rastit, të shërbejnë në nivele të shumëfishta, deficitet nga pikëpamja e marrëdhënies të qarta me zgjedhësit e zonës dhe e përgjegjshmërisë në ushtrimin e autoritetit janë shumë më të mëdha. Në të njëjtën linjë me propozimin e mëparshëm jemi të bindur që është e dëshirueshme të hiqen vija të qarta kompetencash, si personale ashtu edhe institucionale, midis institucioneve demokratike. Qytetarët duhet të jenë në gjendje të llogarisin përpara se të hedhin votën e tyre se kush saktësisht do t’i përfaqësojë në secilin organ legjislativ specifik dhe nuk ka pse të mbështeten mbi zinxhirë kompleksë, shumëplanësh të influencave personale me qëllim që të përmbushin qëllimet e tyre politike. Për më tepër, fakti që në mënyrë thaujse të pashmangshme politikanët, që kandidojnë në zona të ndryshme në të njëjtat zgjedhje, më pas heqin dorë nga postet e fituara në nivelet e ulëta

ka prirjen që të minojë statusin dhe legjitimitetin e këtyre kuvendeve vendore dhe rajonale apo agjencive ekzekutive.⁶

17. Legjislacioni kuadër

Aty, ku ekzistojnë nivele të shumëfishta vendimmarrjeje dhe ku secili prej këtyre niveleve ka një shkallë thelbësore autonomie brenda sferës së vet, është gjithsesi e zakonshme që qeveri më përfshirëse – kombëtare dhe suprakombëtare – të miratojnë ligje, që kërkojnë pranimin aktiv të atyre më pak përfshirëse. Për më tepër, siç u vërejt më sipër, ka pasur një prirje për një rrymë në këtë drejtim për shkak të nevojës së pretenduar për përgjigje të gjithanshme dhe të unifikuara ndaj sfidash të tilla si globalizimi dhe pasiguria. Historikisht ka qenë shtysa prej mbrojtjes apo sulmit kombëtar në luftra ndërshtetërore, që justifikonte pjesën më të madhe të këtij ritmi drejt centralizimit. Sot, një situatë e ngjashme duket se po lind nga “Lufta kundër Terrorizmit.”

Cilido qoftë justifikimi i pretenduar për veprime të centralizuara, parimi i hierarkisë së pushteteve do të kërkonte që çfarëdo legjislacioni i tillë të kishte një natyrë “kuadër,” që do të thotë të respektonte sa më shumë që të ishte e mundur autonominë ekzistuese të njësive të niveleve më të ulëta dhe t’ua linte atyre zgjedhjen e metodave dhe zgjidhjeve në përshtatje me rrethanat e tyre specifike. E shumta, vendimi qendror duhet të përcaktonte synimet e përgjithshme, që duhen përmbushur dhe udhëzimet e përgjithshme për veprim, duke ua lënë procesin e zbatimit autoriteteve ekzistuese vendore dhe rajonale.

Format më të shpërndara të autoritetit shtetëror shkatërrohen veçanërisht prej të ashtuquajturave “mandate të pafinancuara,” apo prej kërkesave nga qeveritë qendrore jo vetëm që qeveritë e niveleve më të ulëta të veprojnë në përputhje me norma të pandryshueshme, por edhe që ato ta financojnë këtë zbatim vetë pa ndonjë mbështetje financiare nga lart poshtë. Asnjë demokraci e bazuar mbi qeverinë shumë-nivelëshe nuk duhet të tolerojë mandate të tilla dhe, për aq sa është e mundur dhe në përputhje me objektivin e përgjithshëm të ofrimit të aksesit uniform ndaj të mirave publike, secili nivel duhet të fuqizohet për të ngritur burimet “e veta” të mjaftueshme për të prodhuar të mirat publike, që qytetarët e tij dhe përfaqësuesit e tyre do t’i konsideronin të përshtatshme.

⁶ Një direktivë e paradokohshme e Bashkimit Europian ka deklaruar që mandatet në parlamentet kombëtare dhe në Parlamentin Europian janë të papërputhshme, por nuk i ndalon kandidatët që të kandidojnë në të dyja garat dhe më pas të heqin dorë prej njërës nga mandatet.

18. Buxhetimi me pjesëmarrjen e qytetarëve

Një pjesë e madhe e veprimtarisë nën këtë pikë është frymëzuar nga reformat e prezantuara në nivelin bashkiak në Porto Alegre, në Brazil, më shumë se trembëdhjetë vjet më parë. Përveç përhapjes në qytete të tjera të atij vendi dhe tjetërkund në Amerikën Latine, ka pasur edhe një sërë eksperimentesh me “buxhetimin me pjesëmarrje” në qytete europiane. Formula ndryshon nga një vend në tjetrin, por zakonisht përfshin akordimin e një pjese të buxhetit bashkiak për t’u shpërndarë sipas kategorive të ofrimit të shërbimeve dhe sidomos për projektet e investimeve vendimet merren nga një kuvend qytetarësh në nivelin e lagjeve të veçanta. Në disa raste, këto kuvende të decentralizuara nga ana e tyre përzgjedhin përfaqësues, që takohen në nivelin e bashkisë me qëllim që të përcaktojnë (sëbashku me këshilltarët e zgjedhur rregullisht të qytetit) përparësitë e buxhetit si i tërë. Me fjalë të tjera, ky proces bashkëbisedimi transparent dhe i hapur mes qytetarëve të prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë plotëson, por nuk zëvendëson, kanalet e zakonshme të demokracisë përfaqësuese.

Jemi të bindur që kjo është një reformë demokratike, që ia vlen të ndiqet në Europë, megjithëse do të jetë i nevojshëm një punë e madhe vlerësimi për shumë eksperimente, që janë kryer tashmë, përpara se të vendosen hollësitë e zbatimit të kësaj reforme. Në rastin e Porto Alegre u prezantua nga një parti specifike, *O Partido dos Trabalhadores (PT)*, dhe është mbështetur ekskluzivisht nga forca politike të së Majtës qysh nga ajo kohë. Megjithatë, nuk shohim asnjë arsye se pse një reformë e tillë nuk do të mbështetej nga një gamë më e gjerë partiake në Europë, meqenëse rezultati i saj mund të ishte sa konservator aq dhe përparimtar – në varësi të parapëlqimeve të komunitetit të lagjes së përfshirë. Për më tepër, ekzistojnë probleme të dukshme me pjesëmarrjen faktike të qytetarëve në një reformë të tillë – si për shembull anshmëria e tyre përsa i përket shkollimit dhe statusit shoqëror, manipulimi i tyre nga interesa të organizuara, përkatësia e tyre në parti politike ekzistuese – dhe ekzistojnë pyetje serioze mbi mënyrën se si një aplikim i tillë në mikronivel mund të përshtatet me “sistemin politik shumështrësor” të Europës. Është e qartë që kemi të bëjmë me një masë, që është shumë e ndjeshme ndaj shkallës, në të cilën kryhet dhe nuk mundet thjesht të grumbullohet për lart në nivelin rajonal, kombëtar apo suprakombëtar.

Kjo na bën të mbështesim një reformë, që lidhet me më sipër por është më “e përgjithshme” e që mund të zbatohet praktikisht në të gjitha

nivelet e qeverisë. Po sikur qytetarët të vendosin, të themi me referendum apo një nismë, për shpërndarjen e parapëlqyer të shpenzimeve publike totale sipas nivelit të qeverisë? Le të supozojmë që atyre do t'u ofrohej në një pikë në kohë mundësia për të zgjedhur se sa do të dëshironin të shpenzohej, përpjestimisht dhe brenda kufijve të caktuar, nga qeveritë bashkiake, vendore, rajonale dhe kombëtare. Shmangiet e vazhdueshme mbi ose nën këtë shpërndarje do të duhej të autorizoheshin drejtpërdrejt nga po të njëjtët qytetarë. Është e qartë që do të duhej të përfshihej një farë fleksibiliteti për situata fatkeqësish natyrore apo emergjenca në pasigurinë kombëtare, por në mënyrë të shpjgueshme qytetarët do të vendosnin *grosso modo* se si rritjet apo uljet në të ardhurat e përgjithshme do të duhej të akordoheshin në përputhje me një formulë të parapërcaktuar.

Kini parasysh që kjo nuk do t'u jepte atyre autoritet të drejtpërdrejtë për të vendosur se si këto fonde do të harxhoheshin për shërbime apo projekte investimi konkurruese – kjo është një punë për politikanë, që janë shumë më të familjarizuar me hollësitë e ujdive dhe nevojave relative. As nuk do të përcaktonte mjetet specifike për të gjeneruar të ardhura apo shkallën e transfertave nga një burim tatimi në një tjetër – thjesht shpërndarjen e gjithanshme të shpenzimeve sipas nivelit të qeverisë.

Diçka e ngjashme tashmë ekziston për sa i përket Bashkimit Europian, ku është vendosur një tavan nga qeveritë anëtare të tij mbi përpjestimin e grumbullimit total të TVSH-së në Europë, që BE mund të harxhojë në një vit të caktuar. Duhet pranuar që kjo përcaktohet nga qeveritë kombëtare dhe jo nga bashkësitë e qytetarëve respektivë, por pse të mos praktikohet pothuajse e njëjta gjë përsa u përket zonave të tyre territoriale kombëtare?

19. Një Kuvend Qytetarësh

Ky kuvend do të përbëhej nga një kampion i zgjedhur rastësish i të gjithë bashkësisë së qytetarëve, që kanë moshë të pranueshme d.m.th. janë votues të regjistruar ose të paregjistruar. Numri i tij (fillimisht) duhet të jetë dyfishi i atij të pranishëm në dhomën e ulët të legjislaturës. Përzgjedhja e “Deputetëve Qytetarë” (DQ) do të ishte në përputhje me sistemin ekzistues të zonave në dhomën e ulët, që do të thotë dy DQ do të zgjidheshin në mënyrë rastësore nga çdo zonë – nëse do të ishte një zonë me një anëtar – apo dyfishin e numrit ekzistues të deputetëve – nëse do të ishte një zonë me disa anëtarë. Kuvendi i Qytetarëve duhet konsideruar si

një “komitet i së tërës” fuqizuar nga kuvendi i zgjedhur normalisht për ta ndihmuar atë në shqyrtime legjislativ – me fjalë të tjera, duhet vështruar si një masë për të forcuar, jo dobësuar, legjitimitetin e parlamentit të rregullt.

Secili DQ do të paguhej sa gjysma e një deputeti në dhomën e ulët për një periudhë dy- apo tri-mujore të shërbimit të tij apo të saj qytetar, dhe secilit do t’i caktohej një asistent legjislativ, që do të ishte përgjegjës për të siguruar që ai apo ajo do të marrë të gjithë dokumentacionin përkatës, do t’u përgjigjej kërkesave për informim të mëtejshëm dhe do të ndihmonte në ndërveprimet me publikun.

Ky kuvend do të takohej një herë në vit për një muaj në një mjedis, që mbetet për t’u caktuar, ndoshta edhe në dhomën e ulët të parlamentit kombëtar. Qëllimi i tij unik do të ishte të shqyrtonte dhe të votonte mbi një apo maksimumi dy ligje të miratuara nga parlamenti i rregullt gjatë vitit të mëparshëm, për të cilin të paktën një e treta e deputetëve në dhomën e ulët kanë kërkuar shprehimisht një pezullim të zbatimit.

DQ-të e ardhshëm duhen zgjedhur dy muaj përpara takimit të Kuvendit të Qytetarëve. Gjatë kësaj periudhe atyre do t’u jepej dokumentacioni i nevojshëm, përfshi zbardhjen e debateve të mëparshme parlamentare mbi ligjet përkatëse dhe komentet bashkëkohore të shtypit. Ata gjithashtu do të kërkonin çfarëdo informacioni shtesë brenda kufijve të sigurisë kombëtare. As që ka nevojë të thuhet që sistemimet do të duhej të bëheshin të tilla që të siguronin që DQ-të të çliroheshin nga punët e tyre të rregullta gjatë periudhës së shërbimit të tyre qytetar dhe që të garantoheshin se do të mund të ktheheshin në vendet e tyre paraekzistuese të punës pa ndonjë penalitet.

Emrat e atyre, që do të zgjidheshin për të qenë Deputetë të ardhshëm të Qytetarëve do të bëheshin publikë dhe qytetarët do të nxiteshin t’i kontaktonin – nëpërmjet asistentëve ligjorë përkatës. Në dispozicion të të gjithë DQ-ve duhen vënë mjete të përshtatshme komunikimi, si për shembull, kompjutera të lidhur online, mjete fotokopjimi, privilegje për të postuar pa pagesë dhe duhen bërë rregullime të posaçme, të tilla si ngritja e faqeve të internetit për ta bërë të lehtë kontaktimin e tyre dhe për të ruajtur privatësinë e tyre.

DQ-të, që aktualisht marrin pjesë në kuvend, duhet të zgjidhen në fund të një periudhe fillestare dymujore me short me monedhë mes dy DQ-ve të përzgjedhur nga çdo zonë me një anëtar dhe mes dy çifteve të DQ-ve nga zonat me disa anëtarë. Në rast sëmundjeje apo pengesash të tjera, “zëvendësues” do të ishte zëvendësi. Këtu qëllimi është që të bëhet

më e vështirë për DQ-të që të ndikohen apo edhe të korruptoheshin nga ndikime të jashtme, meqenëse identiteti i atyre, që marrin pjesë në kuvend nuk do të merrej vesh deri në minutën e fundit.

Pas diskutimeve të rastit, Kuvendi i Qytetarëve do të votonte mbi secilin prej ligjeve paraqitur atij. Vetëm ato projektligje, që marrin një shumicë të thjeshtë votash, do të miratoheshin. Asnjë legjislacion i refuzuar nga kuvendi nuk mund të bëhet ligj i vendit. Nëse legjislatura e rregullt nuk arriti të caktonte ndonjë ligj për kuvendin, ky gjithsesi do të takohej për të shqyrtuar prodhimin e vitit në ligje dhe do të nxirrte një deklaratë mbi cilësinë e tyre me votë shumice, ku pakicat do të shprehnin pakënaqësitë e tyre, nëse do të ishte e nevojshme. Në sistemet politike, që tashmë kanë dispozita për referendume apo nisma, Kuvendi i Qytetarëve mund t'i zëvendësonte sisteme të tilla – me kosto më të ulët dhe me shikueshmëri më të madhe, si dhe me më shumë shanse për diskutim.

20. Pragje të ndryshueshme për zgjedhje

Diskutuam propozimin aktualisht në modë për reformë demokratike në Shtetet e Bashkuara në lidhje me “kufijtë e mandateve” për përfaqësues të zgjedhur dhe konkluduar që ato nuk ishin të dëshirueshme. Politika bashkëkohore kërkon ekspertizë profesionale, që mund të sigurohet vetëm gjatë disa mandateve. Përndryshe, përfaqësues amatorë dhe *pro tempore* mund të manipuloheshin tepër lehtë nga interesa të fuqishme e të pajisura mirë me stafe. Për më tepër, partitë politike më të disiplinuar të Europës mund të minoheshin, kur numra të mëdhenj të kandidatëve të tyre pa të ardhme afatgjatë si përfaqësues të zgjedhur mund të tundohen të votojnë në mënyra të çrregullta dhe “të veçanta.”

Megjithatë, ajo, që mund të ishte tërheqëse, si një kundërpeshë kundrejt “ligjit të hekurt të oligarkisë” (sipas të cilit sa më gjatë një politikan të qëndrojë në post, aq më shumë ai apo ajo tenton të grumbullojë burime të të qenit në post dhe bëhet e vështirë ta largosh nga posti me mjete zgjedhore), do të ishte një sistem pragjesh të lëvizshme. Postmbajtësit, pasi të kenë shërbyer dy mandate, do të kishin ende të drejtë të rizgjidheshin, por do t'u duhej të fitonin një pjesë më të lartë të votave me qëllim që të mbeteshin në post. Për shembull, nëse në zgjedhjet e fundit ai apo ajo kishte fituar me 55%, në zgjedhjet e tjera pragu do rritej me 2.5% ose deri në 57.5% - duke përdorur të njëjtën përqindje rritjeje për çdo zgjedhje pasuese. I njëjti sistem mund të aplikohet në sistemet proporcionale të përfaqësimit, qoftë në lidhje me vendosjen në listë të kandidatit, që mban aktualisht postin ose në lidhje me numrin e

votave të kërkuara për të arritur kuotën. Qytetarët e kënaqur me përfaqësuesit e tyre do të vazhdonin t'i rizgjidhnin ata për aq gjatë sa të dëshironin – por vetëm me kusht që gjithnjë e më shumë prej tyre ta shprehnin miratimin e tyre në zgjedhjet pasuese.

21. Demokracia partiake

Të gjithë studentët e demokracisë bien në një mendje që është e dëshirueshme që vetë partitë politike të jenë demokratike në funksionimin e tyre të brendshëm. Shumica e të njëjtëve studentë, gjithashtu, do të binin në një mendje që një kusht i tillë nuk mund të “legjislohet” – aq më pak, nga ndonjë paketë normash detyruese kombëtare apo supra-kombëtare. Pikërisht nga natyra e tyre, partitë përfaqësojnë “pjesë të sistemit politik dhe shoqërisë” dhe, për rrjedhojë, duhet të kenë autonominë të vendosin se cilët njerëz duan të kenë për anëtarë dhe se si duan ta qeverisin vetveten. Në konkurrimin me njëri-tjetrin ata mund të detyrohen të zgjerojnë programet e tyre përkatëse me qëllim që të jenë tërheqës për votues jashtë anëtarësisë së tyre thelbësore, madje edhe mund të shtrengohen të zhvillojnë një lloj *simulacre* të një procesi demokratik, por shpesh tregojnë pak entuziazëm për të rekrutuar anëtarë të rinj apo për të zhvilluar zgjedhje të brendshme të mirëfillta konkurruese, nëse kjo përbën kërcënim ndaj modeleve të përcaktuara të lidershit. Ato gjithashtu mund të tregojnë pak ose aspak interes për të rritur pjesëmarrjen në zgjedhje, nëse votuesit shtesë nuk do të ishin në mënyrë të manifestueshme me përfitim për kandidatët e tyre.

Kështu, partitë janë një përbërës i nevojshëm i demokracisë liberale sikurse praktikohet aktualisht, por mund të përbëjnë edhe një pengesë për legjitimitetin e saj dhe, sigurisht, për reformimin e institucioneve dhe praktikave të saj. Përgjigja ndaj këtij paradoksi nuk mund të shihet askund më qartë sesa në rënien e vazhdueshme të besimit publik në to. Siç e kemi parë, përgjigja nuk mund të gjendet në detyrimin e tyre për t'u sjellë në mënyrë më demokratike; mund të gjendet vetëm në shpërblimin e tyre kur e bëjnë këtë. Mund të imagjinohet që t'u jepej akses i lirë në media për të përcjellë në publik proceset e tyre të brendshme demokratike – zgjedhjet, seancat dëgjimore, dialogjet publike e kështu me radhë – por kjo supozon që qytetarët të dëshirojnë të dëgjojnë, shikojnë, apo lexojnë mbi aktivitetet e tilla.

Një alternativë mund të ishte heqja mënjanë e një pjese të fondeve publike të parashikuara për të mbështetur partitë politike për t'u shpërndarë për ato parti politike, që zhvillojnë zgjedhje të brendshme

konkurruese për emërimin e kandidatëve apo përcaktojnë forume të rregullta për diskutimin e çështjeve me publikun e gjerë. Ndërsa përsa i përket shpërblimit të tyre për nxitjen e pjesëmarrjes së votuesve, kjo mund të ndihmohej nëpërmjet sistemit të kuponave për financimin e partive (Nr. 23), meqenëse ata, që në fakt votojnë, mund t'i shpërndanin këto kupona.

22. Kuponat për financimin e organizatave në shoqërinë civile

Të gjitha demokracitë liberale, në të cilat anëtarësia dhe mbështetja financiare e shoqatave dhe lëvizjeve është vullnetare, vuajnë nga nën- dhe mbi-përfaqësimi sistematik. Për ta thënë troç, ato grupe të vogla, kompakte dhe të privilegjuara, që kanë më pak nevojë për përfaqësim kolektiv marrin pjesën më të madhe. Ato grupe të mëdha, të papërqendruara dhe të nënprivilegjuara, që kanë më shumë nevojë për të mirat publike, që vetëm një aksion i fortë dhe i mirëfinancuar kolektiv mund t'i sigurojë, marrin shumë më pak. Siç e ka thënë politologu gjermano-amerikan E. E. Shatshnajder (Schattschneider), “problemi me korin e grupeve të interesit është që ai këndon me theksin e klasës së epërme” dhe Europa nuk bën aspak përjashtim – pavarësisht nga niveli apo vendndodhja.

Propozimi ynë është të sigurohet një burim financimi alternativ për organizatat e shoqërisë civile. Koj mund të arrihej në një mënyrë demokratike nëpërmjet tri masave të lidhura ngushtë mes tyre: së pari, vendosja e një statusi *gjysmë-publik* për shoqatat dhe lëvizjet shoqërore të interesit; së dyti, financimi i këtyre shoqatave përmes kontributeve të detyrueshme; dhe së treti, shpërndarja e këtyre fondeve me anë të kuponave të qytetarëve.

Kjo reformë në mënyrën se si financiohen organizatat e shoqërisë civile do të shmangte qëllimisht specifikimin nga autoritetet politike të çfarëdo kategorie të fiksuar përfaqësimi bazuar mbi klasën, statusin, sektorin, profesionin, apo kauzën – ndryshe nga sistemet bashkëkohore të dhomave apo sistemet korporatiste. Kështu, konkurrenca për kuponat e qytetarëve individë do të vendoste për financimin e organizatave. Në shumë raste, reforma do të ishte pa kosto – me kusht që qeveritë të detyroheshin të eliminonin të gjitha subvencionet ekzistuese, që shpërndahen nga agjencitë administrative, dhe të lejonin qytetarët të zgjidhnin se cilat shoqata dhe lëvizje meritojnë mbështetje financiare.

Qëllimi kryesor mbas zhvillimit të një statusi gjysmë-publik për shoqatat dhe lëvizjet është që ato të nxiten të bëhen “qytetarë” më të

mirë, pra, ta trajtojnë njëri-tjetrin mbi bazë barazie dhe respekti të ndërsjellë më të madh, dhe t'u kushtojnë vëmendje më të madhe interesave dhe pasioneve të publikut si i tërë. Kjo do të përfshinte asgjë më pak se një përpjekje për të vendosur një kartë të drejtash dhe detyrimesh për organizatat e shoqërisë civile. Do të ishte naive të supozohej se thjesht imponimi i rregullave të caktuara do t'i bënte ata *eo ipso* aktorë, që “respektojnë faktet, respektojnë të tjerët dhe respektojnë të ardhmen” më shumë. Legjislacioni i shumicës së demokracive kombëtare është i mbushur me përpjekje të pasuksesshme për të vendosur rregulla mbi lobet dhe grupet e presionit. Ajo, që është e dallueshme në këtë përjasje, është lidhja e respektimit të kushteve të caktuara të vetëorganizimit dhe menaxhimit me nxitje shumë konkrete për mbështetje dhe një proces konkurrues për caktimin e fondeve.

Ky rekomandim për reformë mbështetet tërësisht mbi nevojën për të zhvilluar një metodë të re për financimin e shoqërisë civile, që është e pavarur nga aftësitë dhe vullneti i qytetarëve individë për të paguar – që do të thotë nxjerrje parash në mënyrë të pavullnetshme nga të gjithë ata, që në fund të fundit do të përfitojnë. Kontributi duhet mbledhur në mënyrë të barabartë nga të gjithë personat, që banojnë në një territor të caktuar. Personat, që do të dëshironin, gjithashtu mund të kontribuonin vullnetarisht për kauza të ndryshme, por kjo nuk do t'i përjashtonte ata nga “dhurimi përfaqësues” i përgjithshëm. Mbani parasysht që, duke toleruar një liri të tillë, “grupet e privileguara” të vogla dhe kompakte prapëseprapë do të kishin më shumë gjasa për të tërhequr burime të shpërpjestuara, meqenëse anëtarët e tyre do të vazhdonin të kishin nxitje më të mëdha për të dhënë vullnetarisht, përveç detyrimit të përgjithshëm. Gjithsesi, duke patur parasysht numrat e mëdhenj, për të cilët bëhet fjalë, do të kishte gjasa për një harmonizim shumë të konsiderueshëm të burimeve nëpër të gjitha kategoritë e interesit dhe kauzat e pasionit.

Mënyra më praktike për ta bërë këtë do të ishte që ky detyrim (dhe sistemi i kuponave) t'i bashkëngjitej skedimit vjetor të taksës mbi të ardhurat personale – të paktën në ato vende, ku praktikisht të gjithë banorëve u kërkohet të skedojnë, në mos të paguajnë taksa të tilla. Në të vërtetë, në interes të barazisë, ata, që janë të përjashtuar nga taksat për shkak të të ardhurave të ulëta, duhen përjashtuar nga detyrimi për përfaqësimin, por prapëseprapë do të fuqizoheshin të shpërndanin kupona, që do të llogariteshin për të vendosur se cilat shoqata specifike do të merrnin para nga fondi i përbashkët. E rëndësishme është të ruhet niveli i ulët i pagesave individuale – le të themi, 100 për person – me

qëllim që të mos trembeshin mbështetësit potencialë të reformës, por që niveli tërësor i burimeve të ofruara të bëhet i mjaftueshëm për të kompensuar pabarazitë e vazhdueshme mes interesave. Gjithashtu, do të ishte thelbësore që publiku të bindej që një rregullim i tillë do të përbente një zgjerim të rëndësishëm të të drejtave demokratike – analog me zgjerimin e mëparshëm të së drejtës për të votuar.

Gjithë këtë skemë e mban të lidhur mekanizmi i kuponave. Këto njësi llogarish të përcaktuara posaçërisht e të patransferueshme mund t'u jepen vetëm atyre shoqatave të interesave dhe lëvizjeve shoqërore me një status gjysmë-publik, në përpjestimin e përcaktuar nga qytetarët individë. E vetmja “kosto”, që përfshihet në shpenzimin e tyre, do të ishte koha dhe përpjekja e individit për t'u njohur me përfituesit alternativë, plus koha e nevojshme për të shënuar kutitë apo mbushur hapësirat e lëna bosh (në formularë).

Kuponat kanë shumë veçori tërheqëse, që do të ishin në të mirë të përfaqësimit të specializuar. Ato do të lejonin një shprehje relativisht të lirë të shumësisë së parapëlqimeve të çdo qytetari – në vend që ta kufizonin atë në një listë njëpartiake apo me një kandidat, sikurse ndodh me shumicën e sistemeve të votimit, që bazohen mbi territoret gjeografike. Ato, gjithashtu, do të lejonin një zgjidhje të lehtë të “problemit të intensitetit”, që prej kohësh e ka bezdisur teorinë demokratike, meqenëse shpërndarja e tyre proporcionale nga individë nëpër shoqata do të pasqyronte sesa fort kujdeset qytetaria “vërtet” për interesa dhe pasione të ndryshme. Ato barazojnë sasinë e paguar nga çdo person dhe, në këtë mënyrë, prishin vendimin për të kontribuar nga kontrolli i pabarabartë mbi burimet, kontrolli i cili pashmangshmërisht buron nga shpërndarja e pabarabartë e pronës dhe pasurisë. Ato nuk ofrojnë asnjë motiv racional për shpërdorim apo korrupsion, meqenëse nuk mund të ofrojnë një përfitim të drejtpërdrejtë apo të preکشëm për dhuruesin dhe mund të harxhohen vetëm nga shoqata të certifikuara për qëllime të përcaktuara publike. Për më tepër, ato duhet të ofrojnë një shtysë shumë të rëndësishme për të reflektuar mbi natyrën e interesave të dikujt duke nxitur kështu hapjen e një hapësire publike. Meqenëse do të përsëriteshin me kalimin e kohës, shpërndarja e këtyre kuponave do të paraqiste një shans praktikisht unik për të vlerësuar pasojat e zgjedhjeve të bëra në të kaluarën nga dikush.

Për rrjedhojë, kuponat do të bëheshin një mekanizëm i fuqishëm për të vënë në zbatim përgjegjshmërinë e shoqatave dhe lëvizjeve ekzistuese, meqenëse, nëse sjellja e drejtuesve të tyre ndryshon tepër

dukshëm nga parapëlqimet e atyre, që harxhojnë kuponat e tyre për ta, qytetarët ka të ngjarë të mund t'i transferonin kuponat e tyre tjetërkund. Ato gjithashtu do ta bënëin relativisht të lehtë për të zbuluar grupe, që më parë kanë qenë të heshtura dhe nuk kanë mundur të kapërcejnë pragun organizativ fillestar, në vend që të përdorëshin kupona për të shkuar sa para mbrapa mes konceptimeve ekzistuese rivale të interesave të dikujt. Dhe së fundi, kuponat ofrojnë një mjet për të zgjeruar parimin e qytetarisë dhe thelbin konkurrues të demokracisë në një mënyrë që as nuk vendos kërkesa imediate dhe të forta mbi individët e as nuk kërcënon drejtpërdrejt pozitat e ngulitura të elitave.

Për të marrë hua (por në të kundërt) një parrullë nga një luftë e mëparshme për demokraci, mund të thuhet se ajo, që mbështesim është “S’ka Përfaqësim Pa Tatim!”

23. Kuponat për financimin e partive politike

Financimi i partive politike është një çështje delikate. Në shumicën e sistemeve politike partitë politike janë të prirura të jenë kronikisht të nënfinancuara dhe, për rrjedhojë, kërkojnë të sigurojnë fonde në mënyra të dyshimta, jotransparente, që rrezikojnë të perceptohen si të korruptuara. Akuza për korrupsion, që sillet përreth financimeve të tyre, përforcon imazhin popullor negativ për partitë politike duke krijuar një rreth vicioz, që bën që qytetarët normalë të kenë më pak gjasa të kontribuojnë vullnetarisht në mbështetje të tyre dhe minon jo vetëm prestigjin e institucioneve demokratike dhe politikanëve, por edhe besimin e publikut në to. Për pasojë, partitë politike nuk ndjejnë se kanë legjitimitet të mjaftueshëm popullor për të kërkuar më shumë mbështetje financiare nga buxheti publik. Kjo i mban ato në një zonë të përhershme gri, në kufirin midis mjeteve të ligjshme dhe të jashtëligjshme për financimin e veprimtarive të tyre.

Një zgjidhje për këtë problem mund të ishte një sistem kuponash për qëllimin specifik të shpërndarjes së fondeve publike tek partitë. Kur njerëzit votojnë në zgjedhje të përgjithshme, ata gjithashtu do të mund të votonin një “herë të dytë,” pra, të votonin për shpërndarjen e një shume të përcaktuar për partinë apo partitë, që do të zgjidhnin vetë. Me qëllim që të mos rrezikohet një ndikim fillestar tepër i madh, vetëm 50% e financimit publik total për partitë do të shpërndahej me këtë mënyrë. Pjesa tjetër prej 50% do të vendosej nga rezultatet proporcionale në zgjedhjet e mëparshme – siç ka prirjen të jetë praktika sot. Sipas rastit, ky paracaktim mund të lihej mënjanë dhe të gjitha këto fonde të

shpërndaheshin drejtpërdrejt nga qytetarët – pavarësisht se sa mirë mund të kishin dalë partitë në zgjedhjet e mëparshme. Megjithatë, e rëndësishme është që shuma totale për t'u shpërndarë duhet të jetë më e lartë sesa është aktualisht dhe boll e mjaftueshme për të mos u kapërcyer nga përpjekjet e partive individuale për të nxjerrë mjete financiare nga burime private. Ka të ngjarë që nëse qytetarët binden që ata vetë përcaktojnë se cila parti do të shpërblehet me paratë e tyre të taksave, ata do të kenë vullnetin t'i kushtojnë më shumë burime këtij qëllimi.

Duhet shënuar gjithashtu që vota e dytë do të ishte e pavarur nga votimi i tyre për partitë politike apo kandidatët e tyre në ato zgjedhje. Qytetarët do të vendosnin të ndanin kuponin e tyre për parti të ndryshme apo t'ia caktonin atë një partie jo të madhe, që nuk kishte perspektivë të afërt për të fituar. Në versionin më ekstrem të kësaj mase për reformë votuesit mund edhe të zgjidhnin të shpërblenin “asnjë nga këto,” pra, të mbanin mbështetjen e tyre financiare larg të gjitha partive ekzistuese. Fonde të tilla mund të grumbulloheshin nga njëra fushatë zgjedhore në tjetrën dhe grupe qytetarësh me një numër minimal firmash të shpërndara në një numër zonash zgjedhore mund të kishin të drejtë t'i përdornin paratë për të financuar parti të reja.

E pritshme do të ishte që në shumicën e rasteve votuesi të mbështeste partinë e tij apo të saj të parapëlqyer, si nga pikëpamja e votimeve ashtu dhe e financimeve. Megjithëkëtë, mund të supozojmë, gjithashtu, që një numër domethënës mund t'i ndanin votat e tyre. Së pari, ata do të mbështesnin një parti, që parapëlqejnë më shumë në garën zgjedhore, por së dyti, mund të investojnë në një parti tjetër, që do të donin ta shihnin me më shumë ndikim në të ardhmen. Kjo do të përforconte përllogaritjet strategjike të votuesve (dhe mund ta bënte votimin më argëtues) si dhe duhet të ndihmojë partitë më të vogla të organizohen në mënyrë më konkurruese. Një ndikim tjetër i dëshirueshëm i një reforme të tillë do të ishte nxitja e të gjitha partive, të mëdha dhe të vogla, të bënin fushatë energjikisht për një dalje më të madhe në votime meqenëse vetëm kuponat e shpërndarë nga votuesit faktikë do të gjeneronin të ardhura për to.

24. Referendumet dhe nismat

Prirja e përgjithshme drejt pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset vendimmarrëse në të gjitha nivelet duhet mbështetur nga Këshilli i Europës. Si referendumi qeveritar, ashtu edhe nisma popullore janë mjete unike, që i lejojnë qytetarët t'u kërkojnë

llogari përfaqësuesve dhe sunduesve të tyre. Ato gjithashtu kanë prirjen të rrisin interesin dhe ekspertizën e qytetarëve në çështje politike dhe, për rrjedhojë, të plotësojnë përpjekje të tjera për reformë, që synojnë të përmirësojnë nivelin e kompetencës qytetarë në politikë. Së fundi, mekanizma të tilla duhet të përforcojnë legjitimitetin demokratik të vendimeve politike.

Rekomandojmë që institucionet e demokracisë së drejtpërdrejtë t'i shtohen totalit të mekanizmave përfaqësuese demokratike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke përfshirë edhe nivelin supra-kombëtar apo evropian, ku niveli vendor do të ofronte pikënisjen më të përshtatshme për procese eksperimentimi dhe vlerësimi në ato sisteme politike, që nuk janë duke i përdorur ato tashmë. Bashkimi Europian duhet inkurajuar të shkojë përtej të drejtës për peticion propozuar në projekt-Kushtetutën e tij dhe të prezantojë si një nismë europiane ashtu edhe një referendum evropian. Në sistemet politike, ku mekanizma të tillë janë ende të panjohur, përparësi i duhet dhënë kërkesës për të miratuar amendamente kushtetuese dhe për të ratifikuar traktate ndërkombëtare me rëndësi madhore nga të gjithë qytetarët. Ndërkohë që nuk ekziston ndonjë tip ideal i institucionit demokratik, ne rekomandojmë që si referendumet, ashtu edhe nismat të jenë detyruese në vend që të jenë këshilluese. Kjo garanton elektoratin që vendimet e tij do të zbatohen dhe kjo, nga ana tjetër, mund të nxisë një pjesëmarrje më të madhe të votuesve në votime. Këshillojmë kundër përdorimit të kuorumeve me arsyen që vendimet kolektive të qytetarëve duhet të prodhojnë ndikime në politika pavarësisht nga nivelet e pjesëmarrjes në votime. Në sistemet federale, si edhe në Bashkimin Europian, sugjerojmë një skemë të tipit zviceran bazuar mbi një shumicë dyfishë – një të bazuar mbi kriterin numerik dhe tjetrën të bazuar mbi kriterin negociues, që është i ndjeshëm ndaj variacionit në përmasat e njësive pjesëtare. Si hartimi, ashtu edhe miratimi eventual i konsultimeve popullore duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor nga gjykatat kushtetuese kombëtare dhe, në rast të referendumeve eventuale të BE-së, nga Gjykata Europiane e Drejtësisë.

Në mënyrë të ngjashme me *Kodin për praktikë të mirë në çështje zgjedhore* të Komisionit të Venecias, ne rekomandojmë që Këshilli i Europës të hartojë një udhëzues mbi referendumet dhe nismat. Një kod i praktikave të mira i këtij lloji do të ishte i dobishëm si për kryerjen e konsultimeve popullore, ashtu edhe për vlerësimin e tyre të mëvonshëm.

25. Mbështetje elektronike për kandidatët dhe parlamentet (“votimi i zgjuar”)

Rekomandojmë që Këshilli i Europës të mbështesë në mënyrë aktive përpjekjet për të zhvilluar sisteme elektronike të mbështetjes, të cilat do t’u ofronin qytetarëve – në lidhje me votimin online apo votimin elektronik (shih më poshtë) – burime të reja informacioni të ndërtuara për të përmirësuar cilësinë, në mos po edhe sasinë, e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje në të gjitha nivelet e qeverisë. Në thelb të këtij rekomandimi qëndron një paketë rregullimesh teknologjike, që do t’u lejonte qytetarëve të përputhnin opinionet e tyre politike me ato të partive dhe kandidatëve specifikë gjatë fushatave zgjedhore, si edhe eventualisht të përfshiheshin në bashkëbisedimin elektronik me po këto parti dhe këta kandidatë.

Këto teknologji të “votimit të zgjuar” tashmë ekzistojnë në disa shtete anëtare të Këshillit të Europës, megjithëse ato nuk janë të përdorura gjerësisht. Ato inkurajojnë të gjithë kandidatët që të mbushin një pyetësor online, që përmban një paketë të gjerë pyetjesh mbi politikën. Kandidatët do t’u përgjigjeshin pyetjeve të tilla si: “A jeni në mbështetje të licensimit të uzinave të energjisë atomike?” duke klikuar zgjedhjen e parapëlqyer (“shumë në mbështetje”, “mjaft në mbështetje”, “mjaft kundër”, “shumë kundër”, “i paanshëm” apo “i pavendosur”). Gjithashtu, kandidatët do të ishin në gjendje t’i jepnin peshë zgjedhjes së parapëlqyer (“rëndësi e lartë”, “rëndësi e mesme”, “e parëndësishme”). Pyetëtori do të ndërtohej nga një komision zyrtar jopartiak, që pas seancave dëgjimore me organizata të shoqërisë civile dhe ekspertë akademikë do të vendoste se cilat pyetje të përfshinte dhe çfarë formati të përdorte.

Paskëtaj, qytetarët do të ishin në gjendje ta plotësonin të njëjtin formular online dhe pa asnjë kosto, ose në versionin e tij të plotë ose në një më të shkurtër, që ka nevojë për më pak kohë për t’u plotësuar. Atyre do t’u jepej në çast një përmasë relative e parapëlqimit të tyre mbi çështje të caktuara, që shqetësojnë publikun, e krahasuar kjo me qytetarë të tjerë, që kanë plotësuar pyetësorët si dhe një shpërndarjen e përgjigjeve të kandidatëve. Praktakisht ata mund të zbulonin në çast se cilët kandidatë dhe cilat parti kanë parapëlqime të ngjashme me ato të tyre. Ata gjithashtu mund të zgjidhnin ta plotësonin pyetësorin në mënyrë anonime apo të regjistroheshin si “votues të zgjuar”, në mënyrë që profili i tyre politik të regjistrohej jo vetëm për t’iu referuar personalisht në të ardhmen, por edhe për t’u vënë në dispozicion kandidatëve dhe partive si një alternativë ndaj sondazheve të opinionit publik. Kjo do të ishte

analoge me profilet personale të klientëve përdorur në teknologjitë e veprimeve bankare online, madje mund të bëheshin edhe një burim i rëndësishëm ndërveprimi të plotdijshëm mes përfaqësuesve dhe qytetarëve. Politikanët apo partitë mundën madje të përdornin sistemin (vullnetar) të regjistrimit si një mënyrë për të kontaktuar apo rekrutuar qytetarë “mbështetës” gjatë zgjedhjeve të ardhshme.

Pas skedimit të pyetësorit online të qytetarëve sistemi do të përputhte automatikisht parapëlqimet e tij apo të saj me të dhënat, që vijnë nga të gjithë kandidatët me qëllim që të prodhohej një “fletëvotim thelbësor virtual”, që i radhiste ato sipas mbivendosjes proporcionale midis përgjigjeve të kandidatëve dhe atyre të qytetarëve. Është e qartë që sa më shumë pyetje të kenë marrë përgjigje nga qytetarët, aq më të hollësishme dhe të sakta do të jenë profilet e tyre. Duke klikuar tek emrat e kandidatëve, qytetarët gjithashtu do të merrnin informacion të hollësishëm mbi përkatësinë e tyre partiake, profilin politik, numrin e votave të mëparshme (nëse është kandidat, që mban aktualisht postin), lidhjet me faqen e tyre personale në internet, e-mail dhe informacion tjetër kontakti. Kandidatët mund t’u ofronin qytetarëve votues të zgjuar justifikime të hollësishme për zgjedhjet e tyre për çdo çështje në pyetësor me qëllim që të shpjegojnë se pse bëheshin ujdi dhe kompromise.

Fletëvotimi virtual i plotësuar nga serveri i “votuesve të zgjuar” do të mund edhe të printohej për t’u përdorur në qendrën e votimit, veçanërisht në ato raste të sistemeve me lista të hapura, që lejojnë votuesin të regjistrojë parapëlqimin për kandidatët individualë. Në të ardhmen, nëse votimi elektronik përhapet gjerësisht, një version elektronik i “fletëvotimit të vlefshëm virtual” mund të plotësohej drejtpërdrejt në internet.

26. Sisteme të monitorimit elektronik dhe bashkëbisedimit online

Ne periudhën midis zgjedhjeve, duhet të ngrihen platforma elektronike online për të monitoruar dhe krijuar një hartë të votave të të gjitha organeve përfaqësuese për çështje të caktuara. Duke pasur mundësi hyrjeje në këtë platformë, qytetarët do të ishin në gjendje që të vlerësonin vazhdimisht sjelljen politike të përfaqësuesve të tyre gjatë mandateve të këtyre. Për çdo votim në Parlament, çdo votë do të futej menjëherë në një bazë të dhënash online, që do të gjeneronte një profil objektiv të të gjitha zgjedhjeve, që do të kishin bërë të gjithë deputetët gjatë votimeve. E njëjta gjë do të bëhej për të gjitha organet përfaqësuese të niveleve më të ulëta. Për rrjedhojë, votuesit do të merrnin informacion të hollësishëm mbi

veprimtarinë politike të përfaqësuesve të tyre lehtësisht dhe praktikisht pa asnjë kosto.

Një sistem i ngjashëm ekziston tashmë në shumë shtete anëtare, por ofrohet nga organizata në shoqëritë civile përkatëse, që gjenerojnë grafikë për të gjykuar masën, në të cilën përfaqësuesit u përmbahen standardeve të mbrojtjes së mjedisit, feminizmit, liberalizmit e kështu me radhë. Këto mund të jenë mjaft të dobishme, por mund edhe të jenë të manipulueshme, meqenëse qytetari-konsumator mund të mos jetë i njohur me kriteret e përdorura në radhitjen e votave për projektligje të veçanta. Reforma, që propozojmë e bën një gjë të tillë transparente dhe i lejon individit lirinë për të vendosur vetë sistemin e tij të përparësive dhe temat e rëndësishme.

Gjithashtu, qytetarët mund të aftësoheshin të simulojnë online votat, që mund të kenë hedhur mbi projektligje të kaluara, sikur të kishin qenë vetë përfaqësues të zgjedhur. Qëllimi këtu do të ishte të prodhohej një profil virtual, që do t'u përshtatej kombinimit individual të interesave dhe pasioneve të qytetarit. Paskëtaj, profili votues “virtual” i simuluar i personit mund të krahasohej me profilet e gjeneruara nga përfaqësuesit “realë”, duke u dhënë votuesve edhe një tjetër mundësi për të vlerësuar kandidatët në zgjedhje, që aktualisht mbajnë poste. Teknika e përputhjes do të ishte analoge me atë, që përdoret nga teknologjia e “votimit të zgjuar” diskutuar më sipër në propozimin Nr. 25. Kandidatët, që konkurrojnë për herë të parë në zgjedhje vendore, provinciale apo kombëtare duhen ftuar të plotësojnë një prej këtyre profileve virtuale dhe t'u jepet mundësia të japin argumente të hollësishme për zgjedhjet e tyre reale apo virtuale në lidhje me çështje specifike.

Gjithashtu, mund të zhvillohen dhe të vihen gjerësisht në dispozicion mjete online, të cilat do të nxisnin diskutimin politik midis qytetarëve – dhe jo thjesht midis tyre dhe përfaqësuesve të tyre. Sigurisht, të ashtu-quajturat dhoma e bisedimit, *chat rooms*, tashmë ekzistojnë me shumicë për një gamë të pafund çështjesh. Kontributi i mjeteve të këtij lloji të promovuara publikisht do të ndihmonte gjerësisht për të sistematizuar dhe publikuar ekzistencën e tyre, për t'i lidhur ato me përfaqësuesit në të gjitha nivelet dhe, ndoshta me anë të “kioskave të demokracisë”, për të nxitur dhe barazuar aksesin ndaj formave të tilla të diskutimit. Ekzistojnë, gjithashtu, edhe një një numër çështjesh delikate politike dhe etike, që kanë të bëjnë me monitorimin e faqeve të tilla në internet. Këtu, edhe një herë, është një mundësi për Këshillin e Europës

që të hetojë “praktikat e mira” mes shteteve të tij anëtare dhe të publikojë standardet përkatëse.

27. Votimi me postë dhe votimi elektronik

Në një raport të paradokohshëm, Komisioni i Venecias arriti në përfundimin që si votimi në distancë, ashtu edhe ai elektronik janë, në parim, në përputhje me standardet e demokracisë në Europë. Ne besojmë që Këshilli i Europës duhet të nxisë futjen e praktikës së votimit në distancë – qoftë me postë, në mënyrë elektronike, apo që të dyja format – në zgjedhje dhe referendume. Derisa mjetet për votim në distancë pranohen universalisht, ato duhen prezantuar si kanale *suplementare* për pjesëmarrje politike. Në përgjithësi do të rekomandonim që votimi me postë të futej në praktikë para votimit elektronik dhe që për një periudhë të ndërmjetme, të gjithë qytetarëve t’u viheshin në dispozicion mjete për votimin në vend dhe në distancë. Përvoja ka treguar që, sapo të ofrohet mundësia për të zgjedhur, votimi në distancë me shpejtësi do të shndërrohet në normë duke e bërë eventualisht më të lehtë kalimin në një politikë të votimit vetëm në distancë.

Procedurat e votimit në distancë përforcojnë dy elemente të procesit të votimit. Së pari, ato janë më të rehatshme dhe, së dyti, u japin qytetarëve më shumë kohë për të bërë zgjedhjen e tij apo të saj. Zakonisht, ekziston një periudhë prej një apo disa javësh, gjatë së cilës votuesit mund të hedhin votën e tyre. Studimet tregojnë që këta dy faktorë kanë prirjen të çojnë në përqindje më të larta pjesëmarrjeje në votime dhe nuk duken se janë në avantazh apo dizavantazh të grupeve specifike të votuesve.

Për analogji të ushtrimit të të drejtave politike në Europë, votimi me postë mund të ndërtohet sipas tri tipeve bazë. Së pari, kërkesa e shumëfishtë, kërkon nga votuesit që të kërkojnë formalisht fletëvotimet, me të cilat do të votojnë përmes postës në çdo raund zgjedhjesh apo konsultim popullor. Sapo t’i kenë marrë, ata i kthejnë mbrapsht fletët e votimit përsëri me postë. Ky lloj votimi me postë duket se përshtatet më së miri me sistemet zgjedhore, që kërkojnë regjistrim të votuesve për çdo raund zgjedhjesh. Në tipin e dytë, kërkesë e vetme, votuesit kanë nevojë të kërkojnë vetëm që fleta e tyre e votimit t’u dërgohet atyre një herë. Qytetarët, pas kësaj – deri në fund të jetës së tyre – do të marrin fletëvotimet automatikisht dhe, për rrjedhojë, mundësinë për të votuar me postë. Ky tip i “votimit me postë me një kërkesë të vetme” është më i përshtatshëm për sistemet, ku votuesve u kërkohet të regjistrohen vetëm

një herë për të gjitha zgjedhjet. Së fundi, lloji i tretë, tërësisht automatik, u referohet sistemeve, ku lista e votuesve prodhohet në bazë të regjistrit të popullsisë dhe/ose të banesave pa patur nevojë për veprime të mëparshme prej qytetarëve. Në këtë rast, të gjitha materialet zgjedhore përkatëse u dërgohen automatikisht të gjithë votuesve, që më pas mund t'i hedhin votat e tyre me postë.

Studimet kanë treguar që versioni plotësisht automatik i votimit me postë prodhon ndikimin më të madh mbi përmirësimin e pjesëmarrjes zgjedhore. Ashtu si me regjistrimin e votuesve, sa më automatik dhe i hapur të jetë sistemi, aq më i volitshëm bëhet votimi dhe aq më e madhe është rritja e pritshme në pjesëmarrje.

Në rastin e votimit elektronik në distancë me internet procedura duhet ngulitur në një faqe interneti të gjerë “virtuale”, që përmban modulet, që do t'u jepnin mundësi qytetarëve të bashkëbisedonin midis tyre përpara se të hidhnin votën e tyre, të kishin akses ndaj informacionit politik të ofruar nga parti dhe kandidatë, por edhe nga shoqatat dhe lëvizjet në shoqërinë civile, të vlerësonin përputhjen midis qëndrimeve të veta politike dhe zgjedhjeve, që kishin bërë kandidatët dhe përfaqësuesit ekzistues (shih Nr. 25 dhe Nr. 26), si edhe të votonin në një kohë të volitshme nga shtëpia, zyra apo “kioska e demokracisë”. Jo vetëm që kjo duhet të rrisë sasinë e votimeve, por edhe cilësinë e votuesve. Informacioni dhe koha shtesë për të brendësuar dhe vlerësuar duhet të kontribuojë për një ushtrim më të arsyeshëm të së drejtës për të votuar. Ekzistojnë ende shumë çështje, që duhen zgjidhur përpara se qytetarët (dhe politikanët) të ndihen të sigurtë për ta përdorur këtë teknologji, por eksperimentimi është në rrugë e sipër tashmë në shumë shtete anëtare – kryesisht, në nivelin vendor. Këshilli i Europës është një institucion ndërkombëtar shumë i përshtatshëm për të vlerësuar alternativat në fjalë dhe mësimet e nxjerra dhe për të prodhuar një kod praktikash të mira në lidhje me procedura të tilla votimi elektronik.

28. Një agjent për promovimin e reformës demokratike

Këshilli i Europës e ka konsoliduar veten si agjencia më e rëndësishme për të monitoruar ushtrimin e të drejtave të njeriut në Europë dhe tashmë luan një rol domethënës për të “certifikuar” ekzistencën e demokracisë në ato vende, që kohët e fundit kanë dalë nga autokracia. Komisioni i Venecias i KE-së ka gjetur një rol krijues për të ofruar ekspertizë ligjore dhe kushtetuese të paanshme për demokracitë e themeluara rishtas në Europën Qendrore dhe Lindore.

Ne propozojmë që Këshilli i Europës duhet ta zgjerojë rolin e tij drejt përmirësimit sistematik të cilësisë së demokracisë si në shtetet e tij anëtare, ashtu edhe në ato, që do të bëhen anëtare në të ardhmen. Kjo do të kërkonte krijimin e një organi të përhershëm të përbërë – si grupi i ekspertëve, që kanë hartuar këtë material – si nga akademikë nga një numër disiplinash, ashtu edhe nga politikanë me përvojë në nivele të ndryshme të qeverisë dhe në shoqërinë civile. Ky organ do të monitoronte natyrën dhe ritmin e reformave, do të vlerësonte pasojat e tyre dhe, aty ku do të ishte e përshtatshme, do të bëhej avokat i shtrirjes së tyre në qeveri apo vende të tjera. Kjo duhet bërë në mënyrë periodike, le të themi, çdo pesë vjet, dhe duhet të shfrytëzojë gjerësisht të dhënat e mbledhura nga një sistem i rregullt raportimi, në të cilin shteteve anëtare do t'u kërkohej të ofronin informacion mbi reformat, që kanë ndërmarrë si edhe mbi ecurinë normale të institucioneve të tyre demokratike – ashtu siç ka bërë Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) në fushën e ecurisë ekonomike. Nuk do t'i kërkohej të shpallte “rezultate” duke krahasuar cilësinë e demokracisë ndër shtetet anëtare, por do t'i kërkohej të identifikonte “praktika të mira” në krijim e sipër dhe të promovonte përhapjen e tyre në sisteme të tjera politike. Kjo kërkon një kuadër konceptual fillestar – siç është paraqitur këtu – që do të identifikonte përmasat institucionale kyçe të demokracisë liberale bashkëkohore dhe standardet për të vlerësuar ecurinë e saj. As nuk ka nevojë të thuhet që, siç e kemi vërejtur në mënyrë të përsëritur – këto standarde nuk janë uniforme anëtarë rajonit, por variojnë me një gamë të konsiderueshme (por jo të pafundme).

Mandati i këtij grupi ekspertësh duhet të përfshijë mundësinë e raportimit, kur cilësia e demokracisë në një shtet anëtar ka rënë në mënyrë thelbësore dhe ka rënë nën minimumin europian. Në këtë rast ai do të nxirrte një “karton portokalli”, më serioz sesa një i verdhë, në kuptimin që do të rekomandonte që Këshilli i Europës të merrte në shqyrtim pezullimin e anëtarësisë së atij vendi derisa të kryhen përmirësime. S'ka dyshim që vendimi përfundimtar për pezullim (ky do të ishte “kartoni i kuq”) do të varej nga anëtarët e Këshillit.

PËRFUNDIME

Demokracia politike liberale, ashtu siç praktikohet aktualisht në Europë, nuk është “fundi i historisë”. Jo vetëm që mund të përmirësohet, ajo duhet të përmirësohet, nëse dëshiron të ruajë respektin legjitim të qytetarëve të saj. Ajo e ka bërë këtë disa herë në të kaluarën në përgjigje të sfidave dhe mundësive, që kanë lindur dhe nuk ka arsye për të besuar që nuk mund ta bëjë këtë aktualisht.

Jemi përpjekur të përdorim imagjinatën tonë kolektive si teoricienë dhe praktikienë të politikës për të hartuar sugjerime për reforma, që mund të përmirësojnë cilësinë e demokracisë në Europë dhe ta bëjnë atë më legjitime në të ardhmen. Disa prej këtyre tashmë janë prezantuar – zakonisht mbi baza eksperimentale – në disa sisteme politike; shumica, megjithatë, nuk janë vënë në provë kurrë më parë. Ne do të ishim të parët për të pranuar që jo të gjitha këto reforma janë njësoj urgjente apo praktike apo edhe të dëshirueshme. Është detyra e politikanëve demokratikë që të vendosin se cilat janë më të mirat dhe cilat meritojnë trajtim me përparësi.

Megjithatë, ne mund të ofrojmë disa mendime përmbyllëse mbi ato reforma, që jemi të bindur se duhen marrë në shqyrtim me më shumë urgjencë. Është gjykimi ynë kolektiv që problemi madhor i përgjithshëm i demokracisë bashkëkohore europiane ka të bëjë me besimin në rënie të qytetarëve tek institucionet politike dhe me pjesëmarrjen në proceset demokratike. Për rrjedhojë, ato reforma, që premtojnë të rrisin pjesëmarrjen e votuesve, të stimulojnë anëtarësimin në partitë politike, shoqata dhe lëvizje, dhe të përmirësojnë besimin e qytetarëve në rolin e politikanëve si përfaqësues dhe legjislatorë, meritojnë shqyrtim të mëparshëm, sidomos në ato raste, kur ato e bëjnë politikën më argëtuese. Problemi i dytë më i rëndësishëm ka të bëjë me numrin në rritje të banorëve të huaj dhe me statusin politik të jo-shtetasve (të ardhurve) pothuajse në të gjitha demokracitë europiane. Edhe masave për t'i përfshirë këta jo-shtetas brenda procesit politik u duhet dhënë përparësi e lartë.

Ne besojmë që reformat e mëposhtme mund të prezantoheshin në shumicën e shteteve anëtare me anë të legjislacionit të zakonshëm, nuk kanë gjasa të përfshijnë kosto të larta buxhetore dhe duhet të prodhojnë

përmirësime të menjëhershme, qoftë edhe anësore, në cilësinë e demokracisë:

- Llotaritë për zgjedhësit
- Organe Këshilluese të Specializuara të Zgjedhura
- Kioskat e demokracisë
- Edukimi për pjesëmarrje politike
- Këshilli i Jo-Shtetasve
- Të drejtat e votimit për jo-shtetasit
- Papërputhshmëria e mandateve
- Mbështetja elektronike për kandidatët dhe parlamentet (“votimi i zgjuar”)
- Sisteme të monitorimit elektronik dhe bashkëbisedimit online
- Një agjent për promovimin e reformës demokratike

Reformat e mëposhtme kanë më shumë gjasa të hasin kundërshtim politik më të madh sepse janë më novatore dhe sepse kanë më shumë gjasa të prekin balancat mbizotëruese të pushtetit mes partive, interesave të organizatave dhe agjencive qeveritare. Ndoshta për këtë arsye ato kanë më shumë mundësi të kenë ndikim më të madh afatgjatë mbi cilësinë e demokracisë dhe legjitimitetin e institucioneve, por ato janë gjithashtu edhe më të prekshme nga problemet e “transversalitetit”, në kuptimin që ndikimet e tyre të tërthorta duhet të jenë më thelbësore dhe, për rrjedhojë, kërkojnë përshtatje të nevojshme me anë të veprimtarive të tjera reformuese.

- Nënshtetësia universale
- Votimi me mundësi zgjedhjeje
- Mandate të përbashkëta
- Këshilluesit e qytetarëve
- Roje për të ruajtur rojet
- Buxhetimi me pjesëmarrjen e qytetarëve
- Një dispozitë për “karton të verdhë” për legjislaturat
- Legjislacioni kuadër
- Pragje të ndryshueshme për zgjedhjet
- Kupona për financimin e partive politike
- Demokracia brendapartiake
- Kupona për financimin e organizatave në shoqërinë civile
- Referendume dhe nisma

-- Votimi me postë dhe votimi elektronik

Së fundi, ne pranojmë që propozimet e radhitura më poshtë janë veçanërisht të vështira për t'u miratuar dhe zbatuar. Ato janë të pashoqe në thelb, kanë një kosto më të lartë shoqërore dhe ndoshta do të kërkonin “super-shumica” apo edhe ndryshime kushtetuese për t'u miratuar. Kjo nuk do të thotë se ato duhen hedhur tutje – vetëm se kërkojnë shumë më shumë diskutim mes politikanëve dhe përgatitje të qytetarëve përpara se të prezantohen.

-- Shërbimi civil

-- Roje të posaçme për rojet e medias

-- Liria e informacionit

-- Shpërndarja e shpenzimeve publike sipas parapëlqimeve të qytetarëve në bazë niveli (shih Nr. 18)

-- Një Kuvend i Qytetarëve

Do të donim gjithashtu ta mbyllim duke lënë një shënim për të treguar maturi. Reforma të veçuara në rregullat e lojës demokratike rrallë kanë qenë efikase “më vite”. Kanë qenë paketa reformash të ndërlidhura, që kanë qenë më të suksesshmet për përmirësimin e ecurisë dhe legjitimitetit. Disa herë kjo ka qenë rezultat i një llogaritjeje të drejtpërdrejtë dhe racionale të ndërvarësive në lojë; megjithatë, në shumicën e rasteve, ka qenë produkt i vetë procesit politik me nevojën e tij të pashmangshme për aleanca legjislative, kompromise mes forcave garuese dhe shpërblime anësore për grupe të pabindura. Me fjalë të tjera, në demokracitë “e vërteta ekzistuese”, dizenjoja e veprimtarive reformuese është pothuaj gjithmonë jo e përsosur, aq më shumë kur qëllimi është të ndryshohet e ardhmja e rregullave të garës dhe të bashkëpunimit mes forcave politike.

Gjithashtu, reformuesit zakonisht nuk kanë qenë të suksesshëm në parashikimin e të gjitha pasojave të masave, që kanë paraqitur. Pothuaj gjithmonë këto ndryshime kanë gjeneruar pasoja të pasyнуara – disa të mira, disa jo dhe aq të mira. Nuk duhet harruar kurrë që në një shoqëri të lirë dhe në një sistem politik demokratik individët dhe organizatat e ndikuara nga novacionet politike do të reagojnë ndaj tyre dhe shumë shpesh në mënyra të paparashikueshme. Më thelbësorja është që ato do të përpiqen t'i “fusin në lojë”, domethënë t'i shfrytëzojnë ato në mënyrë që

të përfitojnë ato vetë dhe, jo rrallë, do të përpiqen të shtrembërojnë synimin e tyre me qëllim që të mbrojnë interesa të konsoliduara.

Gjithçka këtu bën thirrje për maturi – veçanërisht kur paraqiten reforma, që janë mirëfilli novatore. Në një situatë ideale, masa të tilla duhet fillimisht të trajtohen si eksperimente politike dhe të kryhen në vende të zgjedhura posaçërisht – normalisht, në nivel vendor apo rajonal. Vetëm pasi ndikimet e tyre të jenë monitoruar dhe vlerësuar sistematikisht, shpresojmë nga një agjenci e paanshme dhe shumëkombëshe si Këshilli i Europës, ato mund të përcillen në nivele të tjera brenda të njëjtit sistem politik apo në shtetet e tjera anëtare.

E përsërisim: demokracitë tona në Europë mund të reformohen. Ato mund të shndërrohen për të qenë më në përputhje me atë “fjalë, që nuk ka ekzistuar kurrë” dhe, duke e bërë këtë, ato mund të rifitojnë besimin në institucionet dhe legjitimitetin në procese, që duken se kanë humbur gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit. Por nuk ka për të qenë e lehtë dhe ka për t’u kërkuar mençuria kolektive e teoricienëve dhe prakticienëve politikë në të gjitha dyzetepesë shtetet anëtare të Këshillit të Europës për të identifikuar se cilat reforma duken të jenë më të dëshirueshme, të vlerësojnë cilat kanë qenë pasojat e tyre dhe, së fundi, të ndajnë me njëri-tjetrin mësimet e nxjerra nga këto përvoja.

Me rënien e murit të Berlinit Europa, nga Perëndimi në Lindje, papritur u gjet në një hapësirë demokratike shumë më të madhe. Në këto rrethana favorizuese e të papara për demokracinë në Europë, si mund të shpjegohet pakënaqësia e përhapur gjerësisht me mënyrën se si “demokracia e vertetë dhe ekzistuese” po praktikohet në Europë? Në këtë libër, një grup akademikësh dhe ekspertë të politikës Europiane propozojnë rrugë dhe reforma që kanë për qëllim të ndihmojnë në funksionimin e mirë të institucioneve demokratike, pra, forcimin e legjitimitetit të qeverisjes dhe dispozitave qeverisëse.

Demokracia mbështetet tek qytetarë sovranë, procese transparente të vendimmarrjes dhe qeveritarë të përgjegjshëm. Edhe pse historikisht ka qenë shumë e vështirë për ti realizuar këto parime, ato vazhdojnë të jenë udhërrëfyese për përmirësimin e cilësisë së demokracisë bashkëkohore në Europë dhe më gjerë. Pavarësisht nga diferencat në institucionet ekzistuese dhe shumëllojshmëria e kërkesave që gjenerohen nga Demos-i gjithnjë e më i diversifikuar, ky botim tregon se ekzistojnë reforma konkrete, që janë të mundshme, madje të nevojshme, për t'i përmbushur këto parime.

GLOBIC PRESS

<http://press.globic.us/>

